





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna Rahovec
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kuvendi Komunal – Skupština Opštine – Municipal Rahovec

	REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO KUVENID I KOMUNES/SKUPSTINA OPSTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY	
RAHOVEC /ORAHOVAC		
Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)		
Nr./Br./No <u>31</u> Nr. i faq/Br.str/No.pg <u>10</u>		
Data/Datum/Date <u>26 / 12 / 2019</u>		

PLANI I PUNËS

SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË RAHOVECIT PËR VITIN

2020

Pasqyra e planit

Parathënie

Janar

Shkurt

Mars

Prill

Maj

Qershor

Korrik

Gusht

Shtator

Tetor

Dhjetor

Parathënie

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në Komunë dhe zgjidhet drejtpërdrejtë nga qytetarët dhe funksionon në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, Statutit dhe akteve të tjera nënligjore.

Kuvendi i Komunës nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për:

- Statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre;
- Miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;
- Miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin sipas statutit apo Rregulloreve të punës;
- Planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;
- Themelimin e komisioneve të kërkuara sipas Ligjit;
- Nivelin e tarifave dhe ngarkesave;
- Krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të Komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
- Emërimin dhe riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- Arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda komunale;
- Marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës; dhe
- Përgjegjësitë të tjera që kërkohen me ligj.

Për marrjen e vendimeve, Kuvendi i Komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij komiteteve të përhershme të Kuvendit të Komunës, apo Kryetarit të Komunës. Kuvendi i Komunës mund të tërheqë delegimin në çdo kohë.

Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifatat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal, për marrjen e raporteve nga Kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

Kuvendi i Komunës siguron kushte të punës për mbajtje të seancave të Kuvendit të Komunës, si dhe pjesëmarrje për qytetarë gjatë seancave. Siguron transparencë të plotë ndaj qytetarëve për të gjitha vendimet dhe aktet, si dhe për çdo gjë që është në interes të qytetarëve. Po ashtu, iu krijon mundësi qytetarëve që përmes formave të ndryshme të jenë pjesëmarrës në vendimmarrje.

Përveç këtyre akteve, Kuvendi i Komunës, kryen edhe aktivitete të tjera që janë të domosdoshme për realizimin e përgjegjësive të saj, përfshirë edhe funksione tjera, detyra dhe përgjegjësi të pa deleguara si:

- Vendimet që kanë të bëjnë me pronën e Komunës;
- Miratimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), Planit Zhvillimor Urban (PZHU), dhe Planeve Rregulluese Urbane (PRRU), si dhe ndryshimin e tyre; dhe
- Themelimin e ndërmarrjeve publike të Komunës.

Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Rahovecit është dokument i mbështetur në Ligjin për vetëqeverisje lokale, Statutin e Komunës, Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe aktet tjera nënligjore.

Plani është i hartuar në bazë të një kornize logjike i cili planifikon etapat e realizimit të punëve dhe detyrave të Kuvendit të bazuara në detyrat dhe përgjegjësitë që dalin nga Ligji për vetëqeverisje lokale, Statuti dhe aktet tjera nënligjore.

Me këtë plan synohet arritja e objektivave për vitin 2020, ku Kuvendi i Komunës së Rahovecit planifikon t'i mbaj minimum 10 (dhjetë) seanca të rregullta, 5 (pesë) prej të cilave në gjashtëmujorin e parë të vitit 2020, në të cilat do të trajtohen të gjitha çështjet që janë në interes të Komunës dhe të qytetarëve të Rahovecit, e të cilat janë të proceduara sipas akteve në fuqi:

- Cakton datën e mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit sipas rregullores së punës së Kuvendit;
- Planifikon shqyrtimin e raporteve të rregullta të punës së Kryetarit të Komunës sipas ligjit;
- Inkorporon planin e tubimeve me qytetarë të Kryetarit të Komunës;
- Miraton buxhetin, planet investuese, planin vjetor të prokurimit, planin vjetor të punës së Auditorit të Brendshëm, planet rregullative etj.
- Miraton çështje tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin, sipas Statutit apo Rregullores së punës;
- Nxjerr rregullore të reja dhe bën harmonizimin e rregulloreve ekzistuese me ligjet në fuqi;
- Inkorporon planin e Kryetarit për festa shtetërore e kombëtare.
- Mbikëqyr, diskuton, analizon dhe vlerëson punën e ekzekutivit;

Përfundim

Plani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës, do të ndihmoj dhe lehtësoj punimet e mbledhjeve të Kuvendit, duke iu ofruar anëtarëve të Kuvendit këtë plan, ata do të kenë një pasqyrë për punët dhe aktivitetet e parapara për vitin 2020 e që kanë të bëjnë me interesat e qytetarëve.

Me planin e punës janë paraparë minimum 10 (dhjetë) seanca të rregullta, por sipas nevojës mund të mbahen edhe seanca tjera përfshirë edhe seanca të jashtëzakonshme, solemne siç parashihet me LVL dhe Statutin e Komunës.

Për përmbushjen e Programit të punës, Ekzekutivi ofron mbështetje profesionale dhe administrative organeve të Kuvendit, duke përshtatur organizimin e brendshëm për realizimin e objektivave dhe agjendës sipas këtij plani.

Për mbarëvajtjen e zbatimit e të gjitha aktiviteteve, sipas dinamikës së përcaktuar me këtë program - plan, do të përkujdesen Kryetari dhe Kryesuesi i Kuvendit.

Realizimi i Programit të Punës së Kuvendit kërkon bashkërenditje dhe koordinim të aktiviteteve me Ekzekutivin e Komunës, e cila duhet t'i përmbahet planit të Kuvendit për vitin 2020.

Plani i punës së Kuvendit sipas dinamikës mujore përfshin: emërtimin e aktit, propozuesin, afatin e dërgimit nga propozuesi, afatet e shqyrtimeve nga komitetet funksionale përgjegjëse për shqyrtim.

Programi i Punës së Kuvendit për vitin 2020 do të plotësohet edhe me:

- Miratimin e iniciativave për bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkombëtar.
- Propozime për debate dhe propozime përmbajtësore,
- Propozime për raportime dhe informata,
- Peticione,
- Pyetje të anëtarëve të Kuvendit.

Shtojcë: *Plani i punës sipas muajve*

Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Rahovecit për vitin 2020

Rendi i Ditës		Hartton	Propozon	Shqyrton	Miraton
Janar 2020	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kaluar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi i KK-së	KPF/KK	Kuvendi
	Pyetjet dhe pergjigjet ne pyetjet e kuvendarëve	Anëtarët e Kuvendit	Anëtarët e Kuvendit	Ekzekutivi	
	Informate e Kryetarit mbi Planin e Punës së Ekzekutivit për vitin 2019	Drejtori për Buxhet dhe Financa	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar 2019	Drejtori për Buxhet dhe Financa	Kryetari i Komunës/kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Shqyrtimi i implementimit te planit te veprimt per zbatimin e rekomandimeve te auditorit te pergjithshem sipas planit te veprimt per vitin 2019	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari i Komunës/kuvendi	KPF/KK	
	Shqyrtimi i Raportit të punës të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2019	Kryetari i Këshillit	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Shqyrtimi i Planit vjetor 2020 të Zyrës së Auditorit të Brendshëm.	Zyra e Auditorit të Brendshëm	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Shqyrtimi i Raportit (Informatës) rreth aktiviteteve të KKSb-së	Anëtarët e KKSb-së	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Anëtarët e KK-së	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregullore nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kaluar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi	KPF/KK	Kuvendi
	Pyetjet dhe pergjigjet ne pyetjet e kuvendarëve	Anëtarët e KK-së	Anëtarët e KK-së	KPF/KK	
	Bartja (rialokim) i buxhetit të paspenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual	Drejtori për Financa dhe Buxhet	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Raport i Kryesuesit të Komitetit për Shërbime Publike mbi punën e Komitetit	KSHP	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
Raport i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2019	Kryesuesi i K. Komunitete	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK		
Informate mbi kontratat kornizë të Komunës së Rahovecit	Zyra e Prokurimit	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK		
Shqyrtimi i planit të prokurimit për vitin 2020	Zyra e Prokurimit	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK		
Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të kuvendit	Anëtarët e KK-së	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF	Kuvendi	
Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregullore nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi i Komunës	Kuvendi i Komunës	KPF/KK	Kuvendi	
Shkurt 2020					


Mars 2020	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kaluar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi	Kuvendi
	Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve	Anëtarët e KK-së	Anëtarët e KK-së	Kuvendi
	Informatë nga Komiteti për Auditim për vitin 2019	Kryesuesi i Komitetit	Kryetari i Komunës/Kuvendi	Kuvendi
	Raport mbi menaxhimin e aseteve komunale (inventari) për vitin 2019	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari i Komunës/Kuvendi	Kuvendi
	Informatë mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimin e tyre	Sektori i pronës	Kryetari i Komunës/Kuvendi	Kuvendi
	Informatë mbi menaxhimin e situatave në mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror	Drejtoria e Shërbimeve Publike	Kryetari i Komunës/Kuvendi	Kuvendi
	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Anëtarët e KK-së	Kryetari i Komunës/Kuvendi	Kuvendi
	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregullore nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi i Komunës	Kuvendi i Komunës/Kryetari	Kuvendi
Prill 2020	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kaluar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi	Kuvendi
	Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve	Anëtarët e KK-së	Anëtarët e KK-së	Kuvendi
	Informatë nga puna e Zyrës së Auditorit të Brendshëm	Shefi i Zyrës së Brendshme	Kryetari i Komunës/Kuvendi	Kuvendi
	Raport nga komitetet dhe komisionet e Kuvendit të Komunës	Komitetet dhe komisionet	Kuvendi i Komunës/Kryetari	Kuvendi
	Shqyrtimi i informatës tre mujore financiare të Komunës për periudhën janar - mars 2020	Drejtori për Buxhet dhe Financa	Kuvendi i Komunës/Kryetari	Kuvendi
	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Anëtarët e KK-së	Kryetari i Komunës/Kuvendi	Kuvendi
	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregullore nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi i Komunës	Kuvendi i Komunës/Kryetari	Kuvendi
Maj 2020	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kaluar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi	Kuvendi
	Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve	Anëtarët e KK-së	Anëtarët e KK-së	Kuvendi
	Shqyrtimi dhe aprovimi PZHK-së si dhe planet tjera rregulluese	Drejtoria e Urbanizimit	Kryetari i Komunës/Kuvendi	Kuvendi
	Informatë mbi Qarkoren 1-rë të MF-së	Drejtoria për Buxhet	Kryetari i Komunës/Kuvendi	Kuvendi
	Informatë nga Drejtoria e Buqësisë			
	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Anëtarët e KK-së	Kryetari i Komunës/Kuvendi	Kuvendi
	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregullore nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi i Komunës	Kuvendi i Komunës/Kryetari	Kuvendi


Qershor 2020	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi	KPP/KK	Kuvendi
	Pyetjet dhe pergjigjet ne pyetjet e kuvendarëve	Anetarët e KK-së	Anetarët e KK-së	KPP/KK	Kuvendi
	Miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2020-2023	Ekzekutivi i Komunes	Kuvendi i Komunes/Kryetari	KPP/KK	Kuvendi
	Rishikimi i Buxhetit të Komunes për vitin 2020	Ekzekutivi i Komunes	Kryetari i Komunes/Kuvendi	KPP/KK	Kuvendi
	Shqyrtimi i raportit (informatës) rreth aktiviteteve të KKSB-së	Kryetari i Komunes	Kryetari i Komunes/Kuvendi	KPP/KK	Kuvendi
	Informatë mbi menaxhimin e mbeturinave në komunën e Rahovecit	Dr. e Shërbimeve Publike	Kryetari i Komunes/Kuvendi	KPP/KK	Kuvendi
	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Anetarët e KK-së	Kryetari i Komunes/Kuvendi	KPP	Kuvendi
	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi i Komunes	Kuvendi i Komunes/Kryetari	KPP/KK	Kuvendi
	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi	KPP/KK	Kuvendi
	Pyetjet dhe pergjigjet ne pyetjet e kuvendarëve	Anetarët e KK-së	Anetarët e KK-së	KPP/KK	Kuvendi
	Informatë për Qarkoren e 2-të buxhetore	Anetarët e KK-së	Anetarët e KK-së	KPP/KK	Kuvendi
	Shqyrtimi i raportit financiar janar – qershor 2019	Drejtorja për Buxhet dhe Financa	Kryetari i Komunes/Kuvendi	KPP/KK	Kuvendi
	Raport nga DKA-ja rreth përfundimit të vitit shkollor 2019/2020	Drejtori i DKA-së	Kryetari i Komunes/Kuvendi	KPP/KK	Kuvendi
	Informatë nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale	Drejtori i DSHPS-së	Kryetari i Komunes/Kuvendi	KPP/KK	Kuvendi
	Raporti i punës së Kryetarit të Komunes për gjashtë muajt e vitit 2020	Ekzekutivi i Komunes	Kuvendi i Komunes/Kryetari	KPP/KK	Kuvendi
	Informatë mbi Raportin e Performancës së Komunes	MAPL, Koordinatorja	Kryesuesi i Kuvendit	KPP/KK	Kuvendi
	Shqyrtimi i Raportit të ZAP-it për vitin 2019	ZAP	Kryetari i Komunes/Kuvendi	KPP/KK	Kuvendi
	Informatë mbi realizimin e planit për mirëmbajtjen e Hapësirave të Hapura Publike në komunën e Rahovecit	Drejtori i Shërbimeve Publike	Kryetari i Komunes/Kuvendi	KPP/KK	Kuvendi
	Informatë mbi realizimin e planit të punës së Zyrtës së Prokurimit janar – qershor 2020	Zyra e Prokurimit	Kryetari i Komunes/Kuvendi	KPP/KK	Kuvendi
	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Anetarët e KK-së	Kryetari i Komunes/Kuvendi	KPP	Kuvendi
	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi i Komunes	Kuvendi i Komunes/Kryetari	KPP/KK	Kuvendi

Korrik 2020

Nëntor 2020		Zyra e Kuvendit	Kryesuesi	KPPF/KK	Kuvendi
Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi	KPPF/KK	Kuvendi	
Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve	Anëtarët e KK-së	Anëtarët e KK-së	KPPF/KK	Kuvendi	
Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Anëtarët e KK-së	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPPF	Kuvendi	
Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi i Komunës	Kuvendi i Komunës/Kryetari	KPPF/KK	Kuvendi	
Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi	KPPF/KK	Kuvendi	
Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve	Anëtarët e KK-së	Anëtarët e KK-së	KPPF/KK	Kuvendi	
Raporti mbi realizimin e Planit për vitin 2020 si dhe informata mbi Planin vjetor të prokurimit publik 2021	Zyra e Prokurimit	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPPF/KK	Kuvendi	
Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021	Grupi punues nga Kuvendi	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPPF/KK	Kuvendi	
Informata mbi realizimin e Planit të punës së KK-së për vitin 2020	Kryesuesi i Kuvendit	Anëtarët e KK-së	KPPF/KK	Kuvendi	
Raporti mbi realizimin e Planit për vitin 2020 si dhe shqyrtimi i Planit të punës së Auditorit të Brendshëm për vitin 2021	Zyra e Auditimit të Brendshëm	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPPF/KK	Kuvendi	
Miratimi i Planit Vjetor të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) për vitin 2020	Kryetari i Komunës	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPPF/KK	Kuvendi	
Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Ekzekutivi i Komunës	Kuvendi i Komunës/Kryetari	KPPF/KK	Kuvendi	
Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi	KPPF/KK	Kuvendi	

01 Nr. 31/2019
Rahovec, 26.12.2019





Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Preседnik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNË / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPAL ASSEMBLY

RAHOVEC / ORAHOVAC

Nëseja Nr./Br./No 01 (Kryetari i Komunës)

Nr./Br./No 8 Nr. ifaq/Br.st/No.pg 5

Datë/Date/Date 26 / 12 / 2019

PLANI I VEPRIMIT PËR KËSHILLIN KOMUNAL PËR SIGURI NË
JANAR-DHJETOR 2020

Nr. Re.	Muaji	Çështjet që shqyrtohen	Përshkrim i shkurtër i iniciativës / projektit	Përgatit	Shqyrton	Specifikat Buxhetore
1	JANAR	<p>1. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit,</p> <ul style="list-style-type: none">- Analizë e sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit për vitin paraprak,- Siguria në trafik,- Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla,- Rreth veprimëve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në komunën e Rahovecit,	Kryetari i komunës dhe Komandanti i Policisë raporton para anëtarëve të KKSBS-së, rreth gjendjes së sigurisë për muajt raportues.	Kryetari i Komunës, Policia dhe Koordinatori	Anëtarët e KKSBS-së	00.00€
		2. Të ndryshme.			Anëtarët e KKSBS-së	

2	MARS	<p>1. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit,</p> <ul style="list-style-type: none"> - Trotuarët, liri i tyre dhe shenjat sinjalizuese. - Qentë endacak. - Siguria në trafik, - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla, - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në komunën e Rahovecit, 	<p>Kryetari i Komunës dhe Komandanti i Policisë raporton para anëtarëve të KKS-së, rreth gjendjes së sigurisë për muajt raportues.</p>	<p>Kryetari i Komunës dhe Koordinatori i KKS-së</p>	<p>Anëtarët e KKS-së</p>	<p>00.00 €</p>
<p>2. Organizimi i takimit publik me qytetarët dhe kryetarët e fshatrave dhe lagjeve urbane,</p>	<p>Shqyrtimi i problemeve të sigurisë të cilat i preokupojnë banorët</p>	<p>Kryetari i Komunës, anëtarët e KKS-së</p>	<p>Anëtarët e KKS-së</p>	<p>100.00 €</p>		
<p>3. Të ndryshme.</p>			<p>Anëtarët e KKS-së</p>			
	PRILL	<p>1. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit,</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shqyrtimi i dukurive negative, me theks të veçantë - trajtimi i objekteve jo të sigurta në komunën e Rahovecit, - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla, - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në komunën e Rahovecit, - Parapërgatitja dhe vetëdijesimi i qytetarëve për parandalimin nga zjarri gjatë sezonit veror, 	<p>Kryetari i Komunës, Komandanti i Policisë, drejtori i DKA-së dhe drejtori i Emergjencave raportojnë para anëtarëve të KKS-së, rreth gjendjes së sigurisë për muajt raportues</p>	<p>Kryetari i Komunës, Policia dhe Koordinatori i KKS-së</p>		<p>00.00 €</p>


QERSHOR					
	<p>2. Identifikimi i gëshëve problematike që ndikojnë në sigurinë publike ndër-etnike,</p>	<p>Organizimi i takimeve publike me komunitetet pakicë në Rahovec</p>	<p>Kryetari i Komunës, Policia, Kordinatori i KKSB-së</p>		<p>100.00 €</p>
	<p>3. Të ndryshme.</p>				
	<p>1. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit,</p> <ul style="list-style-type: none"> - Prishja e qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e papërgjegjshëm, - Masat për parandalimin e lëmshë-kërkuesit, - Plan operativ për sezonin e pushimeve të mërgimtarëve dhe dasmave, - Siguria në trafik, - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla, - Rreth veprimave dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në komunën e Rahovecit, 	<p>Kryetari i Komunës, Komandanti i Policisë DMSH-ja, DA-ja dhe DKA-ja, raportojnë para anëtarëve të KKSB-së</p>	<p>Kryetari i Komunës, Policia, Kordinatori i KKSB-së</p>	<p>Anëtarët e KKSB-së</p>	<p>00.00 €</p>
	<p>2. Sensibilizimi i qytetarëve për rendësinë e promovimit të bashkëpunimit ndër-etnik, multi-kulturor dhe ndër – fetar.</p>	<p>Organizimi i ndonjë kampi ose ndonjë aktiviteti sportiv me të rinjtë e komuniteteve që banojnë në komunën e Rahovecit</p>	<p>Kryetari i Komunës, Policia, anëtarët e KKSB-së dhe Kordinatori i KKSB-së,</p>	<p>Anëtarët e KKSB-së</p>	<p>1,000.00 €</p>
	<p>3. Të ndryshme.</p>			<p>Anëtarët e KKSB-së</p>	

DHJETOR		SHTAOTR			
	<p>1. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit,</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vetëdijësimi për mezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike, - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla, - Mungesa e parkingjeve në qytet dhe ndriçimi publik 	<p>Shërbimi i Kuvendit-Zyra e Kryetarit Anëtarët e KKSB-së Policia e Kosovës DKA-ja</p>	<p>Policia KKSB-së</p>	<p>KKSB-së</p>	<p>00.00 €</p>
	<p>2. Të ndryshme.</p>			<p>Anëtarët e KKSB-së</p>	
	<p>1. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit,</p> <ul style="list-style-type: none"> - Prishja e qetësisë publike nga lokalitetet e natës dhe personat e pa përgjegjshëm - Mbrojtjes së pyjeve nga dëmtuesit ilegalë, - Vetëdijësimi nga minat dhe mjertet tjera të pa shpërtjyera nga lufta, - Identifikimi i hapësirave për qasjen e personave me nevoja të veçanta, - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla, - Siguria në trafik. - Raportimi dhe parandalimi i dhunës në familje - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në komunën e Rahovecit 	<p>Kryetari i Komunës, Komandanti i Policisë DMSH-ja, DA-ja dhe DKA-ja, raportojnë para anëtarëve të KKSB-së</p>	<p>Kryetari i Komunës, Policia</p>	<p>Anëtarët e KKSB-së</p>	<p>00.000 €</p>

	<p>2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës së KKSB-së për vitin 2021.</p>	<p>Bëhet përgatitja e Planit të Punës së KKSB-së nga Kryetari i Komunës dhe Koordinatori KKSB-së</p>	<p>Kryetari i Komunës, anëtarët e KKSB-së, Koordinatori</p>	<p>Anëtarët e KKSB-së</p>	<p>00.00 €</p>
<p>3. Të ndryshme.</p>			<p>Anëtarët e KKSB-së</p>		

01 Nr. 28/2019

Rahovec, 26.12.2019



 KRYETAR I KUVENDIT



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec



Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec

RAHOVEC /ORAHOVAC	
Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)	
Nr./Br./No <u>32</u>	Nr. i faq/Br.str/No.pg <u>1</u>
Data/Datum/Date <u>26</u> / <u>12</u> / <u>2019</u>	

Në bazë të nenit 12.2 shkronja (d), nenit 17 shkronja (e) dhe nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 46 paragrafi 1 dhe nenit 57 i Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur me datë: 26.12.2019, merr këtë:

V E N D I M

Për vënien në debat publik të Planit Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE) 2019-2021

1. Kuvendi i Komunës së Rahovecit merr vendim për vënien në debat publik të Planit Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE) 2019-2021.
2. Të drejtë pjesëmarrje në debat publik kanë të gjithë qytetarët e komunës së Rahovecit dhe subjektet të tjera të interesuara.
3. Për datën, vendin dhe kohën e mbajtjes së debatit publik, qytetarët dhe subjektet tjera të interesuara do të njoftohen përmes web - faqes zyrtare të Komunës dhe shpalljes publike në tabelën e shpalljeve .
4. Pyetjet, vërejtjet, sugjerimet, komentet etj. (verbale dhe me shkrim), mund ti drejtohen ekipit për përcjelljen e debatit publik drejtpërdrejtë ose përmes zyrës së Kuvendit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Zyra e Kuvendit të Komunës së Rahovecit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit.


Vendimi u dërgohet:



- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr. 32/2019
Rahovec: 26.12.2019





	REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO KUVENDI I KOMUNES/SKUPSTINA OPSTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY	
RAHOVEC /ORAHOVAC		
Njësia Nr./Br./No <u>01</u> (Kuvendi i Komunës)		
Nr./Br./No <u>32</u> Nr. i faq./Br.str/No.pg <u>100</u>		
Data/Datum/Date <u>26 / 12 / 2019</u>		

KOMUNA E RAHOVECIT

Draft

Plani Komunal i Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE)

2019 – 2021

Dhjetor, 2019



Implemented by
giz
Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Deklarim:

Ky Plan është mbështetur nga Qeveria Gjermane dhe implementuar përmes Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Projekti i Kosovës për Eficiencë të Energjisë.

Studimi, mbledhja e të dhënave dhe hartimi i planit është realizuar nga konsulenca e angazhuar nga GIZ: Asociacioni Kosovar për Energji të Ripërtëritshme dhe Eficiencë të Energjisë (AKEREE), falë bashkëpunimit dhe koordinimit të ngushtë me grupin punues të Komunës së Rahovecit.

Pikëpamjet e hartueseve të këtij plani (AKEREE) si dhe të dhënat e publikuara nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e GIZ-së.

Mirënjohe:

Grupit punues, i emëruar nga Kryetari i Komunës së Rahovecit për Planin Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë, në përbërje të:

1. Shpejtim Mustafa, kryesues;
2. Fadil Bugari, anëtar;
3. Lulzim Krasniqi, anëtar;
4. Shedat Ukaj, anëtar;
5. Etnik Popaj, anëtar;
6. Petrit Haxhijaha, anëtar;
7. Bylbyl Hoxha, anëtar;
8. Asllan Mazreku, anëtar;
9. Beqir Hamza, anëtar;
10. Vjollca Gurgule, SHL Kosova, anëtare.

Përmbajtja

1. HYRJE	11
1.1 KONTEKSTI.....	11
1.1.1 Objektivat dhe përfitimet e PKVEE.....	12
1.1.2 Politikat dhe korniza ligjore.....	13
1.2 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	15
2. INFORMACIONI BAZIK RRETH KOMUNËS	18
2.1 POZITA DHE TOPOGRAFIA.....	18
2.2 KLIMA.....	19
2.3 POPULLSIA DHE VENDBANIMET.....	20
2.4 STRUKTURA ORGANIZATIVE E KOMUNËS SE RAHOVECIT.....	21
2.5 TREGUESIT EKONOMIK DHE FINANCIAR.....	22
2.6 NDËRLIDHJA ME POLITIKAT E TJERA LOKALE DHE RAJONALE.....	24
2.7 PËRVOJA NË ZBATIMIN E MASAVE TË EE.....	25
2.7.1 Kapacitetet në zbatimin e projekteve.....	25
3. FURNIZIM ME ENERGI, PRODHIMI DHE SHPËRNDARJA	26
3.1 FURNIZIMI ME ENERGI.....	26
3.1.1 Energjia elektrike.....	26
3.1.1.1 Furnizim me energji elektrike.....	26
3.1.1.2 Shpërndarja e energjisë elektrike.....	27
3.1.2 Derivatet.....	29
3.1.2.1 Nafta.....	29
3.1.3 Qymyri.....	29
3.1.4 Biomasa- Druri i zjarrit.....	31
3.1.4.1 Peleti.....	33
3.2 PRODHIMI I ENERGISË.....	33
3.2.1. Prodhimi i energjisë prej Burimeve të Ripërtëritshme.....	33
3.2.2. Prodhimi i energjisë për ngrohje.....	34
3.3 PRODHIMI I ENERGISË SIPAS SEKTORËVE.....	34
3.3.1 Prodhimi i energjisë në ekonomitë familjare (ndërtesat e banimit).....	34
3.3.2 Prodhimi energjisë në sektorin e shërbimeve.....	34
3.3.2.1. Prodhimi i energjisë nga ndërtesat publike.....	34
3.3.2.2. Prodhimi i energjisë nga sektori komercial, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.....	35
3.3.2.3 Prodhimi i energjisë nga ndërmarrjet publike.....	35
3.3.3 Prodhimi energjisë në sektorin e bujqësisë.....	35
4. ANALIZA E KONSUMIT TË ENERGISË SIPAS SEKTORËVE	36
4.1 KONSUMI I ENERGISË NGA NDËRTESTAT PUBLIKE KOMUNALE.....	36
4.1.1. Konsumi i energjisë nga ndërtesat e administratës.....	39
4.1.2 Konsumi energjisë nga ndërtesat e arsimit.....	41
4.1.3. Konsumi i energjisë nga ndërtesat shëndetësore.....	43
4.1.4. Konsumi i energjisë nga ndërtesat e Kulturës dhe sportit.....	45
4.1.4. Konsumi i energjisë nga ndërtesa e zjarrfikësve dhe pylltarisë.....	47
4.1.5 Konsumi i energjisë nga ndriçimi publik.....	49
4.2. KONSUMI ENERGISË NË SHËRBIMET PUBLIKE.....	51

4.2.1. Konsumi i energjisë në furnizimin me ujë dhe sektorin e ujërave të zeza	51
4.2.2. Konsumi i energjisë në sektorin e mbledhjes së mbeturinave.....	52
4.3. KONSUMI I ENERGJISË NË SEKTORIN E BUJQËSISË	54
4.4. KONSUMI I ENERGJISË NË SEKTORIN E TRANSPORTIT	54
4.4.1. Transporti publik.....	54
4.4.2. Flota komunale	54
5. ANALIZAT E POTENCIALIT TË EFIÇIENCËS SË ENERGJISË SIPAS SEKTORËVE	55
5.1 SEKTORI I SHËRMBIMEVE	55
5.1.1. Ndërtesat publike.....	55
5.1.1.1. Ndërtesat e Administratës.....	57
5.1.1.2. Ndërtesat arsimore	57
5.1.1.3. Ndërtesat shëndetësore	58
5.1.1.4. Ndërtesat e Kulturës dhe sportit.....	59
5.1.1.5. Ndërtesat e zjarfikësve dhe pylltarisë	59
5.1.1.6. Ndriçimi publik.....	60
5.2. POTENCIALI I PËRGJITHSHËM I KURSIMIT TË ENERGJISË	61
5.3. ANALIZA E GAZRAVE ME EFEKT SERRË DHE POTENCIALI I KURSIMIT	63
5.4. ÇAKU I KURSIMIT TË ENERGJISË	64
6. MASAT E EFIÇIENCËS SË ENERGJISË PËR TË ARRITUR CAQET E KURSIMIT	66
6.1. INFORMIMI DHE MASAT PËR NGRITJEN E KAPACITETEVE	66
6.1.1. Masat për politikat komunale, promovim dhe ndryshimin e shprehive	67
6.2. MASAT E EFIÇIENCËS SË ENERGJISË SIPAS SEKTORËVE	68
6.2.1. Masat e efiçencës së energjisë në sektorin publik	68
6.2.1.1. Ndërtesat e arsimit, shkencës dhe teknologjisë	71
6.2.1.3. Ndriçimi publik.....	78
7. PËRMBLEDHJE E PLANIFIKIMIT AFATMESËM TË EFIÇIENCËS SË ENERGJISË	83
7.1. ZBATIMI I MASAVE TË POLITIKAVE LOKALE, TË PROMOVIMIT DHE NDRYSHIMIT TË SHPREHIVE DHE SJELLJES	83
7.2. ZBATIMI I MASAVE TË EFIÇIENCËS SË ENERGJISË NË SEKTORIN PUBLIK.....	83
8. MONITORIMI I ZBATIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT.....	84
8.1. MENAXHIMI KOMUNAL I ENERGJISË	84
8.2. KOORDINIMI	85
8.3. RAPORTIMI	86
8.3.1. Monitorimi dhe raportimi brenda komunës	86
8.3.2. Raportimi në nivelin qendror (AKEE).....	86
9. MODELI DHE BURIMET E FINANCIMIT PËR IMPLEMENTIMIN E MASAVE TË EFIÇIENCËS SË ENERGJISË	87
9.1. FINANCIMI NGA BUXHETI KOMUNAL	87
9.2. FINANCIMI NGA BUXHETI QENDROR	87
9.3. FINANCIMI NGA DONATORËT	88
9.4. FINANCIMI NGA BE.....	89
10. KONKLuzionET	90
11. REFERENCAT	91
SHTOJCA 1. KONVERTIMI I NJËSIVE	91
SHTOJCA 2. NDËRTE SAT ADMINISTRATIVE	92
SHTOJCA 3. NDËRTE SAT ARSIMORE.....	93

SHTOJCA 4. NDËRTESAT SHËNDETËSORE	97
SHTOJCA 5. NDËRTESAT E KULTURËS DHE SPORTIT	98
SHTOJCA 6. NDËRTESA E ZJARRFIKËSVE DHE PYLLTARISË	100

Tabelat

Tabela 1. Konsumi mesatar vjetor i energjisë dhe potenciali i kursimit nga ndërtesat publike komunale dhe ndriçimi rrugor	16
Tabela 2. Caku dhe niveli i kursimit te energjisë në raport me konsumin e përgjithshëm mesatar vjetor të energjisë në sektorin e ndërtesave publike komunale dhe ndriçimin e rrugëve.....	17
Tabela 3. Kursimi i energjisë në ndërtesat dhe ndriçimin rrugor, të përzgjedhura për zbatim të masave të EE.....	17
Tabela 4. Rrezatimit mujor diellor në komunën e Rahovecit	20
Tabela 5. Vendbanimet dhe numri i banorëve në Komunën e Rahovecit	21
Tabela 6. Buxheti i komunës së Rahovecit për vitin 2018	24
Tabela 7. Investimet e realizuara ne masat e EE në periudhën 2016-2018	25
Tabela 8. Rezervat qymyrit në Republikën e Kosovës	30
Tabela 9. Sasia e burimeve energjetike të konsumuar nga ndërtesat publike në tri vitet e fundit	38
Tabela 10. Ndërtesat e kulturës dhe sportit në komunën e Rahovecit te cilat nuk do te trajtohen per analiza te mëtejme te konsumit te energjisë	46
Tabela 11. konsumi i energjisë elektrike dhe kostoja mesatare vjetore e raportuar.....	50
Tabela 12. Pasqyra e llambave ekzistuese për ndriçimin e rrugëve.....	50
Tabela 13. Konsumi vjetor i karburantit nga flota komunale në periudhën 2016-2018	55
Tabela 14. Potenciali i kursimit të energjisë në stokun e ndërtesave të administratës publike...	57
Tabela 15. Potenciali i kursimit të energjisë në stokun e ndërtesave të arsimit	58
Tabela 16. Potenciali i kursimit të energjisë në stokun e ndërtesave shëndetësore	58
Tabela 17. Potenciali i kursimit të energjisë në ndërtesën e zjarrfikësve dhe pylltarisë	60
Tabela 18. Potenciali i kursimit të ndriçimi publik-Rahovec (sipas konsumit të llogaritur)	60
Tabela 19. Potenciali i kursimit të energjisë në sektorin e ndërtesave publike komunale dhe ndriçimin e rrugëve	63
Tabela 20. Emisionet aktuale vjetore të CO ₂ dhe potenciali vjetor i kursimit	64
Tabela 21 Caku i kursimit vjetor të energjisë nga ndërtesat në të cilat do të aplikohen masa të EE	64
Tabela 22 Caku i kursimit vjetor të energjisë nga ndriçimi i rrugëve në të cilat planifikohet të ndërrohen llambat me ato LED	65
Tabela 23. Caku i kursimit te energjisë në raport me konsumin e përgjithshëm mesatar vjetor të energjisë nga ndërtesat publike komunale dhe ndriçimi i rrugëve	65
Tabela 24. Ndërtesat me potencial kursimi, të rekomanduar për zbatim të masave të EE në....	69
Tabela 25. Ndërtesat pa potencial kursimi të energjisë, të rekomanduar për zbatim të masave të EE në periudhën 2019-2021.....	70
Tabela 26. Ndërtesat më potencial kursimi të energjisë, te rekomanduar për renovim (Grupi 1)	71
Tabela 27. Ndërtesat qe nuk kanë potencial të kursimit të energjisë, të rekomanduar për renovim (Grupi 2).....	76
Tabela 28. Investimet në ndriçim sipas PKVEE	82
Tabela 29. Vlera financiare nëpër vite për krijimin e kapaciteteve dhe realizimin e studimit.....	83
Tabela 30. Vlera e planifikuar financiare nëpër vite për zbatimin e masave të EE në ndërtesa publike komunale dhe ndriçimin rrugor.....	84

Figurat

Figura 1. Pozita gjeografike e Komunës.....	19
Figura 2. Organogrami i komunës së Rahovecit	22
Figura 3. Pamje nga vreshtat dhe spërkatja e tyre.....	23
Figura 4. Pjesëmarrja e konsumit të energjisë elektrike në sektorët ekonomikë (%).....	26
Figura 5. Sasia e energjisë elektrike e konsumuar në periudhën 2016-2018.....	27
Figura 6. Rrjeti i energjisë elektrike.....	28
Figura 7. Sasia e naftës e konsumuar në periudhën 2016-2018	29
Figura 8. Basenet qymyrbajtëse të Kosovës	30
Figura 9. Sasia e linjtit të konsumuar në periudhën 2016-2018	31
Figura 10. Pyjet, kullosat dhe livadhet në komunën e Rahovecit.....	32
Figura 11. Sasia e drurit të konsumuar në periudhën 2016-2018.....	32
Figura 12. Sasia e peletit të konsumuar në periudhën 2016-2018.....	33
Figura 13. Konsumi i energjisë nga ndërtesat publike në tri vitet e fundit.....	37
Figura 14. Konsumi mesatar i energjisë sipas llojit të ndërtesave	37
Figura 15. Pjesëmarrja mesatare vjetore në përqindje të secilit burim energjetik	38
Figura 16. Konsumi specifik mesatar vjetor i energjisë sipas kategorive të ndërtesave	39
Figura 17. Konsumi mesatar vjetor i energjisë nga ndërtesat e administratës në periudhën 2016-2018.....	40
Figura 18. Pjesëmarrja mesatare vjetore në përqindje të secilit burim energjetik	40
Figura 19. Konsumi specifik mesatar vjetor në ndërtesat e administratës.....	41
Figura 20. Konsumi i energjisë nga ndërtesat e arsimit në periudhën 2016-2018	42
Figura 21. Pjesëmarrja mesatare në përqindje të secilit burim energjetik, në periudhën 2016-2018.....	42
Figura 22. Konsumi specifik mesatar vjetor për periudhën 2016-2018	43
Figura 23. Konsumi vjetor i energjisë nga ndërtesat shëndetësore në periudhën 2016-2018	44
Figura 24. Pjesëmarrja mesatare në përqindje të secilit burim energjetik në periudhën 2016-2018	44
Figura 25. Konsumi specifik mesatar vjetor për periudhën 2016-2018	45
Figura 26. Konsumi mesatar vjetor i energjisë nga ndërtesat e kulturës dhe sportit në periudhën 2016-2018	46
Figura 27. Konsumi specifik mesatar vjetor në ndërtesat e kulturës dhe sportit	47
Figura 28. Konsumi mesatar vjetor i energjisë nga ndërtesat në periudhën 2016-2018	48
Figura 29. Pjesëmarrja mesatare në përqindje të secilit burim energjetik në periudhën 2016-2018	48
Figura 30. Konsumi specifik mesatar vjetor për periudhën 2016-2018	49
Figura 31. Mënyra e furnizimit me ujë.....	52
Figura 32. Llojet dhe numri i llambave të ndriçimi publik në Rahovec.....	60
Figura 33. Konsumi mesatar vjetor dhe potenciali i kursimit të energjisë për kategoritë e ndërtesave publike komunale dhe ndriçimin rrugor.....	62
Figura 34. Potenciali vjetor i kursimit në % për kategoritë e ndërtesave publike komunale dhe ndriçimit rrugor	62
Figura 35. Emisionet aktuale vjetore të CO2 dhe potenciali vjetor i kursimit	63

Shkurtesat

AKEE	Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë
AKEREE	Asociacioni Kosovar për Energji të Ripërtërithshme dhe Eficiencë të Energjisë
AMF	Ambulanca e mjekësisë familjare
BE	Bashkimi Evropian
BRE	Burimet e Ripërtërithshme të Energjisë
EC	European Commission/Komisioni Evropian
EU	European Union/ Bashkimi Evropian
CFL	Compact Fluorescent Lamp- llambë fluoreshente kompakte
CO ₂	Dyoksidi i karbonit
CO ₂ eqv	Carbon dioxide equivalent
CMS	Control Management System
DCU	Data Collection Unit
EE	Eficienca e Energjisë
€/v	Euro në vit
GLN	Gazi i lëngëzuar i naftës
HC	Hidrocentrale
kcal	kilocalorie /Kilokalori
KEDS	Kompania Kosovare për Shpërndarjen e energjisë elektrike
KESCO	Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike
kgoe	Kilogram of oil equivalent
kJ	Kilojoules/ Kiloxhaulë
kV	Kilovolt
kWh	Kilovat orë
kWh/m ² /v	Kilovat orë për metër katror në vit
KP	Kompani private
KRM	Kompania Regjionale e Mbeturinave
ktoe	Kiloton oil ekuivalent
LCU	Light Control Unit
LED	Light-emitting diode
lit	Liter
m ²	Metër katror
m ³	Metër kub
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MW	Megavat
MWh	Megavat orë
MWh/v	Megavat orë në vit
Na	Natriumi
NVM	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
OSSH	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes
PVC	Polyvinyl chloride
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë familjare
QMF	Qendra e Mjekësisë familjare
sec	Sekond

SME	Softueri për Menaxhim të Energjisë
SHFMU	Shkolla Filllore e mesme e ulët
TC	Termocentral
UA	Udhëzimi Administrativ

1.Hyrje

Nevoja për të përshtatur politikën e zhvillimit komunal me kërkesat e vendit dhe politikat e reja të BE-së sa i përket reduktimit të emisioneve të gazrave serrë është një sfidë për secilën komunë, në këtë rast edhe për komunën e Rahovecit. Ajo kërkon veprime gjithëpërfshirëse që do të çojnë në uljen e kërkesës për ngrohje dhe energji elektrike si dhe reduktimin e përdorimit të lëndëve djegëse që janë ndotëse të ambientit. Adoptimit i një politike të tillë është një përpjekje për të ndërmarr veprime që çojnë në përdorimin e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë (BRE).

Komuna e Rahovecit synon të ndërtojë një të ardhme duke punuar në reduktimin e konsumit të energjisë, reduktimin e gazrave me efekt serë dhe me këtë minimizimin e shpenzimeve komunale përmes ngritjes së Eficiencës së Energjisë. Me Planin Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë, komuna i bashkëngjitet iniciativës mbarë botërore për energji të pastër dhe të qëndrueshme për të ardhmen.

Përmes PKVEE, komuna do të:

- Paraqes konsumin e energjisë, përmes një analize të gjendjes aktuale lidhur me konsumin energjetik në stokun e ndërtesave të menaxhuara nga komuna;
- Identifikojë sektorët prioritarë në të cilët nevojitet të bëhen ndërhyrje për ngritjen e eficiencës së energjisë;
- Krijohej data bazën, përmes së cilës mund të monitorohen dhe raportohen aktivitetet rreth masave që do të merren në fushën e EE;
- Krijojë një strukturë më të mirë organizative dhe funksionale me qëllim të ngritjes së EE;
- Paraqiten të dhëna lidhur me mundësitë e financimit, për projektet prioritare.

Plani Komunal për Eficiencë të energjisë (PKEE) është pjesë thelbësore e pakos së dokumenteve zhvillimore Komunale. Plani përfshin zhvillimin e komponentëve të ndryshme që ndërlidhen me sektorë apo nën-sektor që në mënyre aktive janë konsumatorë të energjisë. PKEE është dokument strategjik, i cili shërben si udhërrëfyes për hartimin e masave të mëtejme në nivelin lokal dhe që ndihmon në arritjen e caqeve nacionale për kursim të energjisë.

1.1 Konteksti

Meqenëse Kosova është palë nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, ka për obligim të harmonizojë ligjshmërinë e saj me direktivat përkatëse evropiane.

Gjithashtu Kosova është pjesëmarrëse aktive në takimet e Komunitetit të energjisë dhe në Grupin Koordinues për EE.

Bazuar në Direktivën për Eficiencën e Energjisë 2012/27 / EU, që ka hyrë në fuqi më 5 dhjetor 2012, Bashkimi Evropian ka vendosur objektiva për reduktimin e konsumit të energjisë primare në 20% deri në vitin 2020. Kosova si palë nënshkruese e TKE duhet të kontribuojë në arritjen e objektivave të eficiencës së energjisë, duke krijuar politika adekuate dhe stimuj për kursimin e energjisë.

Në këtë drejtim Kosova ka përgatitur Planin e veprimit i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (PVKEE) 2010-2018, i cili parasheh kursime të energjisë 9% ose rreth 92 ktoe, deri në vitin 2018. Plani i parë afatmesëm i veprimit i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (PVKEE) 2010-2012, tashmë i zbatuar dhe ka paraparë kursim të energjisë 3% ose rreth 31 ktoe, deri në vitin 2012 gjë që është arritur. Plani i dytë afatmesëm Kombëtar i Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PVKEE) 2013-2015, ku ishin paraparë kursimet prej 3% ose rreth 31 ktoe. Plani i tretë afatmesëm Kombëtar i Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PVKEE) 2016-2018, ku ishin paraparë kursimet prej 3% ose rreth 31 ktoe.

Aktivitetet në nivel lokal luajnë një rol të rëndësishëm në arritjen e objektivave të lartpërmendura në nivel kombëtar. Gjithashtu, komunat janë të obliguara të përgatisin planin komunal për EE, bazuar në nenin 9 të ligjit për EE Nr. 04/L-016.

1.1.1 Objektivat dhe përfitimet e PKVEE

Plani i EE për Komunën e Rahovecit është një dokument që analizon situatën aktuale dhe rekomandon veprimet dhe ndryshimet që duhet të ndërmerren për të ardhmen në sektorët e ndryshëm të shërbimeve komunale në lidhje me konsumin e energjisë. Në të janë analizuar dhe përfshirë të gjitha ndryshimet e nevojshme që duhet të ndërmerren për të rritur eficiencën në përdorimin e energjisë, sigurinë e furnizimit me burime energjetike, optimizimin e burimeve për mbulimin e nevojave me synim kryesor zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë për të ardhmen e komunës së Rahovecit.

Objektivi

Objektivi i përgjithshëm i PKVEE është zvogëlimi i konsumit të energjisë në ndërtesat publike, flotën komunale dhe ndriçimin publik, rritja e nivelit të rehatisë, zvogëlimi i kostos së shpenzimeve të energjisë si dhe krijimi i sistemit për menaxhimin e energjisë në komunën e Rahovecit.

PKVEE, pritet që në komunën e Rahovecit, të ndikojë si në vijim:

- Krijimin dhe zhvillimin e sistemit për menaxhim të energjisë;
- Krijimin e kapaciteteve profesionale për planifikim, monitorim dhe raportim;
- Ngritjen e vetëdijes për kursimin e energjisë të vendimmarrësit, operatorët, dhe përdoruesit fundor;

- Përmirësimin e shërbimeve komunale;
- Zvogëlimin e konsumit të energjisë në ndërtesat publike komunale, në ndriçimin publik dhe në transport;
- Reduktimin e kostove të energjisë për buxhetin komunal;
- Renovimin e sistemeve të energjisë dhe ndërtesave;
- Përmirësimin e kushteve sanitare dhe nivelit të rehatisë në ndërtesat publike;
- Ruajtjen e mjedisit dhe reduktimin e emetimeve të CO₂ dhe gazrave tjera me efekt serrë përmes zbatimit të masave të EE.

Përfitimet

- **Përfitimet financiare** - Kursimet në kostot e energjisë sjellin përmirësim të bilancit fiskal. Prandaj EE paraqet mundësi për komunën dhe sektorin publik për të zvogëluar buxhetin për kostot e konsumit të energjisë;
- **Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik** - Investimet në EE kanë ndikim pozitiv ekonomik, pasi ato kontribuojnë në zhvillimin e industrisë moderne që ofron punë dhe një sërë mundësish për zhvillimin e biznesit. Përveç kësaj, ato krijojnë të ardhura nga taksat për punët ndërtimore, të nevojshme për zbatimin e masave të EE;
- **Rritja e rehatisë** - Përmes investimeve në fushën e EE rritet rehatia, gjë që mund të ndikojë në rritjen e produktivitetit;
- **Siguria e furnizimit me energji** - Përmirësimi i efikasitetit të energjisë sjell besueshmëri dhe siguri më të madhe të furnizimit me energji dhe demonstroi gatishmërinë e komunës për të qenë shembull në promovimin e synimeve kombëtare për EE;
- **Mbrojtja e mjedisit** - Zvogëlimi i konsumit të energjisë, zvogëlon nevojën për rritjen e prodhimit dhe kapaciteteve të prodhimit të energjisë, kjo ndikon drejtpërdrejtë në zvogëlimin e emisioneve të dëmshme për ambientin.

1.1.2 Politikat dhe korniza ligjore

Plani Komunal i Veprimit për Eficiencë të Energjisë, për të qenë i zbatueshëm duhet të jetë në përputhje me politikat dhe legjisllacionin përkatës vendor.

Politikat

Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2017-2026 – e miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 26 janar 2018. Në kuadër të këtij dokumenti, Eficienca e energjisë në Kosovë, konsiderohet si një komponentë esenciale e planifikimit, zhvillimit strategjik dhe ekonomik të Kosovës. Në kuadër të strategjisë, është objektiv i pestë - plotësimi i caqeve dhe detyrimet për eficiencë të energjisë, burimeve të ripërtëritshme dhe mjedisit. Në kuadër të këtij objektiv janë planifikuar një sërë aktivitetesh për fushën e EE.

Programi i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë 2018-2020 - i miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me 17.07.2018. Në kuadër të programit, janë planifikuar një sërë masash në zbatim të EE në ndërtesat publike përfshirë hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore që rrjedhin nga ligji i ri për eficiencën e energjisë, zhvillimin e kapaciteteve në nivel qendror dhe lokal për zbatimin e politikave të Eficiencës së Energjisë, Zhvillimin e Planit të Veprimit për Eficiencën e Energjisë për periudhën 2019 e më tej sipas kërkesave të Direktivës 2012/27/EU dhe një studimi paraprak. Gjithashtu është planifikuar që deri në vitin 2020 të hartohet/miratohet Plani i Veprimit për Eficiencën e Energjisë për periudhën 2019-2021 dhe Plani i Veprimit për Eficiencën e Energjisë për periudhën 2019-2027.

Legjislacioni

Aktualisht, në Kosovë ekziston korniza ligjore bazë për sektorin e energjisë, që përgjithësisht është në përputhje me acquis të energjisë të Bashkimit Evropian (BE). Ndërsa legjislacioni primar për EE është Ligji Nr. 06/L-079 për Eficiencë të Energjisë.

Ky ligj:

- Përcakton kornizën ligjore të domosdoshme për promovimin dhe përmirësimin e eficiencës së energjisë në Republikën e Kosovës;
- Rregullon aktivitetet që kanë për qëllim zvogëlimin e intensitetit energjetik në ekonominë shtetërore dhe që i kontribuojnë zvogëlimin të ndikimit negativ në mjedis të aktiviteteve që ndërlidhen me sektorin e energjisë;
- Transponon Direktivën 2012/27/EU të datës 25 tetor 2012 për eficiencën e energjisë, duke ndryshuar Direktivat 2009/125/EC dhe 2010/30/ EU dhe duke shfuqizuar Direktivat 2004/8/ EC dhe 2006/32 /EU; dhe
- Siguron bazën ligjore për transpozimin e legjislacionit që ndërlidhet me kornizën e etiketimit të performancës energjetike për produktet e ndërlidhura me

energjinë.

Përveç ligjeve bazë të sektorit të energjisë, ekzistojnë një numër aktesh nënligjore të cilat janë në fuqi si Udhëzime Administrative (UA) dhe rregullore të ndryshme si:

- Udhëzimi Administrativ nr. 14/2012 për promovimin e efijencës së energjisë të përdoruesit fundor dhe shërbimet energjetike;
- Udhëzimi Administrativ nr. 09/2012 për pajisjet e etiketimit që përdorin energjinë
- Udhëzimi Administrativ nr. 01/2012 për Auditimin e Energjisë;
- Udhëzimi Administrativ nr. 09/2017 për Zyrat Komunale të Energjisë
- Rregullorja nr. 01/2012 për themelimin e Komisionit për Çertifikimin e Auditorëve dhe Menaxherëve të Energjisë;
- Udhëzimi Administrativ nr. 05/2017 për Caqet e Energjisë nga Burimet e Ripërtëritshme;
- Udhëzimi Administrativ nr. 06/2017 për Promovimin e Shfrytëzimit të Energjisë nga Burimet e Ripërtëritshme;
- Rregullorja nr.02/18 për metodologjinë kombëtare për kalkulimin e performancës së integruar energjetike të ndërtesave;
- Rregullorja nr.03/18 për procedurën e çertifikimit të performancës energjetike në ndërtesë;
- Rregullorja nr.04/18 për kërkesat minimale të performancës energjetike të ndërtesave;
- Rregullorja nr. 01/2018 për inspektimin e sistemeve të ngrohjes dhe sistemeve për kondicionim të ajrit.

1.2 Përmbledhje ekzekutive

PKVEE paraqet informacionin lidhur me konsumin e energjisë në ndërtesat publike komunale siç janë ndërtesat administrative, arsimore, kulturore dhe sportive, shëndetësore, ndërtesës së zjarrfikësve, mbrojtjes së pyjeve, të ndriçimit publik dhe flotës komunale të transportit.

Plani i Veprimit për Efijencën e Energjisë paraqet gjetjet dhe rekomandimet kryesore për energjinë në komunën e Rahovecit, sidomos për dy sektorët më të rëndësishëm të shërbimeve komunale atë të ndërtesave publike dhe ndriçimit rrugor. Plani është draftuar nga grupi i ekspertëve të AKEREE-së, në mbështetje të plotë të grupit punues komunal dhe në mbështetje financiare të GIZ-it.

Përmes Planit Komunal të Efijencës së Energjisë, komuna e Rahovecit promovon një planifikim afatmesëm për arritjen e objektivave mjedisore dhe ekonomike. Në kuadër të

këtij plani rëndësi e veçantë i është kushtuar potencialit të kursimit të energjisë dhe identifikimit të prioriteteve për investime në periudhën afatmesme.

Në komunën e Rahovecit:

- Konsumi mesatar vjetor i energjisë në periudhën 2016-2018 nga ndërtesat publike komunale dhe ndriçimi rrugor – 7,407.62 MWh/v;
- Konsumi mesatar vjetor i energjisë në periudhën 2016-2018 nga ndërtesat publike – 5,590.93 MWh/v;
- Potenciali vjetor i kursimit të energjisë në ndërtesat publike komunale – 1,820.01 MWh/v ose 32.55 %;
- Konsumi mesatar vjetor i energjisë në periudhën 2016-2018 nga ndriçimi rrugor - 1,816.69 MWh/v;
- Potenciali vjetor i kursimit të energjisë në ndriçimin rrugor – 232.41 MWh/v ose 12.76 % në raport me konsumin e përgjithshëm të energjisë elektrike (sipas konsumit të raportuar).

Më detajisht, konsumi aktual vjetor dhe potenciali i kursimit nga sektori i ndërtesave publike komunale dhe ndriçimi rrugor është i paraqitur në tabelën vijuese.

Tabela 1. Konsumi mesatar vjetor i energjisë dhe potenciali i kursimit nga ndërtesat publike komunale dhe ndriçimi rrugor

Konsumi mesatar vjetor i energjisë në periudhën 2016-2018								
	Administrative	Arsimore	Shëndetësore	Kulturore dhe sportive	Ndërtesa e zjarrfikësve dhe pylltarisë	Gjithsej ndërtesat publike komunale	Ndriçimi i rrugëve	Gjithsej
Nr. i ndërtesave	9	41	14	4	2	70	-	70.00
Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	5525.67	54857.38	6364.91	2354.76	909.10	70011.82	-	70011.82
Sipërfaqja që ngrohet (m ²)	2757.00	40673.90	4538.00	335.00	38.00	48341.90	-	48341.90
Konsumi mesatar vjetor i energjisë (MWh/v)	455.99	4150.96	880.92	40.29	62.77	5590.93	1816.69	7407.62
Kosto mesatare vjetore e energjisë (€/v)	33243.38	148675.58	69730.79	4283.46	5127.77	261060.98	54576.00	315636.98
Emissioni i t CO ₂ /v	291.88	730.35	582.25	57.93	59.41	1721.83	1215.15	2936.98
Potenciali i kursimit të energjisë								
Numri i ndërtesave me potencial kursimi	9	31	10	0	2	52	-	52.00
Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	5525.67	29167.79	5427.89	0.00	909.10	41030.45	-	41030.45
Sipërfaqja që ngrohet (m ²)	2757.00	19971.70	3858.00	0.00	38.00	26624.70	-	26624.70
Kursimi i energjisë (MWh/v)	164.20	1190.61	445.01	0.00	20.19	1820.01	232.41	2052.42

Investimet në ndërtesa me potencial kursimi (€)	117500.00	1625600.00	158000.00	0.00	25000.00	1926100.00	140646.00	2066746.00
Kursimi i t CO ₂ /v	92.55	209.38	310.37	0.00	17.75	630.05	333.74	963.79

Në kuadër të këtij plani, në komunën e Rahovecit pritet të arrihet caku i kursimit të energjisë prej 637.39 MWh/v ose 8.60%, krahasuar me konsumin aktual vjetor (të raportuar) nga sektori i ndërtesave publike komunale dhe ndriçimi rrugor. Me detajisht, caku i kursimit të energjisë në raport me konsumin e raportuar është i paraqitur në tabelën vijuese.

Tabela 2. Caku dhe niveli i kursimit të energjisë në raport me konsumin e përgjithshëm mesatar vjetor të energjisë në sektorin e ndërtesave publike komunale dhe ndriçimin e rrugëve

Sektori	Konsumi aktual mesatar vjetor i energjisë	Kostoja mesatare vjetore e konsumit të energjisë	Caku i kursimit të energjisë në kuadër të planit 2019-2021	Caku i kursimit të energjisë në kuadër të planit 2019-2021	Kosto e investimeve në masa të EE për plotësimin e caktit të kursimit të energjisë
	MWh/v	€/v	MWh/v	%	€
Ndërtesat publike komunale	5590.93	261060.98	405.55	7.25	942,000.00
Ndriçimi i rrugëve	1816.69	54576.00	231.84	12.76	140646.00
Gjithsej	7407.62	315636.98	637.39	8.6	1,082,646.00

Në kuadër të këtij plani janë identifikuar 13 ndërtesa publike komunale, në të cilat planifikohet të zbatohen masat e EE në periudhën 2019-2021.

Sa i përket ndriçimit rrugor, në kuadër të këtij plani është rekomanduar që masat për EE të zbatohen në të gjitha pjesët e ndriçimit që nuk janë me llamba LED. Kjo përfshin 35 rrugë të qytetit dhe 12 fshatra që janë të propozuar të zbatohen përmes 5 projekteve.

Kursimi i energjisë që do arrihet në kuadër të investimeve në raport me konsumin aktual vjetor të këtyre ndërtesave dhe ndriçimit rrugor të identifikuar për investime, është i paraqitur në tabelën vijuese.

Tabela 3. Kursimi i energjisë në ndërtesat dhe ndriçimin rrugor, të përzgjedhura për zbatim të masave të EE

Kategoria	Numri i ndërtesave/rrugëve për zbatim të masave të EE	Sipërfaqja e ndërtesave (m ²)	Sipërfaqja ngrohëse (m ²)	Konsumi mesatar vjetor i energjisë 2016-2018 (MWh/v)	Konsumi specifik mesatar vjetor i energjisë (kWh/m ² /v)	Kursimi vjetor i energjisë (MWh/v)	Kursimi vjetor i energjisë (%)	Investimet (€)
-----------	-------------------------------------------------------	-------------------------------------------	---------------------------------------	------------------------------------------------------	---------------------------------------------------------------------	------------------------------------	--------------------------------	----------------

Ndërtesa publike komunale	13	15171.14	10070.00	1163.17	175.18	405.55	34.87	942,000.00
Ndriçimi rrugor	35 rrugë dhe 12 fshatra	-	-	385.48	-	231.84	60.14	140646.00
Gjithsej	-	15171.14	10070.00	1548.65	-	637.39	41.16	1,082,646.00

2. Informacioni bazik rreth komunës

2.1 Pozita dhe topografia

Territori i komunës së Rahovecit përfshihet në regjionin e Prizrenit dhe ka një pozitë të mirë gjeografike. Shtrihet në pjesën qendrore të gadishullit Ballkanik dhe i takon Evropës juglindore. Ky territor përfshin pjesën qendrore dhe jugore të rrafshit të Dukagjinit dhe është i ndarë në tri tërësi ose mikro regjione. E këto janë: rrafshi-luginor, kodrinor dhe malor. Territori i komunës së Rahovecit zë një sipërfaqe prej 275.5 km². Në Veri kufizohet me Komunën e Klinës me distancë rreth 45 km, në Veri lindje me Komunën e Malishevës rreth 16 km, në Jug lindje me komunën e Suharekës rreth 17 km dhe atë të Mamushës, në Jug me komunën e Prizrenit 25 km, dhe në Perëndim me komunën e Gjakovës 28 km dhe në largësi nga kryeqendra e Kosovës (Prishtina) rreth 60 km. Në Komunën e Rahovecit temperaturat mesatare vjetore janë 11,68 °C.

Vendbanimet në komunën e Rahovecit shtrihen në lartësitë mbidetare prej 310 m Krusha e Madhe, deri në 920 m lartësi mbidetare Zatriqi.

Për kah lartësia mbidetare këto vendbanime ndahen në luginore-rrafshore, kodrinore dhe malore. Vendbanimet të cilat janë të përfshira në luginë ose rrafshina janë këto: (310 – 350 m.)¹ Xërxa, Fortesa, Gexha, Malësia e Vogël, Ratkoci, Denji, Dabidoli, Çifllaku, Nagaci, Hoça e Vogël dhe Retia.

Vendbanimet të cilat janë të përfshira në lartësitë mbidetare prej 350 – 600 m që i takojnë kategorisë së vendbanimeve kodrinore janë: Rahoveci, Drenoci, Senovci, Pastaselli, Palluzhë, Kramoviku, Mrasori, Hoça e Madhe, Apterushë, Zaçishti, Patoçani i Ulët, Patoçani i Epërm, Nashpalla, Bratotini, Baboc, Vranjaka, Celina dhe Krusha e Madhe (edhe pse disa pjesë të reja të vendbanimeve të këtyre fshatrave u takojnë pjesës së kategorisë së luginave ose rrafshinave.)

Vendbanimet malore shtrihen në lartësitë mbidetare prej 600 – 1.000 m e këto janë: Zatriqi, Kazniku dhe Drenoci.

¹ Plani Zhvillimor Komunal – 2013-2023 - Rahovec



Figura 1. Pozita gjeografike e Komunës

2.2 Klima²

Në territorin e Komunës së Rahovecit mbizotëron klimë kontinentale me ndikim mesdhetar. Faktorët më të rëndësishëm të cilët ndikojnë në klimën e kësaj hapësire janë: pozita e përshtatshme gjeografike, largësia e vogël e Rahovecit nga Deti Adriatik (102 km deri të gryka e derdhjes së lumit Drinit të Bardhë në detin Adriatik), lartësia mesatare mbidetare (rreth 308 në luginën e lumit të Drinit të Bardhë të Krusha e Madhe dhe 1.039 në majën e Zatriqit, që do të thotë mesatarja 550 m në tërë sipërfaqen e komunës), barriera e malit të Shkozës, Zatriqit dhe Koznikut, zhvillimi i mirë i botës bimore dhe shtazore (livadhet, kullosat, të mbjellurat dhe pyjet) etj. Klima me tipare të mesme mesdhetare ndihet rreth lumit Drini i Bardhë si dhe në këto vendbanime: Krushë e Madhe, Celinë, Fortesë, Xerxë, Gexhë, Ratkoc dhe Çifllak. Klima me ndikim kontinental ndikon në malet e Koznikut, Zatriqit dhe Shkozës³.

Në Komunën e Rahovecit temperaturat mesatare vjetore janë 11.680 °C. Maksimumi absolut paraqitet në muajin Korrik prej 38.50 C, ndërsa minimum në muajin shkurt me – 14.50°C. Muaji më i nxehtë është Korriku me temperaturë deri në 38,5 °C dhe më i ftohti është muaji Shkurt me temperaturë -18 °C.

² <https://kk.rks-gov.net/rahovec/qyteti/pozita-gjeografike/>; Plani Zhvillimor Komunal - Rahovec;

https://sq.wikipedia.org/wiki/Rahoveci#Kushtet_klimatike

³ Plani Zhvillimor Komunal-RAHOVEC

Reshjet maksimale në Rahovec janë 1047.2 mm, ndërsa minimale janë 609.9 mm. Mesatarja e reshjeve është 707.7 mm. Të reshurat e dëborës janë më të mëdha në Rahovec, në muajin Janar. Në Rahovec, mesatarisht janë 15.7 ditë me borë. Rahoveci ka mesataren vjetore me mjegull prej 19.7 ditë apo 5.4 %.

Më së shpeshti fryjnë erërat e veriut (11.8 %), veri-lindja (62 %), dhe perëndimi (50 %), ndërsa më së paku fryjnë erërat e lindjes (17 %), jugut (14 %) dhe jug-lindja (4 %).

Në tabelën me poshtë janë të paraqitura të dhënat lidhur me rrezatimin diellor në komunën e Rahovecit. Të dhënat janë për lokacionin: Vendndodhja: 42°23'47 "Veri, 20°39'10" Lindje, dhe lartësi: 395 m.

Tabela 4. Rrezatimit mujor diellor në komunën e Rahovecit⁴

Month	H_h	H_{opt}	$H(45)$	I_{opt}	T_{24h}	N_{DD}
Jan	1460	2150	2300	59	3.9	510
Feb	2230	3020	3160	53	5.2	415
Mar	3810	4660	4710	42	9.4	309
Apr	4840	5270	5110	28	14.1	146
May	5790	5760	5390	15	18.7	32
Jun	6770	6430	5880	8	23.3	7
Jul	7080	6910	6370	13	26.9	0
Aug	6280	6700	6400	24	27.4	14
Sep	4400	5310	5320	39	22.0	63
Oct	3060	4220	4410	52	15.1	231
Nov	1750	2620	2810	59	10.6	405
Dec	1170	1720	1840	60	4.7	526
Year	4070	4570	4480	32	15.1	2658

Ku janë:

H_h - Rrezatim në planin horizontal ($Wh/m^2/ditë$)

H_{opt} - Rrezatimi në planin e pjerrtë optimal ($Wh/m^2 / ditë$)

$H(45)$ - Rrezatim në planin këndor prej 45 shkallë ($Wh/m^2/ditë$)

I_{opt} - Këndi optimal i pjerrtësisë

T_{24h} - Temperatura mesatare për 24 orë ($^{\circ}C$)

N_{DD} - Numri i gradë ditëve të ngrohjes.

2.3 Popullsia dhe vendbanimet⁵

⁴ <http://re.jrc.ec.europa.eu/pvgis/apps4/pvest.php?lang=en&map=europe>

⁵ Plan i Zhvillimor Komunal 2013-2023 - Rahovec

Në komunën e Rahovecit jetojnë rreth 56208 banorë¹. Kjo popullsi jeton në gjithsej 36 vendbanime dhe në një sipërfaqe prej 275.5 km². Nga kjo del se mesatarisht në këtë komunë jetojnë rreth 204 banorë në një km².

Numri i popullsisë në komunën e Rahovecit ka shënuar një rritje të konsiderueshme me rreth 35921 banorë prej vitit 1948 deri në vitin 2011. Pra në bazë të kësaj rritje del se mesatarisht popullsia ka shënuar rritje prej 552 banorë në vit. Brenda periudhë kohore 65 vjeçare popullsia e Rahovecit është rritur gati për tri herë.

Popullsia e komunës së Rahovecit jeton në gjithsej 36 vendbanime, prej tyre 35 janë fshatra dhe vetë qyteti i Rahovecit. Këto vendbanime kanë dallime të theksuara sa i përket numrit të popullsisë. Në qytetin e Rahovecit jetojnë rreth 15892 banorë që do të thotë se rreth 28 % e popullsisë së tërësishme jeton në këtë qytet, ndërsa në të gjitha vendbanimet tjera jetojnë rreth 40316 banor apo rreth 72 %.

Tabela 5. Vendbanimet dhe numri i banorëve në Komunën e Rahovecit

Nr.	Vendbanimet	Numri i banorëve	Nr.	Vendbanimet	Numri i banorëve
1	Bellacrkë	2270	19	Opterushë	1911
2	Bërnjak	40	20	Pastasellë	1011
3	Bratotin	396	21	Pataqan i Epërm	533
4	Brestovc	1288	22	Pataqan i Ultë	1077
5	Celinë	1903	23	Petkoviç	731
6	Çifllak	1292	24	Polluzhë	808
7	Dabidol	799	25	Radostë	2346
8	Denjë	1755	26	Rahovec	15892
9	Drenoc	1587	27	Ratkoc	3791
10	Gexhë	660	28	Reti e Ulet	234
11	Hoçë e Madhe	124	29	Retijë	771
12	Hoçë e Vogël	1166	30	Sapniç	996
13	Kaznik	164	31	Sarosh	6
14	Kramovik	1125	32	Senoc	687
15	Krushë e Madhe	4473	33	Vrajakë	838
16	Mrasor	191	34	Xërxë	3184
17	Nagavc	743	35	Zatriç	535
18	Nushpal	220	36	Zoçishtë	659

2.4 Struktura organizative e komunës së Rahovecit

Komuna e Rahovecit funksionon në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040), Statutit të saj dhe akteve të tjera nënligjore. Ky ligj përkufizon statusin ligjor të komunave, kompetencat dhe parimet e përgjithshme të financave komunale organizimin dhe funksionimin e organeve komunale, marrëdhëniet brenda komunale

dhe bashkëpunimin ndër komunal, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkufitar dhe marrëdhëniet ndërmjet komunave dhe pushtetit qendror.

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në Komunë dhe zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët në pajtim me Ligjin mbi Zgjedhjet Lokale. Kuvendi i Komunës ka 31⁶ anëtarë, miraton Statutin dhe e ndryshon atë nëse konsideron se një gjë e tillë është e nevojshme.

Shërbimet e Komunës së Rahovecit të qytetarët, janë të ndryshme dhe të shumta, duke filluar nga rregullimi i dokumenteve të statusit civil deri në projektet kapitale. Struktura organizative e komunës së Rahovecit është e paraqitur në organogramin, si me poshtë




Figura 2. Organogrami i komunës së Rahovecit⁷

2.5 Treguesit ekonomik dhe financiar

Komuna e Rahovecit me prodhim të verës dhe token pjellore ka potenciale të mëdha për zhvillime në të ardhmen. Zhvillimi ekonomik në komunën e Rahovecit është i orientuar me së shumti në bujqësi, vreshtari dhe perim-kulturë. Afro 65% e popullatës është vlerësuar së sigurojnë ekzistencën nga aktivitetet bujqësore. Mesatarja vjetore e të ardhurave për një fermer është përafërsisht 2500 deri 3000 €. Komuna e Rahovecit disponon me rreth 50 % të sipërfaqeve të vreshtave të Kosovës si dhe kapaciteteve përpunuese.

⁶ Profili i komunave të Republikës së Kosovës -Komuna e Rahovecit- MAPL

⁷ <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2019/01/Organogrami-Komuna-Rahovec.pdf>

Duke marrë parasysh kushtet e favorshme topografike, klimatike dhe agro-ekologjike, puna në bujqësi, vreshtari dhe vrerari përbën aktivitetin themelor ekonomik në Rahovec, në të gjitha aspektet duke përfshirë prodhimin, burimin e të ardhurave dhe punësimin.

Sipas shënimeve të Entit Statistikorë, Komuna e Rahovecit disponon me 13600 hektar tokë bujqësore, sipërfaqet e tokës bujqësore të cilat gjenden përgjatë shtratit të lumit Drini i Bardhë në lartësi mbidetare prej 310 – 350 m, është tokë me pjellori të lartë në të cilat kultivohen kulturat bujqësore intensive, siç janë perimet (speci, domate, patate, tranguj, shalqiri, karrota e tjera) dhe kulturat lavërtarë (gruri, misri). Në tokat kodrinore, në lartësi mbidetare prej 350 – 600 m. gjendet toka e tipit Smonicë ku kultivohen kulturat lavërtare pranverore dhe vjeshtore dhe kulturat shumëvjeçare kullosat. Më kulturat lavërtare vjeshtore mbillen rreth 2.400 hektar, ku kryesisht mbillet gruri. Në bazë të dhënave, rendimenti mesatar i grurit është 3,5 t/ha.

Në komunën e Rahovecit ekziston sistemi i ujitjes me të cilin menaxhon Kompania Regjionale e Ujitjes (KRU)-Radoniqi, me seli në Gjakovë. Me këtë sistem ujiten 2,658.63 hektar tokë të punueshme bujqësore. Sipërfaqja e përgjithshme e vreshtave në komunën e Rahovecit është 2168 Ha, me trend të rritjes.



Figura 3. Pamje nga vreshtat dhe spërkatja e tyre

Sektori i industrisë në Komunën e Rahovecit, bazohet kryesisht në industrinë agro-industriale, përpunimin e rushit dhe të grurit, industrinë e plastikës, ndërtimtarisë, teknologjinë përpunuese të metaleve, teknologjive për ngrohje dhe ftohje, artizanale, tregti, shërbime etj. Pas luftës, ndërmarrjet e vogla kanë shfaqur tendencën për shfrytëzimin dhe përpunimin e gurit, rërës, zhavorrit dhe argjilës.

Duke e pasur parasysh nivelin e përgatitjes profesionale dhe shpirtin ndërmarrës, shumë individë kanë filluar me biznese individuale dhe familjare duke trasuar rrugën për një të ardhme dhe duke u bazuar në ekonominë e tregut, si e vetmja perspektivë zhvillimore.

Në komunën e Rahovecit veprojnë 1000 biznese private, dhe veprimtaria e tyre është prodhuese, industriale, shërbyese dhe tregtare. Problemi i nivelit të lartë të papunësisë në nivel të Kosovës, reflektohet edhe në Komunën e Rahovecit.

Tabela 6. Buxheti i komunës së Rahovecit për vitin 2018

Rahovec	2018 në €
Buxheti total	13,660,103.00
Totali i faturave të energjisë	371584.62
Ndërtesat publike – (përfshi energjinë elektrike)	273,356.97 ⁸
Ndriçimi publik	57,878.77 ⁹
Flota e komunës (karburant për automjete)	40,348.88
TOTALI i investimeve në masa të EE	291.396,70€

2.6 Ndërlidhja me politikat e tjera lokale dhe rajonale

Zhvillimi i planit të efijencës së energjisë është bazuar në analizën e të dhënave komunale për energjinë, për periudhën 2016-2018 dhe parashikon një periudhë zbatimi nga 2019 deri në 2021. PKVEE ndërlidhet edhe me një numër të dokumenteve tjera si:

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit 2016-2021- në kuadër të këtij dokumenti, Shtylla 4 përfshin: infrastrukturën me 4 masa prioritare, masa 3 - ulja e konsumit të energjisë përmes masave të efijencës së energjisë.

Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2017-2021- masa e pestë- Plotësimi i caqeve dhe obligimeve për efijencë të energjisë dhe Burime të Ripërtërishme të Energjisë, në kuadër të së cilës theksohet: Kosova është zotuar në përbushjen e caktit të kursimit prej 9% nga konsumi i gjithmbarshëm i energjisë, cak i vendosur sipas Direktivës 2006/32/EC të BE-së. Gjithashtu ka marrë obligimet për zbatimin e politikave të reja të BE-së që burojnë nga Direktiva Evropiane 2012/27/EC për efijencën e energjisë.

Programi i Kosovës për Reforma në Ekonomi-masa 2- Ulja e konsumit të energjisë nëpërmjet masave të efijencës së energjisë – kjo masë synon të kontribuojë në arritjen e caktit të kursimit të energjisë për 9%, nëpërmjet zbatimit të masave të EE dhe burimeve të ripërtërishme të energjisë në sektorin publik dhe residential, dhe duke vendosur kornizën ligjore për efijencë të energjisë në sektorin privat. Kjo masë është e ndërlidhur me rekomandimin e politikave nga Dialogu Ekonomik dhe Financiar ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, 23 maj 2017.

Plani Zhvillimor Komunal – Rahovec – Plani zhvillimor është dokument, i hartuar për territorin e komunës për periudhën kohore deri në vitin 2020 dhe jep udhëzime konkrete për veprimet që duhet të ndërmerren në përmirësimin e jetës së qytetarëve të komunës

⁸ Kosto e llogaritur nga të dhënat e pranuar

⁹ Kosto e llogaritur nga të dhënat e pranuar

së Rahovecit, duke ndikuar në ngritjen e kualitetit social, ekonomik dhe fizik të hapësirës përkatëse.

Plani Komunal për Eficiencë të Energjisë 2015 -2020- është përgatitur sipas Ligjit për Eficiencën e Energjisë 04 / L-016 dhe paraqet dokumentin e Komunës i cili është përqendruar në adresimin e eficiencës së energjisë në nivelin komunal. Sipas këtij plani, Komuna e Rahovecit i ka vënë vetës si qëllim një kursim prej 27% të konsumit total të energjisë deri në vitin 2020 në stokun e ndërtesave publike dhe ndriçim publik, sektorë nën menaxhimin e drejtpërdrejt të Komunës, dhe ky plan, i pari i llojit të vet për komunën e Rahovecit, ka shërbye si udhëzues për arritjen e këtij qëllimi. Gjithashtu, ky plan adreson konsumin energjetik në stokun e ndërtesave dhe ndriçimin publik në pronësinë dhe nën menaxhimin e Komunës së Rahovecit.

2.7 Përvoja në zbatimin e masave të EE

2.7.1 Kapacitetet në zbatimin e projekteve

Në vitet e fundit, komuna e Rahovecit ka zbatuar një numër të madh të projekteve në fushën e EE. Kjo dëshmon se stafi i komunës ka përvojë mjaft të mirë në zbatimin e masave të EE. Përvoja e tyre lidhet, sidomos në përgatitjen e TeR/specifikacionit teknik, tenderimit, mbikëqyrjes, monitorimit dhe raportimit lidhur me rezultatet e arritura.

Komuna e Rahovecit e ka të caktuar zyrtarin për energji, mirëpo edhe më tej nuk ka zyre për energji sipas Udhëzimit Administrativ nr. 09/2017, e cila do koordinojë aktivitetet me sektorë të tjerë në proces të realizimit të projekteve. Me krijimin dhe funksionalizimin e sistemit komunal për menaxhimin e energjisë dhe me vendosjen e të dhënave në softuerin SME, zyrtari komunal i energjisë do të ketë më të lehtë menaxhimin e të dhënave nga terreni për ndërtesat publike komunale dhe ndriçimin publik, si dhe në krijimin e Planit Komunal të Veprimtë për Eficiencë të Energjisë (PKVEE). Ky softuer është një mjet i cili do të lehtësojë procesin e planifikimit, monitorimit dhe raportimit lidhur me projektet në fushën e EE.

Tabela 7. Investimet e realizuara ne masat e EE në periudhën 2016-2018

Masat kryesore të Eficiencës së Energjisë	Kostoja në (€) nëpër vite		
	2016	2017	2018
<ul style="list-style-type: none"> • Instalimi i ngrohjes qendrore • Ndërrimi i dritareve dhe izolimi i kulmit • Ndërrimi i dyshemesë • Hidroizolimi dhe termoizolimi i dyshemeve të klasave • Ndërrimi i dritareve dhe masa termoizoluse • Ndërrimi i trupave ndriçues nga ata të natriumit në trupa ndriçues me llamba LED • Ndriçim i ri • Ndërrimi i dritareve nga druri me dritare nga PVC me dy shtresa xhami 	194.571,10€	165.779,52€	291.396,70€

3. Furnizim me energji, prodhimi dhe shpërndarja

3.1 Furnizimi me energji

3.1.1 Energjia elektrike

3.1.1.1 Furnizim me energji elektrike

Problemi i furnizimit me energji elektrike në Kosovë e ka gjenezën në shkatërrimin e qëllimshëm të sistemit të energjisë elektrike, në të gjitha elementet e tij, nga regjimi pushtues, veçanërisht në vitet e 90-ta. Që nga viti 1984 nuk ka pasur ndërtime të kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë elektrike, me përjashtim të disa kapaciteteve të vogla hidrike, por që nuk kanë pasur ndikim në zgjidhjen e problemit të sigurisë së furnizimit me energji elektrike. Aktualisht shumica e blloqeve të termocentraleve janë në fundin e jetës së tyre teknike. Sikur të kishte pasur një zhvillim në kushte stabile të furnizimit me energji elektrike, praktikisht të gjitha kapacitetet gjeneruese të TC "Kosova A" do të duhej të ishin ose të dekomisionuara ose të rehabilituara (siç ka ndodhur në shumicën e rasteve të ngjashme në vendet e Evropës Jug-Lindore(EJL)).

Me gjithë problemet dhe vështirësitë me të cilat është përballur sistemi i prodhimit të energjisë elektrike, në 15 vitet e fundit ka pasur rritje të vazhdueshme në prodhimin e energjisë elektrike.

Se si qëndrojnë sektorët në konsumin e energjisë elektrike në nivel vendi, tregon figura e mëposhtme.




Figura 4. Pjesëmarrja e konsumit të energjisë elektrike në sektorët ekonomikë (%)¹⁰

Nga figura më lartë shihet se sektori i amvisërisë në nivel vendi është konsumuesi më i madh i energjisë elektrike, me rreth 59%.

Në komunën e Rahovecit, energjia elektrike përdoret për ndriçim, për pajisje elektrike, në disa raste edhe për ngrohje. Sasia e energjisë elektrike e konsumuar nëpër vite në

¹⁰ Balanca Vjetore e Energjisë në Republikën e Kosovës për vitin 2018-ASK

periudhën 2016-2018 nga ndërtesat publike dhe ndriçimi publik është paraqitur në figurën me poshtë.




Figura 5. Sasia e energjisë elektrike e konsumuar në periudhën 2016-2018

3.1.1.2 Shpërndarja e energjisë elektrike

Mbulimi i kërkesave për energji elektrike bëhet nga prodhimi vendor dhe një pjesë nga importi. Prej vitit 2000 deri në vitin 2015 janë shpenzuar 538.25 milionë euro për importin e energjisë elektrike. Në disa raste ka pasur ndërhyrje të Qeverisë për subvencionimin e importit, që nga viti 2012 janë ndërprerë subvencionimet për import.

Pas privatizimit të kompanisë për shpërndarje dhe furnizim të energjisë elektrike, kostoja e importit të energjisë elektrike ka rënë ndjeshëm, veç tjerash edhe si pasojë e procedurave më efikase të blerjes së energjisë elektrike. Kapacitetet infrastrukturore të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike nuk kanë mundur të përcjellin në masën e duhur rritjen e kërkesës, si pasojë, në radhë të parë, e investimeve të pakta në rrjetin shpërndarës. Për pasojë sistemi i shpërndarjes së energjisë elektrike është tej ngarkuar vazhdimisht, veçanërisht gjatë sezonit të dimrit.

Në maj të vitit 2013 sistemi i shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike ka kaluar në pronësi private. Në fund të vitit 2014 ka përfunduar procesi i shturjes ligjore të OSSH-së nga aktiviteti i furnizimit. Në vitet e fundit, sidomos pas privatizimit të rrjetit të shpërndarjes, janë bërë investime mjaft të mëdha në rrjetin e shpërndarjes (rreth 20 milionë euro në vit) dhe vazhdohet të investohet në projekte të planifikuara nga OSSH-ja.

Rrjeti elektro energjetik në Komunën e Rahovecit është përmirësuar pas përfundimit të projektit për ndërtimin e TS 110/35/10(20)kV i cili ndodhet në dalje të Rahovecit në

drejtimin e Xërxes, dhe linja 110 kV nga Theranda në Rahovec. Linja kabllorike 35kV fillon nga TS 110/35/10(20)kV – Rahovec dhe furnizon trafo stacionet ekzistuese: TS 35/10(20)kV – Rahovec dhe TS 35/10(20)kV – Xerxë. Gjithashtu edhe linjat kabllorike te reja nga TS i RI 110/35/10(20) kV deri te 35/10(20) kV kanë ndihmuar në përmirësimin e situatës elektroenergjetike.

Pra rrjeti i energjisë elektrike të tensionit të lartë dhe të mesëm në komunën e Rahovecit është mjaft mire i mbuluar, shikuar nga aspekti i furnizimit me energji elektrike, edhe pse në disa pjese të caktuara të komunës nevojitet shtimi i kapaciteteve, pra transformatorë për përmirësim të mëtejshëm të rrjetit elektrik në komunë. Në përgjithësi kërkohet që kapaciteti i rrjetës energjetik në të gjitha drejtimet të ketë rritje, përkatësisht duhet të vazhdohet rritja e kapacitetit të rrjetit energjetik nga 10 kV në 20 kV. Përveç shtimit të transformatorëve nevojitet edhe përmirësimi i rrjetit elektrik të tensionit 10(20)kV si dhe 0.4kV. Në zonat rurale duhet të bëhet ndërrimi i shtyllave elektrike të drurit me ato të betonit, kurse në zonën e qytetit një pjesë e rrjetit është e përmirësuar me vendosjen e kanaleve nëntokësorë të kabllorëve 10(20) kV qe lidh nënstationin elektrik 35kV me nënstationet 10/0.4 kV.

Zëvendësimi i përçuesve të zhveshur me kablo ajrore në zonat rurale dhe me kablo nëntokësore në zonat urbane gjithashtu duhet të kryhet brenda një periudhe sa më të shkurtër. Rrjeti primarë dhe sekondarë i energjisë elektrike në Komunën Rahovecit është paraqitur në figurën e mëposhtme.




Figura 6. Rrjeti i energjisë elektrike

3.1.2 Derivatet

3.1.2.1 Nafta

Karburantet e lëngëta: Nafta, Mazuti, Gazi i Lëngëzuar i Naftës (GLN) importohen dhe janë të shtrenjta, por ofrojnë komoditet të mirë për ngrohje. GLN është një burim eficient, miqësor me ambientin. Ekziston një treg relativisht i mirë i furnizimit nga sektori privat me tendencë rritjeje.

Në Kosovë nuk ka prodhim të naftës dhe gazit natyror. Në Kosovë, nuk ka rafineri naftë dhe duhet theksuar se nënproduktet e naftës zënë një pjesë të rëndësishme të furnizimit të burimeve energjetike në nivel vendi dhe në nivel komune.

Sipas të dhënave nga komuna e Rahovecit, nafta është derivati i vetëm që është konsumuar për ngrohje. Në periudhën 2016 - 2018 është konsumuar mesatarisht 86,434.33 litra në vit.

Gjithashtu nafta është karburant që përdoret për flotën komunale, në periudhën 2016 deri në vitin 2018 janë konsumuar 87,003.50 litra.

Në figurën me poshtë është paraqitur sasia e naftës e konsumuar në periudhën 2016-2018 për ngrohjen e ndërtesave publike.




Figure 7. Sasia e naftës e konsumuar në periudhën 2016-2018


3.1.3 Qymyri

Kosova ka rreth 12.5 miliardë ton të linjitit si rezerva gjeologjike, duke e vendosur Kosovën në vendin e dytë në Evropë dhe në vendin e pestë në botë me këto rezerva.

Linjiti është resursi më i rëndësishëm energjetik i Kosovës, i cili furnizon 97% të prodhimit total të energjisë elektrike (TC "Kosova A" dhe TC "Kosova B").

Hulumtimet e para të qymyrit në Kosovë kanë filluar në fillim të shekullit XX, ku është konstatuar se në Kosovë ekzistojnë rezerva të mëdha të qymyrit. Në vitin 1922 fillon shfrytëzimi nëntokësor në minierën e Hadës e më vonë edhe në Babush të Lipjanit. Hulumtimet sistematike gjeologjike të qymyrit në basenin e Kosovës kanë filluar në periudhën kohore 1952-1957. Gjatë kësaj periudhe është bërë përgatitja për kalimin e shfrytëzimit të qymyrit në basenin e Kosovës, nga shfrytëzimi nëntokësor në atë sipërfaqësor duke shqyrtuar mundësitë e shfrytëzimit masiv për nevojat e termocentraleve për prodhimin e energjisë elektrike dhe përpunimin industrial të qymyrit.

Tabela 8. Rezervat qymyrit në Republikën e Kosovës



Basenet qymyrbajtëse	REZERVAT (t)		
	Gjeologjike	Bilance*	Jo bilance**
Kosovës	10,091,000,000	8,772,000,000	1,319,000,000
Dukagjinit	2,244,830,000	2,047,700,000	197,130,000
Drenicës (f. Skenderaj)	106,631,000	73,188,000	33,443,000
Gjithsej	12,442,461,000	10,892,888,000	1,549,573,000

Figura 8. Basenet qymyrbajtëse të Kosovës

Sipas të dhënave nga komuna e Rahovecit, thëngjilli i llojit linjit është burimi energjetik që përdoret për ngrohje të disa ndërtesa. Në disa raste përdoret në kombinim me drurin. Sipas të dhënave në periudhën 2016-2018, mesatarisht është konsumuar 368.03 ton/vit.

Në figurën me poshtë është paraqit sasia e linjtit e konsumuar nëpër vite në periudhën 2016-2018 për ngrohjen e ndërtesave publike komunale.

* Rezervat bilance janë ato rezerva ku fuqia kalorike e qymyrit është mbi 5.450 kJ/kg

** Rezervat jashtë bilance janë ato rezerva ku fuqia kalorike e qymyrit është nën 5.450 kJ/kg




Figure 9. Sasia e linjtit e konsumuar në periudhën 2016-2018

Nga figura vërehet se në vitin 2018 ka pasur zvogëlim të theksuar të përdorimit të linjtit për ngrohje, kjo është për faktin e përdorimit të burimeve tjera si druri dhe peleti dhe në respektim të Vendimit Nr.06/74 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, i nxjerr me datë 06.11.2018, përmes të cilit ndalohet përdorimi i thëngjillit për ngrohje në ndërtesat e institucioneve publike. Për zbatimin e këtij vendimi janë të obliguara institucionet qendrore dhe lokale.

3.1.4 Biomasa- Druri i zjarrit

Sipërfaqja pyjore në Kosovë është mjaft e qëndrueshëm me rreth 481 000 ha (44.7% e sipërfaqes totale). Rreth 38% e sipërfaqes pyjore është në pronësi private, ndërsa 62% janë pyje publike. Pyjet e pastra fletore mbulojnë pothuajse 83% të sipërfaqes pyjore.

Në Komunën e Rahovecit, në pjesën kodrinore dominojnë pyjet me mjaft lloje dhe janë të përziera. Dallohen pyjet gjetherënëse si: qarri (*quercus cerris*) dhe bungu me rreth 80 %, ahu (*fagus sylvatica*), shkoza (*carpinus orientalis*). Përhapje më të kufizuar kanë llojet tjera që paraqiten si të vetmuara si: brekia, bliri (*tilia kordata*), frashri, dëllinja etj. Janë prezentë edhe llojet tjera si: thana (*cornus mas*), murrizi (*crataegus monogyna*), kaça (*rosa canina*), manaferra e egër (*rubus fruticosus*), shtogu (*sambucus nigra*), kulumbria (*prunus spicosa*), lajthia (*corylus avellana*), dhe në vise të larta fieri shqiponjë (*pteridium aquilinum*) etj.

Sipërfaqja e përgjithshme e pyjeve në dy sektorët është rreth 10800¹¹ ha , ku sektori privat ka rreth 1500 ha dhe ai publik 9300 ha. Sipërfaqja e përgjithshme e komunës së Rahovecit është e mbuluar me pyje rreth 6065 ha, ndërsa 3205 ha janë sipërfaqe

¹¹ Plan i Zhvillimor Komunal-RAHOVEC

malore e zhveshur. Degradimet e pyjeve janë dukuri sikur në çdo pjesë të Kosovës, e sidomos prerjet ilegale, ku rreth 2200 ha në bazë të dhënave komunale rezultojnë si të degraduara.




Figura 10 Pyjet, kullosat dhe livadhet në komunën e Rahovecit

Zakonisht druri i cili përdoret për ngrohje është i sapo prerë, kjo për faktin se nuk ka hapësira adekuate për terjen e drurit. Në figurën më poshtë është paraqitur sasia e drurit të konsumuar nëpër vite në periudhën 2016-2018 për ngrohjen e ndërtesave publike komunale.




Figure 11. Sasia e drurit e konsumuar në periudhën 2016-2018

Vërehet rritje e sasisë së përdorimit të drurit për ngrohje në vitin 2018 krahasuar me vitet tjera, kjo është për faktin e zvogëlimit të përdorimit të linjitit për ngrohje.

3.1.4.1 Peleti

Peleti është një produkt energjetik që fitohet në mënyrë artificiale nga biomasa me origjinë drusorë, respektivisht nga byku (tallashi), ashklat, pjesët e imëta dhe lëvorja e drurit. Diametri i peletit sillet rreth 6-12 mm kurse gjatësia tij 5-45 mm. Dendësia e peletit të hedhur (grumbullit të peletit duke përfshirë zbrazëtirat) sillet rreth 650 kg/m^3 , përmbajtja e lagështisë nga 8-10 % kurse nxehtësia e djegies 4.9-5.4 kWh/kg.

Në figurën më poshtë është paraqitur sasia e peletit e konsumuar nëpër vite në periudhën 2016-2018 për ngrohjen e ndërtesave publike komunale.




Figure 12 Sasia e peletit e konsumuar në periudhën 2016-2018

3.2 Prodhimi i energjisë

3.2.1. Prodhimi i energjisë prej Burimeve të Ripërtërishme

Në komunën e Rahovecit nuk ekzistojnë centrale të cilat prodhojnë energji elektrike. Përndryshe, sipas informacionit nuk ka ndonjë kapacitet tjetër nga BRE për tu konsideruar. BRE-të janë burim energjetik për të ardhmen, dhe kjo është e rekomandueshme sidomos të qendrat e mjekësisë për ngrohjen e ujit sanitar. Aktualisht nuk ekziston një furnizues i gazit natyror për asnjë zonë të Kosovës dhe as për Rahovecit.

Komuna e Rahovecit ka potencial të vlerësuar dhe të matur për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese të energjisë elektrike nga era. Zona me potencial për energji nga turbinat e erës gjendet në malin Zatriq të Rahovecit. Sipas studimit të NEK Umwelttechnik AG (2010), rezultatet e matjes së shpejtësisë së erës në lartësinë 47 m japin rezultate të mira për gjenerim të energjisë elektrike. Po sipas këtij studimi ka potencial për ndërtimin e një parku të erës me kapacitet rreth 20 MW. Rezultatet e llogaritjes së parkut (me modelin e turbinës RE power MM 92, 2 MW) japin një prodhim vjetor të energjisë elektrike prej 36400 MWh, duke rezultuar në një prodhim mesatar vjetor prej 3630 MWh dhe 1640 orë në ngarkesë të plotë për një turbinë. Shpejtësitë mesatare të erës në vende të turbinave radhiten prej 4.8-5.7 m/s, me një mesatare prej 5.3 m/s.

Duket se potenciali i gjenerimit të energjisë elektrike nga era është atraktiv për investitorët. Ky interesim shihet edhe te kompania "EV Wind Park" Sh.p.k¹², e cila me 29.03.2018 ka marrë autorizimin preliminar nga ZRRE për të ndërtuar parkun e erës për gjenerim të energjisë elektrike në Zatriq me kapacitet 32.4 MW..

3.2.2. Prodhimi i energjisë për ngrohje

Në komunën e Rahovecit nuk ka ngrohore qendrore të qytetit. Ndërtesat që menaxhohen nga komuna, kryesisht kanë të instaluar kaldajat e tyre vetanake për ngrohje të cilat përdorin si lëndë për djegie drurin, linjitin, naftën, peletin dhe disa prej tyre energjinë elektrike. Burimet energjetike të cilat përdoren për ngrohje sigurohen nga komuna e Rahovecit.

3.3 Prodhimi i energjisë sipas sektorëve

3.3.1 Prodhimi i energjisë në ekonomitë familjare (ndërtesat e banimit)

Në sektorin rezidencial të Komunës së Rahovecit nuk ekzistojnë centrale të cilat prodhojnë energji elektrike, mund të këtë gjeneratorë të cilët shfrytëzojnë karburantet e lëngëta për prodhimin e energjisë elektrike. Këta gjeneratorë kryesisht përdoren në kohën kur ka mungesë të furnizimit me energji elektrike nga furnizuesi publik.

Gjithashtu, në sektorin rezidencial, ekzistojnë disa sisteme të vogla të paneleve diellore kryesisht për prodhimin e ujit të ngrohtë sanitar.

3.3.2 Prodhimi energjisë në sektorin e shërbimeve

3.3.2.1. Prodhimi i energjisë nga ndërtesat publike

¹² <http://ero>

ks.org/2019/Autorizimet_Licencat/02_09_2019_Regjistri_i_Aplikuesve_per_Autorizim_dhe_Pranim_ne_Skemen_Mbeshtetese.pdf

Sipas të dhënave në ndërtesat publike të komunës së Rahovecit nuk ekzistojnë centrale të cilat prodhojnë energji elektrike, mirëpo në mungesë të furnizimit të rregullt me energji elektrike nga sistemi, ka gjeneratorë të cilët prodhojnë energji elektrike.

Në vitet e fundit vërehet një zvogëlim i përdorimit të tyre për shkak të përmirësimit të furnizimit me energji elektrike nga furnizuesi publik.

E gjithë sasia e energjisë për ngrohje prodhohet përmes sistemit të ngrohjes të instaluar në ndërtesa. Po ashtu, edhe uji i ngrohtë sanitar prodhohet përmes bojlerëve me energji elektrike të instaluara në ndërtesat përkatëse.

3.3.2.2. Prodhimi i energjisë nga sektori komercial, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

Nuk ka të dhëna së ndonjë ndërtesë e sektorit komercial apo të NVM prodhon energji elektrike. Zakonisht, në rastet kur ka mungesë të furnizimit me energji elektrike përdoren gjeneratorët për prodhim të energjisë elektrike. Ky prodhim në vitet e fundit është zvogëluar dukshëm.

3.3.2.3 Prodhimi i energjisë nga ndërmarrjet publike

Nuk ka të dhëna se ndonjë ndërmarrje publike prodhon energji elektrike. Zakonisht, në rastet kur ka mungesë të furnizimit me energji elektrike përdoren gjeneratorët për prodhim të energjisë elektrike. Ky prodhim në vitet e fundit është zvogëluar dukshëm.

3.3.3 Prodhimi energjisë në sektorin e bujqësisë

Duke marrë parasysh kushtet e favorshme topografike, klimatike dhe agro-ekologjike puna në bujqësi, vreshtari dhe verari përbën aktivitetin themelor ekonomik në Rahovec në të gjitha aspektet duke përfshirë prodhimin, burimin e të ardhurave dhe punësimin.

Rreth 90% të tokës së komunës së Rahovecit përdoret si tokë punuese për bujqësi, e sidomos tokat kodrinore që përdoren si territore vreshtare. Toka e punueshme prej 14000 Ha, është e mbuluar me sistem të ujitjes nga Drini i Bardhë në sipërfaqe prej 3500/Ha. Rreth 70% e popullsisë në qytet dhe fshat sigurojnë ekzistencën nga aktivitetet bujqësore si në vreshtari dhe perimtari, etj.

Energjia në këtë sektor kryesisht përdoret si karburant për punimin e tokës, ndërsa më pak për sistem të ujitjes. Derivatet të cilat përdoren më së shumti janë nafta dhe benzina.

4. Analiza e konsumit të energjisë sipas sektorëve

Të dhënat e nevojshme lidhur me konsumin e energjisë në ndërtesat publike të komunës së Rahovecit janë siguruar nga komuna përmes zyrtarit për energji dhe nga tereni, me rastin e incizimit që i është bërë secilit objekt. Përgjatë incizimit të secilit objekt janë bërë matjet e duhura si dhe janë intervistuar personat përgjegjës për të marrë të dhënat e nevojshme për analizën e konsumit dhe nevojave energjetike të objektit përkatës. Janë dy sektorë të cilët janë analizuar në mënyrë të detajuar: sektori i ndërtesave publike komunale dhe i ndriçimit të rrugëve.

Analiza e mëtejshme përfshinë:

- Sektorin e ndërtesave publike komunale;
- Sektorin e ndriçimit të rrugëve dhe
- Flotën komunale.

4.1 Konsumi i energjisë nga ndërtesat publike komunale

Analiza e konsumit të energjisë është bërë për ndërtesat:

- Administrative;
- Arsimore;
- Shëndetësore;
- Kulturore dhe sportive
- Zjarrfikësve dhe mbrojtjes pyjore.

Në komunën e Rahovecit, në total janë analizuar 70 ndërtesa publike, me sipërfaqe të përgjithshme prej 70,011.82 m². Sasia e energjisë e konsumuar nëpër vite në periudhën 2016-2018 nga ndërtesat publike komunale është e paraqitur në figurën në vijim. Këtu përfshihet edhe energjia elektrike e cila është përdorur për ndriçim të ndërtesave, për pajisje elektrike, në disa raste edhe për ngrohjen e hapësirave. Konsumi mesatar vjetor i energjisë në periudhën 2016-2018 është 5,590.93 MWh/v




Figura 13. Konsumi i energjisë nga ndërtesat publike në tri vitet e fundit

Në figurën me poshtë është i paraqitur konsumi mesatar vjetor i energjisë në periudhën 2016-2018, sipas kategorive të ndërtesave publike komunale.




Figura 14. Konsumi mesatar i energjisë sipas llojit të ndërtesave

Konsumi i burimeve energjetike në periudhën 2016-2018 është i paraqitur në tabelën vijuese.

Tabela 9. Sasia e burimeve energjetike të konsumuar nga ndërtesat publike në tri vitet e fundit

Lloji i burimit energjetik	Njesia	Vitet		
		2016	2017	2018
Dru	m ³	1478.00	1710.60	2416.00
Linjit	ton	393.58	643.50	67.00
Naftë	lit	76425.00	85546.00	97332.00
Pelet	ton	26.66	31.50	63.00
Energji elektrike	kWh	886820.17	822057.88	761424.94

Sipas tabelës me lartë vërehet se në vitin 2018 ka rritje të konsumit të drurit dhe peletit për ngrohje, krahasuar me vitin 2017, dhe ka zvogëlim të përdorimit të linjtit. Në figurën me poshtë është paraqitur pjesëmarrja e burimeve energjetike në %.




Figure 15. Pjesëmarrja mesatare vjetore në përqindje e secilit burim energjetik

Sipas figurës më lartë shihet se druri si burim energjetik për ngrohje ka pjesëmarrjen më të madhe me 51.63 %.

Në figurën më poshtë shihet krahasimi i konsumit specifik mesatar vjetor i energjisë në ndërtesat publike komunale.




Figura 16. Konsumi specifik mesatar vjetor i energjisë sipas kategorive të ndërtesave

Nga analiza e bërë lidhur me konsumin e energjisë në ndërtesa dhe krahasimi lidhur me konsumin specifik mesatar vjetor të energjisë, është e qartë se ekzistojnë dallime në mes të ndërtesave të një kategorie por edhe në mes të ndërtesave të kategorive të ndryshme. Andaj, rekomandohet që para çdo planifikimi për investim në masa të EE të bëhen auditime energjetike në ndërtesa.

Analiza e konsumit energjetik është bërë për secilën ndërtesë komunale për periudhën 2016-2018, ***mirëpo si vlerë referente për llogaritje të mëtejme është marr vlera mesatare vjetore e konsumit për periudhën 2016-2018.***

4.1.1. Konsumi i energjisë nga ndërtesat e administratës

Janë analizuar gjithsej 9 ndërtesa, prej të cilave vetëm dy ndërtesa kanë të instaluar ngrohjen qendrore. Sipërfaqja e përgjithshme e këtyre ndërtesave është 5,525.67 m², ndërsa sipërfaqja që aktualisht ngrohet është 2,757.00 m², pra rreth 49.89 % të sipërfaqes së ndërtesave ngrohet.

Sipas raportimit, ndërtesat administrative kanë konsumuar në periudhën 2016 - 2018, mesatarisht 455.99 MWh/vit. Në figurën me poshtë është paraqitur konsumi mesatar vjetor i energjisë elektrike dhe ngrohjes nëpër vite në periudhën 2016-2018.




Figura 17. Konsumi mesatar vjetor i energjisë nga ndërtesat e administratës në periudhën 2016-2018




Figura 18. Pjesëmarrja mesatare vjetore në përqindje e secilit burim energjetik

Aktualisht, në ndërtesat e administratës, si burime energjetike shfrytëzohen energjia elektrike, druri i zjarrit dhe nafta. Me naftë ngrohet objekti i vjetër dhe i ri i komunës. Ndërsa, të gjitha ndërtesat tjera të administratës përdorin drurin si burim energjetik. Ndërsa energjia elektrike kryesisht përdoret për ndriçim dhe për pajisje elektrike të nevojshme brenda këtyre ndërtesave.

Konsumi specifik mesatar vjetor për periudhën 2016-2018 sillet nga 95.66 kWh/m²/v deri në 418.77 kWh/m²/v.

Konsumi specifik mesatar vjetor i energjisë për secilën ndërtesë të administratës është i paraqitur në figurën në vijim.




Figura 19. Konsumi specifik mesatar vjetor në ndërtesat e administratës

Mbi bazën e konsumit specifik, vërehet se sektori i ndërtesave të administratës ka konsum specifik mjaft të lartë të energjisë dhe kështu potencial mjaft të madh të kursimit të energjisë. Në këtë sektor ka mjaft hapësirë për investime në zbatim të masave të EE për rritjen e rehatisë dhe zvogëlimin e konsumit energjetik.

4.1.2 Konsumi energjisë nga ndërtesat e arsimit

Në komunën e Rahovecit, janë analizuar gjithsej 41 ndërtesa arsimore prej të cilave 21 kanë të instaluar ngrohjen qendrore. Sipërfaqja e përgjithshme e këtyre ndërtesave është 54,857.38 m², ndërsa sipërfaqja që aktualisht ngrohet është 40,673.90 m². Pra, rreth 74.14 % të sipërfaqes së këtyre ndërtesave ngrohet.

Në figurat më poshtë është i paraqitur konsumi i energjisë nga ndërtesat arsimore (energji elektrike dhe ngrohje) nëpër vite, si dhe pjesëmarrja mesatare në përqindje e llojeve të burimeve energjetike në periudhën 2016-2018. Sipas raportimit, ndërtesat arsimore kanë konsumuar në periudhën 2016 - 2018, mesatarisht 4,150.96 MWh/ vit.




Figura 20. Konsumi i energjisë nga ndërtesat e arsimit në periudhën 2016-2018




Figura 21. Pjesëmarrja mesatare në përqindje e secilit burim energjetik, në periudhën 2016-2018

Nga figura vërehet se druri ka pjesëmarrjen më të madhe në konsumin energjetik të ndërtesat arsimore me 67.29 %, për faktin se shumica e ndërtesave kanë të instaluara kaldajat me dru.

Konsumi specifik mesatar për periudhën 2016-2018 i ndërtesave arsimore sillet nga 50.83 kWh/m²/v deri në 406.64 kWh/m²/v. Ndërsa për secilën ndërtesë arsimore, konsumi specifik mesatar vjetor i energjisë është sipas figurës në vijim.




Figura 22. Konsumi specifik mesatar vjetor për periudhën 2016-2018

Mbi bazën e konsumit specifik mesatar vjetor të energjisë, mund të theksohet se, sektori i ndërtesave të arsimit në përgjithësi nuk ka performancë të keqe energjetike, megjithatë edhe më tej ka vend për investime në zbatim të masave të EE për rritjen e rehatisë dhe zvogëlimin e mëtejshëm të konsumit energjetik.

4.1.3. Konsumi i energjisë nga ndërtesat shëndetësore

Sa i përket konsumit të energjisë, janë analizuar 14 ndërtesa shëndetësore prej të cilave 13 ndërtesa kanë të instaluar ngrohjen qendrore. Sipërfaqja e përgjithshme e këtyre ndërtesave është 6364.91 m², ndërsa sipërfaqja që aktualisht ngrohet është 4538.00 m². Pra, rreth 71.30 % e sipërfaqes së këtyre ndërtesave ngrohet.

Në figurën më poshtë shihet konsumi vjetor i energjisë nga ndërtesat shëndetësore në periudhën 2016-2018, ku konsumi mesatar vjetor i energjisë është 880.92 MWh/v.




Figura 23. Konsumi vjetor i energjisë nga ndërtesat shëndetësore në periudhën 2016-2018




Figura 24. Pjesëmarrja mesatare në përqindje e secilit burim energjetik në periudhën 2016-2018
 Konsumi specifik mesatar vjetor për periudhën 2016-2018 sillet nga 36.65 kWh/m²/v deri në 643.61 kWh/m²/v.

Konsumi specifik mesatar vjetor i energjisë




Figura 25. Konsumi specifik mesatar vjetor për periudhën 2016-2018

Nga figura me lartë shihet se shumica e ndërtesave shëndetësore kanë konsum specifik mesatar vjetor të energjisë të ultë. Vetëm një ndërtesë (QMF- Çifllak) ka konsum specifik mesatar vjetor 643.61 kWh/m²/v, ndërsa të gjitha ndërtesat tjera kanë konsum me të vogël se 250 kWh/m²/v.

Konsumi i ulët specifik i energjisë i këtij stoku të ndërtesave është si rezultat i performancës së mirë energjetike të ndërtesave shëndetësore. Pjesa me e madhe e ndërtesave shëndetësore kanë të zbatuara masa të EE dhe pothuajse të gjitha ndërtesat përveç asaj QMF- Çifllak, kanë dritare me izo qelq.

4.1.4. Konsumi i energjisë nga ndërtesat e Kulturës dhe sportit

Në kudër të këtij stoku të ndërtesave, janë gjithsejtë dhjetë (10) ndërtesa. Prej tyre janë katër (4) ndërtesa që janë analizuar sa i përket konsumit të energjisë dhe potencialit për kursim të energjisë. Sipërfaqja e përgjithshme e këtyre ndërtesave është 2354.76 m². Ndërsa sipërfaqja që ngrohet është 319.00 m². Ky stok i ndërtesave konsumon vetëm energji elektrike, për ndriçim dhe në disa raste për ngrohje, me nxehëse elektrike. Disa ndërtesa funksionojnë vetëm në raste të caktuara të aktiviteteve që zhvillohen. Në tabelën me poshtë janë të paraqitura ndërtesat e kulturës dhe sportit të cilat nuk do të trajtohen me tej në aspektin e konsumit energjetik dhe potencialit të kursimit.

Tabela 10. Ndërtesat e kulturës dhe sportit në komunën e Rahovecit të cilat nuk do të trajtohen për analiza të mëtejme të konsumit të energjisë

Nr.	Emërtimi i ndërtesës	Viti i ndërtimit	Komente
1	Shtëpia e Verës -Bërnjakë	2013	Shërben për turizëm gjatë verës
2	Shtëpia e kulturës - Xërxë	2016	Ndërtesa nuk funksionon.
3	Palestra Sportive Mezahir Isma - Rahovec	2019	Është funksionalizuar në 2019
4	Shtëpia e Kulturës "Feim Gashi -Drenoc	2018	Ndërtesa nuk funksionon.
5	Shtëpia e Kulturës Jahja Hoti - Ratkoc	2012	Ndërtesa është në rindërtim e sipër dhe nuk është i finalizuar
6	Stadiumi i qytetit "Jahja Danuza -Rahovec		Nuk ka ngrohje, ndërtesa është i përkohshëm-tip barake

Sipas raportimit, këto ndërtesa kanë konsumuar energji elektrike në periudhën 2016 - 2018, mesatarisht 40.29 MWh/ vit. Në figurën me poshtë është paraqitur konsumi mesatar vjetor i energjisë elektrike dhe ngrohjes në periudhën 2016-2018.




Figura 26. Konsumi mesatar vjetor i energjisë nga ndërtesat e kulturës dhe sportit në periudhën 2016-2018

Meqenëse këto ndërtesa nuk kanë konsum të vazhdueshëm të energjisë për ngrohje, si rezultati i funksionit të tyre, dhe shumica nga to nuk ngrohen fare, atëherë edhe konsumi specifik vjetor i energjisë është i vogël. Konsumi specifik mesatar vjetor i energjisë në ndërtesa është i paraqitur në figurën e mëposhtme.




Figura 27. Konsumi specifik mesatar vjetor në ndërtesat e kulturës dhe sportit

Sipas konsumit specifik mesatar vjetor stoku i këtyre ndërtesave nuk ka potencial për kursim të energjisë.

4.1.4. Konsumi i energjisë nga ndërtesa e zjarrfikësve dhe pylltarisë

Në kuadër të këtij stoku janë dy ndërtesa të cilat përdoren si infrastrukturë me karakter mbrojtës, njëra për mbrojtje nga zjarri dhe tjetra për mbrojtjen e pyjeve. Sipërfaqja e përgjithshme e këtyre ndërtesave është 909.10 m², ndërsa sipërfaqja që aktualisht ngrohet është 38.00 m². Pra, rreth 4.18 % e sipërfaqes së këtyre ndërtesave ngrohet. Siç shihet, është një sipërfaqe tepër e vogël e cila aktualisht ngrohet. Asnjëra nga ndërtesat nuk ka sistem individual të ngrohjes qendrore, ngrohen me shporet dhe me ngrohëse elektrike. Vlen të theksohet, se një kat i ndërtesës së zjarrfikësve përdoret nga Ekoregjioni.

Në figurën më poshtë shihet konsumi vjetor i energjisë nga këto ndërtesa në periudhën 2016-2018, ku konsumi mesatar vjetor i energjisë është 62.77 MWh/v.




Figura 28. Konsumi mesatar vjetor i energjisë nga ndërtesat në periudhën 2016-2018




Figura 29. Pjesëmarrja mesatare në përqindje e secilit burim energjetik në periudhën 2016-2018

Nga figura me lartë shihet, së konsumi i energjisë elektrike është shumë i madh, kjo për faktin së sipërfaqja që ngrohet është shumë e vogël krahasuar me sipërfaqen e përgjithshme të ndërtesave, sidomos të ndërtesës së zjarrfikësve.

Konsumi specifik mesatar vjetor për periudhën 2016-2018 sillet nga 360.16 kWh/m²/v deri në 837.24 kWh/m²/v.




Figura 30. Konsumi specifik mesatar vjetor për periudhën 2016-2018

Nga figura me lartë shihet se ndërtesat kanë konsum specifik mesatar vjetor të energjisë mjaft të lartë. Konsumi i lartë specifik i energjisë i këtij stoku të ndërtesave është si rezultat i performancës së keqe energjetike të ndërtesave dhe si rezultat i konsumit tepër të madh të burimit energjetik për ngrohje. Gjithashtu për ngrohje përdoret edhe energjia elektrike, sidomos të ndërtesa e pylltarisë.

4.1.5 Konsumi i energjisë nga ndriçimi publik

Të dhënat për ndriçimin publik të rrugëve janë marrë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike të Komunës. Këto të dhëna mbi llojet e trupave ndriçues dhe kapacitetit të llambave ndriçuese, sipas rrugëve të qytetit dhe fshatrave në të cilat ndriçimi ekziston, janë strukturuar në tabela, ndërsa për nevoja të analizimit të potencialit të kursimit është llogaritur konsumi vjetor i energjisë për të gjitha llambat nëse të gjitha ato do të ishin në gjendje funksionale. Kjo për arsye se nuk është i njohur numri i llambave të cilat nuk janë në funksion për shkak të ndonjë defekti.

Sipas të dhënave të gjendjes ekzistuese, në komunën e Rahovecit janë të instaluar 2241 llamba për ndriçim publik të rrugëve ku dominojnë llambat LED që, për momentin, janë llambat më eficientet në treg dhe gjithsej janë të instaluar 1338 llamba ose 59.7% në totalin e llambave që janë të instaluar. Pjesa tjetër e llambave të instaluar përbëhet nga llambat halide (halogjene) me 392 copë apo 17.49%, llambat CFL me 352 apo 15.71%, llambat inkadeshente (llambat e zhivës) 155 copë apo 6.92%. Është interesante të përmendet se pjesëmarrja e llambave të presuara të natriumit është shumë e vogël, janë të raportuara vetëm 3 llamba të instaluar.

Bazuar në gjendjen ekzistuese prezenca e një përqindje mjaftë të madhe e llambave LED tregon se ka patur investime në ndriçim publik nga autoritetet komunale. Me gjithë investimet që duket se janë bërë në instalimin e llambave eficiente LED, bazuar në madhësinë e llambave të instaluara (kapacitetin e ndriçimit në W), ka të ngjarë që kapaciteti i llambave LED është i mbi dimensionuar, pra janë vendosur llamba me kapacitet më të madh të ndriçimit se sa ka qenë e nevojshme. Kjo vërehet te numri i madh i llambave LED me kapacitet 100W (janë 744 llamba apo 55.61%) dhe llamba me kapacitet 120W (janë 108 llamba apo 8.07%) si dhe llambat LED me kapacitet 80W (janë 281 llamba apo 21%). Instalimi i llambave me kapacitet më të madh se ai i nevojshëm për ndriçim, nuk jep rezultate të ngritjes së efijencës energjetike, përkundrazi e rrit edhe më shumë konsumin e energjisë dhe kostot financiare si në investim ashtu edhe në operim dhe mirëmbajtje të ndriçimit.

Gjithashtu në totalin e llambave ekzistuese të instaluara figuron një numër i konsiderueshëm i llambave kompakte fluoreshente (CFL). Këto llamba janë të dedikuara për ndriçim të brendshëm pasi janë të ndjeshme ndaj lagështisë që ndikon në jetëgjatësinë e tyre. Kur flitet për llambat CFL ka një numër të konsiderueshëm të tyre që kanë kapacitet të vogël (llamba me kapacitet 25W-13 copë, me kapacitet 15W-132 copë dhe me 10W janë 30 copë).

Prandaj, rekomandohet që para se të investohet në ndriçim të ri të rrugëve ose nëse investohet në ndërrim të llambave ekzistuese me llamba më eficiente, duhet që paraprakisht të përpilohet projekti inxhinierik që do të mundëson përzgjedhjen e duhur të llojit të llambave dhe do të mundësoj dimensionimin korrekt të kapacitetit të tyre, të cilat do të instalohen.

Mesatarisht konsumi vjetor i energjisë elektrike për ndriçim i raportuar nga komuna sipas kostos financiare vjetore bazuar në faturat e paguara, është treguar në tabelën e mëposhtme.

Tabela 11. konsumi i energjisë elektrike dhe kostoja mesatare vjetore e raportuar

	Konsumi mesatar vjetor kWh	Kostoja mesatare e ndriçimit €/vit
Konsumi i raportuar	1,816,691.95	54,576.00

Tabela 12. Pasqyra e llambave ekzistuese për ndriçimin e rrugëve

Lloji i llambave	Fuqia	Numri i llambave	Gjithsej fuqia (kW)	Numri i oreve te punes ne vit (h)	Gjithsej konsumi i energjisë (kWh/vit)
Inkandeshente (Zhivë)	125	129	16.125	4015	64741.875
Inkandeshente (Zhivë)	150	16	2.4	4015	9636
Inkandeshente (Zhivë)	400	10	4	4015	16060
Gjithsej llambat Inkandeshente (Zhivë)		155	22.53	4015	90437.88
CFL	85	2	0.17	4015	682.55

CFL	80	3	0.24	4015	963.60
CFL	65	162	10.53	4015	42277.95
CFL	40	10	0.40	4015	1606.00
CFL	25	13	0.33	4015	1304.88
CFL	15	132	1.98	4015	7949.70
CFL	10	30	0.30	4015	1204.50
Gjithsej llambat CFL		352	13.95	4015	55989.18
Natrium	160	3	0.48	4015	1927.20
Natrium	125	1	0.13	4015	501.88
Gjithsej llambat Natrium		4	0.61	4015	2429.08
Halide (Halogjene)	160	300	48.00	4015	192720.00
Halide (Halogjene)	150	28	4.20	4015	16863.00
Halide (Halogjene)	125	3	0.38	4015	1505.63
Halide (Halogjene)	120	26	3.12	4015	12526.80
Halide (Halogjene)	100	35	3.50	4015	14052.50
Gjithsej llambat halide (Halogjene)		392	59.20	4015	237667.93
LED	120	108	12.96	4015	52034.40
LED	100	744	74.40	4015	298716.00
LED	80	281	22.48	4015	90257.20
LED	40	40	1.60	4015	6424.00
LED	38	25	0.95	4015	3814.25
LED	15	140	2.10	4015	8431.50
Gjithsej llambat LED		1,338	114.49	4015	459677.35
Gjithsej të gjitha llambat		2,221	211	4015	846,201

Ndriçimi publik i rrugëve sipas asaj që është e raportuar për gjendjen ekzistuese, megjithatë, ka mjaftë hapësirë për aktivitete investuese në tërë komunën për ngritjen e nivelit të efijencës energjetike në ndriçimin publik.

4.2. Konsumi energjisë në shërbimet publike

4.2.1. Konsumi i energjisë në furnizimin me ujë dhe sektorin e ujërave të zeza

Qytetarët e komunës së Rahovecit furnizohen me ujë të pijshëm në tri forma:

1. Sistemi qendror i furnizimit-ujës-jellësi i Radoniqit;
2. Sistemet e vogla -ujës-jellësit lokal (sistem të pompimit); dhe
3. Puset individuale.

Furnizimi i banorëve të komunës së Rahovecit me ujë të pijshëm, momentalisht përcillet me probleme të mëdha.

Komuna e Rahovecit nuk ka rrjetë shumë të zhvilluar të furnizimit me ujë të pijes, i cili ka shtrirje në 26 vendbanime ose 58%, derisa pjesa tjetër e vendbanime ose 42% nuk kanë qasje në rrjetën e furnizimit kolektiv me ujë të pijes.

Aktualisht sistemi i ujësjellësit dhe kanalizimit (të ujërave të zeza dhe ujërave të shiut) në Komunën e Rahovecit menaxhohet nga Hidrosistemi i "Radoniqit". Furnizimi i komunës së Rahovecit me ujësjellës bëhet nga Hidrosistemi i Radoniqit.




Figura 31. Mënyra e furnizimit me ujë¹³

Furnizimi në vendbanimet tjera rurale, pjesa e tjetër e popullatës e cila nuk është e kyçur në ujësjellësin e Radoniqit, furnizohen me ujë nga bunarët e cektë dhe të pambrojtur (7-8 m thellësi).

Në komunën e Rahovecit, kanalizimi i ujërave të ndotura është shumë pak i zhvilluar, përkatësisht ky sistem është i shtrirë në zonën urbane dhe në disa vendbanime. Rreth 53260 banorë kanë qasje në kanalizim ose 74.46% e popullsisë së komunës së Rahovecit. Rreth 25.54 % e popullatës së komunës nuk kanë qasje në rrjetën e kanalizimit, por ujërat e zeza i derdhin në mënyrë të egër në lokacione të ndryshme në vendbanimet ku jetojnë, përkatësisht në shtratin e përroskave dhe lumenjve.

4.2.2. Konsumi i energjisë në sektorin e mbledhjes së mbeturinave

Për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Rahovecit, Komuna respektivisht Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor licencuar dy kompani:

- Ndërmarrja publike "Ekoregjioni"- e cila ofron pjesën më të madhe të territorit të Rahovecit; dhe
- Ekodrinia operator privat.

¹³ Plani Zhvillimor Komunal-RAHOVEC

Kompanitë të cilat janë të licencuara për administrimin e mbeturinave, punojnë në bazë të rregullores për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Rahovecit, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina, e miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në vitin 2014.

Për menaxhim dhe rregullim sa ma të mirë të sektorit të mbeturinave, komuna e Rahoveci krahas zbatimit të ligjit për mbeturina ka miratuar edhe kornizën rregullative dhe dokumente strategjike si vijon:

- Rregulloren për plotësimin e rregullores për menaxhimin e mbeturinave 01. Nr 4103 të datës 09.12.2015;
- Rregullore për menaxhimin e mbeturinave 01.Nr.239. të datës 30.01.2015; dhe
- Planin Lokal për menaxhimin e mbeturinave të vitit 2016-2021.

Mbulimi i shërbimeve në territorin e Komunës është i përfshirë në të gjithë territorin apo në 36 vendbanimet. Aktualisht operatori me i madh është Ekoregjioni-NJP "Ambienti" e cila sipas shënimeve të komunës ofron shërbim primar të grumbullimit të mbeturinave për 66% të popullatës së përgjithshme, dhe atë 100% të zonën urbane dhe rreth 27% në zonat rurale apo 36,439 banor. Kurse operatori tjetër "Ekodrinia", shërben kryesisht në pjesën rurale dhe rurale të thellë me përqindje të përgjithshme prej 34%.

Sasia e mbeturinave e cila grumbullohet brenda një dite sillet 20-30 ton, kurse sipas raporteve të dy kompanive që operojnë në Komunën e Rahovecit, shërbimi i grumbullimit të mbeturinave zhvillohet në të gjitha vendbanimet e komunës, megjithatë një pjesë e amvisërive nuk pranon të bëjë marrëveshje me operatorët.

Veprimtaria primare e kompanive të licencuara për menaxhimin e mbeturinave në komunë është:

- Grumbullimi i mbeturinave, dhe
- Transporti i mbeturinave komunale,

Ndërsa shërbim dytësor kanë:

- Menaxhimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike.
- Pastrimin e rrugëve dhe pastrimin e borës gjatë sezonës dimërore
- Mirëmbajtjen hapësirave të gjelbërta publike .

Kompanitë ofrojnë shërbimet e tyre për tri kategori të konsumatorëve: ekonomit familjare, biznese dhe institucionet. Format e shërbimit janë: shërbimi derë më derë dhe konsumatorët të pajisur me kontejnerë, kurse bizneset me kontrata janë të pajisura me kontejnerë të veçantë.

Mekanizmi i inkasimit bëhet përmes inkasantëve, arkës ndihmëse dhe llogarive rrjedhëse. Shkalla e arkëtimit për shërbimet e ofruara tek NjP Ambienti është 80-82% që vlerësohet si arkëtim mjaft i mirë. Kjo kompani grumbullon dhe transporton deri në deponin Landovicë rreth 8,500 t/vit.

4.3. Konsumi i energjisë në sektorin e bujqësisë¹⁴

Duke marrë parasysh kushtet e favorshme topografike, klimatike dhe agro-ekologjike puna në bujqësi, vreshtari dhe verari përbën aktivitetin themelor ekonomik në Rahovec në të gjitha aspektet duke përfshirë prodhimin, burimin e të ardhurave dhe punësimin. Rreth 90% të tokës së komunës së Rahovecit përdoret si tokë punuese për bujqësi, e sidomos tokat kodrinore që përdoren si territore vreshtare. Rreth 70% e popullsisë në qytet dhe fshat sigurojnë ekzistencën nga aktivitetet bujqësore si në vreshtari dhe perimtari, etj.

Në sektorin e bujqësisë si burime energjetike zakonisht përdoren nafta dhe derivatet e saj për mekanizmin bujqësor por nuk ka të dhëna për sasinë e këtij burimi që konsumohet.

4.4. Konsumi i energjisë në sektorin e transportit

4.4.1. Transporti publik

Në vitin 2018 në Kosovë janë të regjistruara 343,631 automjete motorike dhe jo motorike, në raport me vitin 2017 ka një rritje për 2.75%. Transporti në Kosovë, në përgjithësi dhe Rahoivecit në veçanti, filloi të zhvillohet me ritme të shpejta, sidomos pas vitit 1999. Kështu, u zhvilluan infrastrukturat rrugore dhe aftësitë transportuese të mjeteve rrugore. Sektori i transportit zë një vend të rëndësishëm në konsumin e burimeve energjetike. Rritja e theksuar e numrit të mjeteve u shoqërua me një ngritje të aktivitetit të transportit dhe një rritje të dukshme të konsumit të lëndëve energjetike, kryesisht naftës dhe benzinës. Sipas Balancës Vjetore të Energjisë në Republikën e Kosovës për vitin 2018, sektori i transportit merr pjesë me 30% në konsumin e përgjithshëm të energjisë.

Në nivel lokal organizohet nëpërmjet të autobusëve dhe automjeteve të tjera të transportit, i cili është mjaft mirë i organizuar. Shikuar nga numri i vendbanimeve që kanë transport publik, nga 36 vendbanime sa ka komuna e Rahovecit 31 prej tyre kanë qasje në transport publik nëpërmjet të autobusëve, dhe 5 vendbanime nuk kanë transport publik¹⁵.

Nuk ka të dhëna lidhur me konsumin energjetik të transportit në komunën e Rahovecit.

4.4.2. Flota komunale

¹⁴ Plani Zhvillimor Komunal-RAHOVEC

¹⁵ Plani Zhvillimor Komunal-RAHOVEC

Flotën komunale të komunës së Rahovecit e përbejnë 119 automjete. Prej të cilave 95 janë që përdorin naftën si karburant ndërsa të tjerat përdorin benzinën si karburant. Të dhënat lidhur me konsumin e karburanteve nga automjetet e komunës në periudhën 2016-2018 janë të paraqitura në tabelën me poshtë.

Tabela 13. Konsumi vjetor i karburantit nga flota komunale në periudhën 2016-2018

Viti	Numri i automjeteve		Konsumi i karburantit (l)		Konsumi	Emisioni
	Naftë	Benzinë	Naftë	Benzinë	MWh/v	CO ₂ ,t
2016	30	8	28100.90	6550.00	356.91	96.54
2017	33	8	28661.80	7130.00	368.12	99.54
2018	32	8	30240.80	6440.00	378.55	102.44
Gjithsej	95	24	87003.50	20120.00	1103.59	298.52

5. Analizat e potencialit të efijencës së energjisë sipas sektorëve

5.1 Sektori i shërbimeve

5.1.1. Ndërtesat publike

Ndërtesat publike komunale janë ndërtuar ndërmjet viteve 1937 dhe 2019. Furnizimi me ngrohje në disa raste nuk është sipas kushteve të komfortit. Po ashtu në koridore nuk ka ngrohje, sidomos të ndërtesat që ngrohen me stufa.

Gjatë incizimit që i është bërë të gjitha ndërtesave, janë marr të dhënat lidhur me karakteristikat teknike të ndërtesës. Këto të dhëna janë vendosur në një format të pyetësorit, të cilat më pas janë vendosur në SME për t'u krijuar një data bazë për analiza të mëtejme të stokut të ndërtesave publike komunale.

Përgjatë incizimit, për secilën ndërtesë janë marrë të dhëna lidhur me:

- Muret e jashtme të ndërtesës, përfshirë llojin e materialit ndërtimor që është përdorur, termoizolimi dhe trashësia e termoizolimit;
- Kulmet e ndërtesave, përfshirë llojin e kulmit, mbulesën e tyre dhe nëse kanë izolim termik apo jo;
- Dyshemetë e ndërtesave, përfshirë llojin e materialit dhe nëse ndërtesat kanë termoizolim;
- Sistemet e ngrohjes/ftohjes, karakteristikat e përgjithshme (lloji i sistemit të ngrohjes, kapaciteti dhe lloji i lëndës djegëse që përdoret);

- Sistemet e ndriçimit, përfshirë intensitetin e ndriçimit, llojin e poçeve dhe sistemin e kontrollit);
- Dyert dhe dritaret, përfshirë llojin e tyre, gjendjen në të cilën aktualisht ndodhen dhe performancën e tyre energjetike.

Përgjatë incizimit që u është bërë ndërtesave, është vërejtur se ato janë në kushte të ndryshme teknike dhe në aspektin e performancës energjetike. Të pakta janë ndërtesat që kanë të zbatuara masat e EE sipas normave, pastaj në shumicën e ndërtesave janë zbatuar masat e EE pjesërisht.

Në vitet e fundit janë bërë investime në renovimin e tyre dhe në vendosjen e masave të EE, mirëpo edhe më tej ka potencial të kursimit të energjisë në këto ndërtesa. Gjithashtu, përveç nevojës së kursimit të energjisë, rëndësi duhet dhënë edhe rritjes së rehatisë në hapësirat e ndërtesave.

Tashmë dihet se rritja e EE sjell reduktimin e nevojave për investime për prodhimin e energjisë, reduktimin e konsumit të lëndëve djegëse në të gjithë sektorët dhe njëkohësisht reduktimin e ndotjes së ambientit dhe reduktimin e emisioneve të gazeve me efekt serë (CO₂, N₂O, CH₄).

Rritja e rehatisë së hapësirave të brendshme të ndërtesave, rrit edhe efektivitetin e punës dhe edukimit. Për këtë nevojitet të bëhen investime në strukturën e ndërtesave dhe në përmirësimin e performancës së tyre energjetike. Në këtë drejtim nevojiten të merren një sërë masash si:

- Termoizolimi i mbështjellësit të jashtëm të ndërtesës;
- Vendosja e dyerve të jashtme dhe dritareve eficiente, në përputhje me kërkesat e performancës energjetike të ndërtesave (sipas rregullores nr. 04/18 për kërkesat minimale të performancës energjetike të ndërtesave);
- Instalimi i sistemeve të ngrohjes qendrore me pelet;
- Instalimi i sistemeve diellore për ujë të ngrohtë sanitar dhe prodhimin e energjisë elektrike;
- Instalimi i sistemeve eficiente të ventilimit dhe ftohjes së hapësirave, etj.

Në kuadër të analizës së potencialit për eficiencën e energjisë si target është marrë konsumi në vlerë prej 80 kWh/m²/vit, që sipas praktikave mund të jetë konsum optimal për ndërtesë.

Në komunën e Rahovecit janë analizuar 70 ndërtesa publike komunale. Nga kjo analizë del se 52 ndërtesa kanë konsum specifik vjetor të energjisë më të madhe se 80 kWh/m²/vit, që mund të konsiderohen si ndërtesa me potencial të kursimit të energjisë.

5.1.1.1. Ndërtesat e Administratës

Janë analizuar gjithsej nëntë ndërtesa administrative. Të gjitha ndërtesat e analizuara kanë potencial për kursimin e energjisë. Këto ndërtesa janë ndërtuar në periudhën nga viti 1974 deri në vitin 2017. Shumica e këtyre ndërtesave kanë të zbatuara pjesërisht masat e EE.

Analiza lidhur me potencialin e kursimit të energjisë është bërë për secilën ndërtesë, dhe kjo mund të shikohet në shtojcën e këtij dokumenti.

Ndërsa në tabelën më poshtë është paraqitur konsumi mesatar vjetor i energjisë për periudhën 2016-2018 dhe potenciali vjetor i energjisë që mund të kursehet në stokun e ndërtesave të administratës.

Tabela 14. Potenciali i kursimit të energjisë në stokun e ndërtesave të administratës publike

Kategoria e ndërtesave	Sipërfaqja e përgjithshme m ²	Sipërfaqja që ngrohet m ²	Konsumi mesatar vjetor i energjisë MWh/v	Konsumi specifik mesatar vjetor i energjisë (ngrohje+el ektrike) kWh/m ² /v	Potenciali vjetor i kursimit të energjisë MWh/v	Potenciali vjetor i kursimit të energjisë %
Administrative	5525.67	2757.00	455.99	311.30	164.20	30.01

5.1.1.2. Ndërtesat arsimore

Në komunën e Rahovecit janë gjithsej 41 ndërtesa arsimore. Këto ndërtesa janë ndërtuar në periudhën 1937 deri në vitin 2017. Prej këtyre ndërtesave 16 ndërtesa mund të konsiderohen së kanë të zbatuara masa të EE në mure, kulme, dysheme dhe dritare me izo qelq dy shtresor. Ndërtesat tjera kanë pjesërisht të zbatuara masat e EE. Megjithatë, te pjesa me e madhe e këtyre ndërtesave, termoizolimi nuk i plotëson kërkesat minimale të performancës energjetike sipas udhëzimit administrativ nr. 04/18.

Vlen të theksohet se nga 41 ndërtesa arsimore, 32 prej tyre kanë dritare me izo qelq dy shtresor/tre shtresor.

Përkundër masave që janë marrë në vitet e fundit në përmirësimin e EE, ende mbetet për t'u investuar në përmirësimin e performancës së tyre energjetike.

Bazuar në konsumin aktual të energjisë në tri vitet e fundit, nga 41 ndërtesa të analizuar 31 prej tyre kanë potencial të kursimit të energjisë.

Potenciali i kursimit të energjisë për stokun e ndërtesave arsimore është i paraqitur në tabelën në vijim. Ndërsa potenciali i EE për secilën ndërtesë është i paraqitur në shtojcën e këtij dokumenti.

Tabela 15. Potenciali i kursimit të energjisë në stokun e ndërtesave të arsimit

Kategoria e ndërtesave	Sipërfaqja e përgjithshme	Sipërfaqja që ngrohet	Konsumi i mesatar vjetor i energjisë	Konsumi specifik mesatar vjetor i energjisë (ngrohje+elektrike)	Potenciali vjetor i kursimit të energjisë	Potenciali vjetor i kursimit të energjisë
	(m ²)	(m ²)	(MWh/v)	kWh/m ² /v	(MWh/v)	%
Arsimore	54857.38	40673.90	4150.96	158.36	1190.61	28.68

5.1.1.3. Ndërtesat shëndetësore

Janë gjithsej 16 ndërtesa shëndetësore. Këto ndërtesa janë ndërtuar në periudhën 1980 deri në vitin 2018. Prej tyre, 5 ndërtesa janë ndërtuar në periudhën 1980 – 1999 dhe 11 ndërtesa tjera janë ndërtuar në periudhën 2000-2018.

Nga 16 ndërtesa sa janë vetëm 14 prej tyre janë analizuar në aspektin e konsumit të energjisë dhe potencialin e mundshëm për kursim të energjisë. Dy prej tyre nuk janë analizuar: AMF - Polluzhë – e cila është ndërtuar në vitin 2018 dhe është funksionalizuar në vitin 2019 dhe QKMF1-Rahovec e cila është në ndërtim e sipër.

Këto ndërtesa, në përgjithësi kanë performancë të mirë energjetike. Shumica prej tyre kanë të zbatuara masa të EE, p.sh. vetëm tri ndërtesa nuk kanë të termoizoluara muret ndërsa vetëm një nuk ka termoizolim në asnjë pozicion të mbështjellësit të jashtëm. Nga 14 ndërtesa të këtij stoku vetëm një nuk ka dritare me izo qelq. Të shumica e ndërtesave që kanë të zbatuara masat e EE, sa i përket termoizolimit, në përgjithësi nuk i plotësojnë kërkesat minimale të performances energjetike sipas udhëzimit administrativ nr. 04/18.

Bazuar në konsumin aktual të energjisë në tri vitet e fundit, nga gjithsej 14 ndërtesa të analizuar 10 prej tyre kanë potencial të kursimit të energjisë. Potenciali i kursimit të energjisë për stokun e ndërtesave shëndetësore është i paraqitur në tabelën në vijim. Ndërsa potenciali i EE për secilën ndërtesë është i paraqitur në shtojcën e këtij dokumenti.

Tabela 16. Potenciali i kursimit të energjisë në stokun e ndërtesave shëndetësore

Kategoria e ndërtesave	Sipërfaqja e përgjithshme	Sipërfaqja që ngrohet	Konsumi i mesatar vjetor i energjisë	Konsumi specifik mesatar vjetor i energjisë (ngrohje+elektrike)	Potenciali vjetor i kursimit të energjisë	Potenciali vjetor i kursimit të energjisë
	(m ²)	(m ²)	(MWh/v)	kWh/m ² /v	(MWh/v)	%
Shëndetësore	6364.91	4538.00	880.92	155.91	445.01	50.52

5.1.1.4. Ndërtesat e Kulturës dhe sportit

Janë gjithsej dhjetë ndërtesa të Kulturës dhe sportit. Ndërsa në aspektin e konsumit energjetik dhe potencialit të kursimit të energjisë janë analizuar vetëm 4 prej tyre, shih materialin me lartë të konsumi i energjisë nga ndërtesat e kulturës dhe sportit. Asnjë ndërtesë e analizuar nuk ka potencial për kursimin e energjisë, bazuar në konsumin aktual të energjisë. Këto ndërtesa janë ndërtuar në periudhën nga viti 1961 deri në vitin 2019.

Në këto ndërtesa janë bërë investime në masat e EE, sidomos në termoizolim të mureve të jashtme, kulmit, dyshemesë, ndërrim të dyerve dhe dritareve. Asnjë ndërtesë nuk ka të instaluar ngrohjen qendrore. Ndërtesat që aktualisht ngrohen si burim energjetik e përdorin energjinë elektrike. Ajo çka e karakterizon këtë stok të ndërtesave është se tri ndërtesa kanë të zbatuara komplet masat e EE, tri tjera kanë termoizolim të mureve, dy nuk kanë fare termoizolim, një ndërtesë është në ndërtim e sipër ndërsa një është e përkohshme-tip barake, kurse të gjitha ndërtesat kanë dritare me izo qelq të dyfishtë. Sipas analizës që i është bërë secilës ndërtesë edhe me tej mbetet për t'u investuar në përmirësimin e performancës së tyre energjetike. Më detalisht lidhur me konsumin dhe karakteristikat tjera të ndërtesave të këtij stoku shih shtojcën në këtë dokument.

5.1.1.5. Ndërtesat e zjarrfikësve dhe pylltarisë

Ndërtesa e zjarrfikësve është ndërtuar në vitin 1975, ndërsa shtëpia e pylltarisë është ndërtuar në vitin 1947. Ndërtesa e pylltarisë është në gjendje shume të keqe, për shkak se nuk ka pasur mirëmbajtje dhe renovime adekuate. Ndërsa ndërtesa e zjarrfikësve është në gjendje pak me të mirë, janë bërë investime në ndërrimin e dyerve dhe dritareve në vitin 2012 dhe termoizolimi i kulmit në vitin 2015.

Bazuar në konsumin aktual të energjisë në tri vitet e fundit, të dy ndërtesat kanë potencial për kursimin e energjisë. Potenciali i kursimit të energjisë, është i paraqitur në tabelën në vijim. Ndërsa potenciali i EE për secilën ndërtesë është i paraqitur në shtojcën e këtij dokumenti.

Tabela 17. Potenciali i kursimit të energjisë në ndërtesën e zjarrfikësve dhe pylltarisë

Kategoria e ndërtesave	Sipërfaqja e përgjithshme	Sipërfaqja që ngrohet	Konsumi i mesatar vjetor i energjisë	Konsumi specifik mesatar vjetor i energjisë (ngrohje+elektrike)	Potenciali vjetor i kursimit të energjisë	Potenciali vjetor i kursimit të energjisë
	(m ²)	(m ²)	(MWh/v)	kWh/m ² /v	(MWh/v)	%
Zjarrfikësve dhe pylltarisë	909.10	38.00	62.77	598.70	20.19	32.16

5.1.1.6 Ndrëçimi publik

Në komunën e Rahovecit në gjendjen ekzistuese dominon lloji i llambave LED që është dukshëm me i madh se numri i llojeve të tjera të llambave, por gjithashtu numri i llambave CFL dhe llambave halogjene është relativisht i madh, shih figurën në vijim:




Figura 32. Llojet dhe numri i llambave të ndriçimi publik në Rahovec

Për të gjitha këto raste është bërë llogaritja e kostos së investimit, përfitimet financiare dhe përfitimet mjedisore nga reduktimi i emetimit të CO₂ në hapësirë, që shihen në tabelën me poshtë.

Tabela 18. Potenciali i kursimit të ndriçimi publik-Rahovec (sipas konsumit të llogaritur)

Statusi	Kons i pergj i ener elek (kWh/vit)	Kostot e pergj te ener elek (euro/vit)	Kursimet nga kostot e pergj te ener elek (%/vit)	Shkarkimi i CO2 (kg CO2/vit)	Pakesimi i shkarkimeve te CO2 (t/CO2/vit)	Kosto e mirembajtjes (Euro/vit)	Perqindja e redukimit te koston se mirembajtjes
I vjeter (ekzistues)	846201.40	80812.23		1215145.21		19262.40	
I ri (LED)	613793.13	58617.24		881406.93		9651.18	
Gjithsej kursime	232408.28	22194.99	27.46%	333738.28	333.74	9611.22	49.90%

5.2. Potenciali i përgjithshëm i kursimit të energjisë

Potenciali lidhur me kursimin e energjisë është analizuar për:

- Sektorin e ndërtesave publike komunale; dhe
- Sektorin e ndriçimit të rrugëve.

Në sektorin e ndërtesave publike komunale:

- Janë analizuar gjithsej 70 ndërtesa;
- Sipas të dhënave lidhur me konsumin e energjisë, janë 52 ndërtesa të cilat kanë potencial të kursimit të energjisë;
- Konsumi i përgjithshëm mesatar vjetor i energjisë në periudhën 2016-2018 është 5,590.93 MWh/v.
- Potenciali i përgjithshëm vjetor i kursimit të energjisë është 1,820.01 MWh/v, ose 32.55 %.

Për llogaritjen e potencialit të kursimit të energjisë, si vlerë referente është marr konsumi specifik i energjisë prej 80 kWh/m²/vit.

Në sektorin e ndriçimit të rrugëve:

- Konsumi mesatar vjetor i energjisë në periudhën 2016-2018, sipas raportimit, është 1,816.69 MWh/v;
- Potenciali i përgjithshëm vjetor i kursimit të energjisë, krahasuar me konsumin e raportuar, është 232.41 MWh/v ose 12.76 %.

Në figurat më poshtë është paraqitur krahasimi në mes të konsumit dhe potencialit të kursimit të energjisë si dhe përqindja e kursimit të energjisë per kategoritë e ndërtesave publike komunale dhe ndriçimin rrugor.




Figura 33. Konsumi mesatar vjetor dhe potenciali i kursimit të energjisë për kategoritë e ndërtesave publike komunale dhe ndriçimin rrugor




Figura 34. Potenciali vjetor i kursimit në % për kategoritë e ndërtesave publike komunale dhe ndriçimit rrugor

Në tabelën më poshtë është paraqitur potenciali i kursimit të energjisë në ndërtesat publike komunale dhe ndriçimin rrugor, si dhe kostoja e përgjithshme e investimeve në masa të EE në ndërtesa me potencial të kursimit të energjisë dhe ndriçimin rrugor.

Tabela 19. Potenciali i kursimit të energjisë në sektorin e ndërtesave publike komunale dhe ndriçimin e rrugëve.

Sektori	Konsumi mesatar vjetor i energjisë	Kostoja mesatare vjetore e konsumit të energjisë	Potenciali vjetor i kursimit të energjisë	Potenciali vjetor i kursimit të energjisë	Kosto e investimeve në masa të EE
	MWh/v	€/v	MWh/v	%	Mil.€
Ndërtesat publike komunale	5,590.93	26,1060.98	1820.01	32.55	1.9261
Ndriçimi i rrugëve	1,816.69	54,576.00	232.41	12.79	0.1406
Gjithsej	7,407.62	315,636.98	2052.42	27.71	2.067

5.3. Analiza e gazrave me efekt serrë dhe potenciali i kursimit

Lirimi i gazrave me efekt serrë vjen kryesisht nga djegia e lëndëve djegëse fosile të cilat përdoren për energji. Ekzistojnë një numër gazrash të ndryshme serrë në atmosferën e Tokës. Ato primare janë: ozoni, metani, avujt e ujit, dyoksidi i karbonit dhe oksidet e azotit.

Në kuadër të këtij plani është bërë vetëm analiza e emisioneve të CO₂. Sipas të dhënave, sasia mesatare vjetore e CO₂ që emitohet dhe potenciali vjetor i kursimit është paraqitur në figurën në vijim.




Figura 35. Emisionet aktuale vjetore të CO₂ dhe potenciali vjetor i kursimit

Në tabelën me poshtë është paraqitur emisioni dhe potenciali vjetor i kursimit të CO₂ në ndërtesat publike komunale dhe ndriçimi rrugor.

Tabela 20. Emisionet aktuale vjetore të CO₂ dhe potenciali vjetor i kursimit

Lloji i ndërtesave	Emisioni aktual	Potenciali i kursimit
	CO ₂ ,t/v	CO ₂ ,t/v
Ndërtesat publike komunale	1721.83	630.05
Ndriçimi rrugor	1215.15	333.74
Gjithsej	2936.98	963.79

5.4. Caku i kursimit të energjisë

Objektivi i përgjithshëm i PKVEE është zvogëlimi i konsumit të energjisë, rritja e nivelit të rehatisë, zvogëlimi i kostos së shpenzimeve të energjisë si dhe krijimi i sistemit për menaxhimin e energjisë në komunën e Rahovecit.

Ndërtesat publike komunale

Caku i kursimit të energjisë të ndërtesat publike komunale nuk pritet të jetë i lartë për shkak të konsumit të ultë të energjisë në tri vitet fundit nga këto ndërtesa dhe për faktin se në kuadër të ndërtesave të përzgjedhura për tu zbatuar masat e EE në periudhën 2019-2021, ka ndërtesa të cilat nuk konsiderohen me potencial kursimi të energjisë, megjithatë këto kanë nevojë për zbatim të masave të EE.

Në kuadër të këtij plani, janë identifikuar 13 ndërtesa në të cilat do të aplikohen masa të EE. Të dhënat lidhur me cakun e kursimit dhe vlerën e investimeve për zbatimin e masave të EE në këto ndërtesa, janë të paraqitura në tabelën me poshtë.

Tabela 21 Caku i kursimit vjetor të energjisë nga ndërtesat në të cilat do të aplikohen masa të EE

Caku i kursimit për periudhën 2019-2021								
Numri i ndërtesave për zbatim të masave të EE	Sipërfaqja e ndërtesave (m ²)	Sipërfaqja ngrohëse, (m ²)	Konsumi mesatar vjetor i energjisë 2016-2018 (MWh/v)	Konsumi specifik mesatar i energjisë (kWh/m ² /v)	Kosto vjetore e konsumit të energjisë (€/v)	Potenciali i kursimit (MWh/v)	Potenciali i kursimit (%)	Investimet (€)
13	15171.14	10070.00	1163.17	175.18	42886.16	405.55	34.87	942,000.00

Ndriçimi rrugor

Ky sektor ka mjaft potencial për kursim të energjisë. Në kuadër të këtij plani janë identifikuar gjithsej 5 masa sa i përket ndërrimit të llambave në ato eficiente LED. Caku i

kursimit të energjisë në rrugët në të cilat planifikohet të bëhet ndërrimi i llambave me ato LED në kuadër të këtij plani dhe kostoja e nevojshme e investimeve, është e paraqitur në tabelën me poshtë.

Tabela 22 Caku i kursimit vjetor të energjisë nga ndriçimi i rrugëve në të cilat planifikohet të ndërrohen llambat me ato LED

Caku i kursimit per periudhën 2019-2021				
Ndërrimi i llambave ne ato LED	Konsumi mesatar vjetor i energjisë 2016-2018 (MWh/v)	Potenciali i kursimit (MWh/v)	Potenciali kursimit (%)	Investimet (€)
35 rrugë dhe 12 fshatra	385.48	231.84	60.14	140,646.00

Caku i përgjithshëm i kursimit të energjisë

Caku i kursimit të energjisë dhe krahasimi i tij me konsumin e përgjithshëm vjetor mesatar (të raportuar) për ndërtesa publike komunale dhe ndriçimin publik është paraqitur në tabelën me poshtë.

Tabela 23. Caku i kursimit te energjisë në raport me konsumin e përgjithshëm mesatar vjetor të energjisë nga ndërtesat publike komunale dhe ndriçimi i rrugëve

Sektori	Konsumi mesatar vjetor i energjisë	Kostoja mesatare vjetore e konsumit të energjisë	Caku i kursimit të energjisë në periudhën 2019-2021	Caku i kursimit të energjisë në periudhën 2019-2021	Kosto e investimeve në masa të EE për plotësimin e cakt të kursimit të energjisë
	MWh/v	€/v	MWh/v	%	€
Ndërtesat publike komunale	5590.93	261,060.98	405.55	7.25	942,000.00
Ndriçimi i rrugëve	1816.69	54576.00	231.84	12.76	140646.00
Gjithsej	7407.62	315,636.98	637.39	8.60	1,082,646.00

Përveç kursimeve të kostos për shpenzimet e energjisë; zbatimi i masave të EE sjell edhe disa përfitime të tjera si:

- Rritjen e komfortit të hapësirave të brendshme të ndërtesave duke krijuar kushte më atraktive për të gjithë ata që shfrytëzojnë hapësirat e ndërtesave;
- Rritjen e jetëgjatësisë së ndërtesave;
- Rritjen e sigurisë për ngasësit e automjeteve dhe për këmbësoret.

6. Masat e efijencës së energjisë për të arritur caqet e kursimit

Në fushën e efijencës së energjisë në nivel vendi janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm politiko-programorë, ligjorë dhe institucionalë për promovimin e saj. Është themeluar Agjencia e Kosovës për Efijencën e Energjisë si dhe Komisioni Çertifikues i Auditorëve dhe Menaxhereve të Energjisë. Është themeluar fondi për EE, si një mekanizëm me rëndësi në promovimin e EE. Po ashtu janë bërë investime të konsiderueshme në përmirësimin e efijencës së energjisë si në nivel vendi ashtu edhe në komunën e Rahovecit. Megjithatë në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm të EE dhe arritjes së caqeve duhet të merren një sërë masash, përfshirë:

- Masat me qëllime informimi dhe për ngritjen e kapaciteteve në komunën e Rahovecit;
- Masat në zbatim të projekteve në ndërtesat publike dhe ndriçimin publik.

6.1. Informimi dhe masat për ngritjen e kapaciteteve

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve duhet të merren masat si në vijim:

Informimi lidhur me EE – komuna mund të organizoj fushata promovuese informative në lidhje me informimin e qytetarëve, nxënësve dhe personelit punonjës. Gjithashtu mund të hapen kënde informative ku qytetarët mund të gjejnë material informues në lidhje me EE.

Krijimi i zyrës komunale per energji – komuna e ka emëruar menaxherin për energji, megjithatë duhet të krijohet dhe funksionalizohet zyra për energji në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr. 09/2017 për Zyrat Komunale të Energjisë. Kjo zyrë duhet të kompletohet me zyrtar të cilët do të kenë detyra dhe përgjegjësi të qarta.

Ngritja e kapaciteteve profesionale - stafit i zyrës për energji duhet të ketë kapacitete të mjaftueshme profesionale në hartimin e politikave komunale, promovimin e EE, monitorimin e projekteve, vlerësimin e ndikimit të masave të EE dhe raportimin. Gjithashtu stafi duhet të jetë mirë i përgatitur për përdorimin dhe mirëmbajtjen e softuerit për menaxhimin e energjisë. E gjithë kjo mund të bëhet përmes trajnimeve dhe pjesëmarrjes së stafit të zyrës në konferenca, takime dhe vizita studimore.

Studimi për konsumin dhe potencialin e kursimit energjetik – tashmë është krijuar një bazë e mirë e të dhënave për ndërtesat publike komunale dhe për ndriçimin rrugor. Mirëpo me qëllim të plotësimit të bazës së të dhënave lidhur me konsumin dhe potencialin e kursimit të energjisë nga sektorët tjerë, komuna e Rahovecit duhet te kryen një studim i cili do të përfshijë sektorët si: industrinë, transportin, amvisërinë, bujqësinë dhe shërbimet.

6.1.1. Masat për politikat komunale, promovim dhe ndryshimin e shprehive

Masa nr. 1.	
Titulli i masës së ndërmarrë	Ngritja e kapaciteteve të stafit të zyrës për energji
Përgjegjësi për implementim	Kuvendi Komunal dhe Drejtoria e shërbimeve publike
Periudha e implementimit	Janar 2020 - Dhjetor 2021
Kosto e vlerësuar[€]	-
Kursimet e llogaritura (% or kWh/a)	
Reduktimi i llogaritur I CO2 (tCO ₂ /a)	
Kosto e reduktimit të CO2 [€/ tCO ₂]	
Burimi i financimit	Qeveria, Buxheti komunal dhe donacionet
Përshkrimi i shkurtër	
	<ul style="list-style-type: none"> • Nxjerrja e vendimit për themelimin e Zyrës komunale për energji; • Përgatitja dhe miratimi i rregulloreve përmes së cilës: definohet numri i zyrtarëve të zyrës për energji; përcaktohen detyrat dhe përgjegjësit e zyrës për energji dhe stafit të saj; definohet forma e komunikimit me drejtoritë tjera brenda komunës si dhe forma e komunikimit dhe raportimit të zyrës ndaj institucioneve të tjera; • Kompletimi i zyrës me pajisje dhe staf të nevojshëm; • Ngritja e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve, përmes trajnimeve dhe pjesëmarrjes në aktivitete që zhvillohen në fushën e EE;

6.2. Masat e efijencës së energjisë sipas sektorëve

Në bazë të potencialit të kursimit dhe kriterëve tjera ndihmëse si qëndrueshmëria e investimit dhe numri i shfrytëzuesve të ndërtesave komunale janë identifikuar projektet për investime sipas sektorëve në vijim.

6.2.1. Masat e efijencës së energjisë në sektorin publik

Me qëllim të reduktimit të konsumit energjetik, në sektorin publik mund të merren masat e efijencës së energjisë si:

- Izolimi termik i mureve të ndërtesës;
- Ndërrimin e dritareve të vjetra me karakteristika të dobëta termike me dritare të reja me karakteristika termike dukshëm më të mira;
- Izolimi termik i pllakës së tavanit;
- Izolimi termik i dyshemesë - kjo masë duhet analizuar mirë për të parë nëse kostoja e renovimit është e arsyeshme;
- Ndërrimi i poçeve me ato efijente – LED;
- Zëvendësimi i sistemeve joefijente të ngrohjes me ato efijente, duke synuar që si burim energjetik të jetë peleti;
- Instalimi dhe funksionalizimi i sistemeve diellore për ngrohjen e ujit sanitar, sidomos në ndërtesat shëndetësore.

Siç shihet nga të dhënat më lartë, pothuajse shumica e ndërtesave kanë potencial për kursim të energjisë, edhe ato ndërtesa të cilat sipas konsumit aktual nuk konsiderohen se kanë potencial për kursim të energjisë kanë nevojë për zbatim të masave të EE. Megjithatë, është e pa mundur që në periudhën tre vjeçare sa planifikohet të jetë ky plan, të bëhen investime në të gjitha ndërtesat. Mbi bazën e kësaj, janë përzgjedhur ndërtesat për të cilat mund të bëhen investime. Për përzgjedhjen e ndërtesave në kuadër të këtij plani janë trajtuar tre opsione:

Opsioni 1- Përzgjedhja e ndërtesave duke u bazuar vetëm në nivelin e konsumit specifik vjetor të energjisë më të lartë. Bazuar në analizën që është bërë, konsumi specifik nuk është tregues real i gjendjes së një ndërtese, meqë ka ndërtesa të cilat janë në gjendje jo të mirë sa i përket performancës energjetike dhe kanë konsum të vogël specifik vjetor të energjisë dhe anasjelltas.

Opsioni 2- Përzgjedhja e ndërtesave duke u bazuar vetëm në nivelin e kursimit më të lartë vjetor të energjisë. Ky do të ishte një opsion i mirë për komunën meqë do të merreshin masa të EE në ndërtesa që kanë potencial të madh të kursimit dhe me këtë rast do të vije deri të kursimi më i shpejtë në buxhetin e komunës. Megjithatë mbi bazën e këtij opsioni do të mbesin pa u futur në plan një numër i ndërtesave që janë në

gjendje jo të mirë sa i përket komfortit, komponent e cila duhet të merret në vazhdimësi në konsideratë.

Opsioni 3- Sipas të cilit do të merren në konsideratë një numër më i madh i kriterëve si në vijim:

- Konsumi specifik vjetor i energjisë;
- Karakteristikat teknike të ndërtesës dhe niveli i masave të EE të zbatuara;
- Investimet që janë bërë në ndërtesë viteve të fundit;
- Prioriteteve të vendosura nga komuna e Rahovecit për investime në periudhën 2019-2021;

Për përzgjedhjen e ndërtesave, është marr në konsideratë opsioni 3. Konsiderohet se është opsioni me i mirë duke pasur për bazë gjendjen reale që aktualisht janë ndërtesat.

Sipas këtij opsioni, për investime në kuadër të këtij plani janë propozuar 16 ndërtesa të sektorit të arsimit. Të gjitha ndërtesat e propozuara konsiderohen me prioritet për investime në masa të EE sipas kriterit 3 me lartë.

Këto ndërtesa janë ndarë në dy grupe. Ndarja e tillë është bërë duke u bazuar në konsumin mesatar vjetor të energjisë dhe potencialin e kursimit:

Grupi 1- janë ndërtesat të cilat konsiderohen me prioritet për investime dhe sipas të dhënave të konsumit energjetik në tri vitet e fundit, është llogaritur së këto ndërtesa kanë potencial për kursim të energjisë.

Grupi 2 - janë ndërtesat të cilat konsiderohen me prioritet për investime në masa të EE por sipas të dhënave të konsumit energjetik në tri vitet e fundit, është llogaritur së këto ndërtesa nuk kanë potencial për kursim të energjisë.

Në tabelën më poshtë janë të paraqitura ndërtesat që rekomandohet se duhet të zbatohen masat e EE-së në periudhën 2019-2021.

Tabela 24. Ndërtesat me potencial kursimi, të rekomanduar për zbatim të masave të EE në periudhën 2019-2021

nr	Emërtimi i ndërtesës	Lloji i ndërtesës	Sipërfaqja totale e objektit m ²	Sipërfaqja ngrohëse, m ²	Konsumi mesatar i energjisë 2016-2018 (kWh/v)	Konsumi specifik mesatar i energjisë (kWh/m ² /v)	Kosto e konsumit Euro/v	Potenciali i kursimit (kWh/v)	Potenciali kursimit (%)	Investimet (€)
1	SHFMU "Nesim Elshani" Nagavc	Edukim	1358.74	400.00	65231.00	155.62	1936.62	30247.92	46.37	65000.00
2	SHFMU "Milaim Krasniqi"	Edukim	669.58	340.00	107295.00	313.09	3049.01	79250.52	73.86	55000.00

	/Pastaselle									
3	SHML "12 Maj"-Ratkoc	Edukim	2815.40	2120.00	186361.40	87.34	5750.67	15551.75	8.34	135000.00
4	SHFMU "Sopniqi"-Sapniq	Edukim	536.04	290.00	81552.67	272.74	2775.06	55893.52	68.54	45000.00
5	SHFMU "Skender Kastrati" - Gexhe	Edukim	697.50	590.00	50778.33	85.07	1839.16	2992.93	5.89	50000.00
6	SHFMU "Faik Konica" - Celine	Edukim	1073.51	360.00	110956.33	296.60	3680.33	77976.78	70.28	40000.00
7	SHFMU "Haki Stermilli" - Zoqishtë	Edukim	794.34	350.00	77680.67	218.28	2268.04	48398.19	62.30	110000.00
8	SHFMU "Hamez Thaqi"-Xerxe	Edukim	1197.80	1020.00	116827.70	114.10	3801.59	34777.68	29.77	75000.00
9	Parashkoll ore "Kinderberg" - Krusha e Madhe	Edukim	87.20	60.00	15660.00	261.00	466.66	10860.00	69.35	12000.00
10	SHFMU "Deshmoret e Zatriqit"-Zatriq	Edukim	420.78	240.00	70119.00	286.66	2260.73	49599.32	70.74	20000.00
	Gjithsej		9650.89	5770.00	882462.10	209.05	27827.87	405548.60	45.96	607000.00

Tabela 25. Ndërtesat pa potencial kursimi të energjisë, të rekomanduar për zbatim të masave të EE në periudhën 2019-2021

nr.	Emërtimi i ndërtesës	Lloji i ndërtesës	Sipërfaqja totale e objektit m ²	Sipërfaqja ngrohëse, m ²	Konsumi mesatar i energjisë 2016-2018 (kWh/v)	Konsumi specifik mesatar i energjisë (kWh/m ² /v)	Kosto e konsumit Euro/v	Potenciali i kursimit (kWh/v)	Potenciali kursimit (%)	Investimet (€)
11	SHFMU "Rilindja" - Çollak	Edukim	1392.00	1200.00	61259.67	50.85	1965.73	-	-	90000.00

12	SHFMU "Ardhmëria"-Rahovec	Edukim	1781.10	1350.00	80955.69	58.45	7929.79	-	-	115000.00
13	SHFMU "Bekim Sylka"-Rahovec	Edukim	2347.15	1750.00	138487.60	77.52	5162.77	-	-	130000.00
	Gjithsej		5520.25	4300.00	280702.95	62.27	15058.28	-	-	335000.00

Për secilën ndërtesë të përzgjedhur për zbatim të masave të EE në periudhën 2019-2021 është përgatitur formulari i veçantë i cili përmban elementet themelore, përfshirë koston e vlerësuar për investime, potencialin e kursimit të energjisë, vlerën e kursimit të emisioneve të CO₂ dhe masat e EE të cilat duhet të ndërmerren për ndërtesën përkatëse. Masat janë vendosur duke u bazuar në incizimet në teren që i janë bërë secilës ndërtesë, ndërsa vlera e investimeve në masa të EE është vendosur duke marrë për bazë çmimet aktuale të tregut dhe janë llogaritur për secilën masë të EE të paraqitur në formularët e mëposhtëm. Të ndërtesat që janë planifikuar masat e EE dhe kanë periudhën e kthimit të investimeve me të gjatë së 16 vite, kjo pjesë nuk është plotësuar në formular.

Përkundër këtyre të dhënave që paraqiten në formularët me poshtë, rekomandohet që para çdo planifikimi për investim në ndonjë ndërtesë të bëhet auditimi i energjisë për ndërtesën përkatëse.

6.2.1.1. Ndërtesat e arsimit, shkencës dhe teknologjisë

Për investime në kuadër të këtij plani janë propozuar 13. ndërtesa. Në tabelat e mëposhtme janë treguar masat e propozuara për ndërtesat arsimore.

Tabela 26. Ndërtesat më potencial kursimi të energjisë, të rekomanduara për renovim (Grupi 1)

Masa nr. 1.	
Titulli i masës së ndërmarrë	Renovimi i SHFMU "Nesim Elshani" - Nagavc
Përgjegjësi për implementim	Drejtoria për Arsim
Periudha e implementimit	Janar 2020 - Dhjetor 2020
Kosto e vlerësuar e implementimit [€]	65,000.00 €
Kursimet e vlerësuara (% or kWh/a)	30,247.92 kWh/v
Reduktimi i vlerësuar i CO ₂ (tCO ₂ /a)	11.25 t CO ₂ /v
Kosto e reduktimit të CO ₂ [€/ tCO ₂]	
Periudha e kthimit	

Burimi i financimit	Qeveria, Buxheti komunal, Fondi për EE, donatorët
Përshkrimi i shkurtër	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Termoizolimi i pllakës së kulmit; ➤ Ndërrimi i dritareve; ➤ Renovimi i kulmit me shtresa; ➤ Ndërrimi i poçeve në ato LED ➤ Instalimi i ngrohjes qendrore.
Prioriteti i zbatimit	(ultë, mesëm, lartë)
Përshkrimi detal i masave do të bëhet pas auditimit të energjisë	

Masa nr. 2.	
Titulli i masës së ndërmarrë	Renovimi i SHFMU "Milaim Krasniqi"-Pastasellë
Përgjegjësi për implementim	Drejtoria për Arsim
Periudha e implementimit	Janar 2020 - Dhjetor 2020
Kosto e vlerësuar e implementimit [€]	55,000.00 €
Kursimet e vlerësuara (% or kWh/a)	79,250.52 kWh/v
Reduktimi i vlerësuar i CO2 (tCO ₂ /a)	14.20 t CO ₂ /v
Kosto e reduktimit të CO2 [€/ tCO ₂]	
Periudha e kthimit	
Burimi i financimit	Qeveria, Buxheti komunal, Fondi për EE, donatorët
Përshkrimi i shkurtër	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Termoizolimi i mureve; ➤ Termoizolimi i pllakës së kulmit; ➤ Renovimi i kulmit me shtresa; ➤ Termoizolimi i dyshemesë; ➤ Ndërrimi i poçeve me ato LED; ➤ Instalimi i ngrohjes qendrore.
Prioriteti i zbatimit	(ultë, mesëm, lartë)
Përshkrimi detal i masave do të bëhet pas auditimit të energjisë	

Masa nr. 3.	
Titulli i masës së ndërmarrë	Renovimi i SHML "12 Maj"-Ratkoc
Përgjegjësi për implementim	Drejtoria për Arsim
Periudha e implementimit	Janar 2020 - Dhjetor 2020
Kosto e vlerësuar e implementimit [€]	135,000.00 €
Kursimet e vlerësuara (% or kWh/a)	15,551.75 kWh/v
Reduktimi i vlerësuar i CO2 (tCO ₂ /a)	2.45 t CO ₂ /v
Kosto e reduktimit të CO2 [€/ tCO ₂]	
Periudha e kthimit	

Burimi i financimit	Qeveria, Buxheti komunal, Fondi për EE, donatorët
Përshkrimi i shkurtër	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Ndërrimi i dritareve; ➤ Ndërrimi i lanternës (ndriçimi nga kulmi), ➤ Renovimi i kulmit me shtresa, ➤ Instalimi i ngrohjes, ➤ Ndërrimi i poçeve ➤ Duhet të drenazhohen ujerat nga themeli-bodrumi.
Prioriteti i zbatimit	(ultë, mesëm, lartë)
Përshkrimi detal i masave do të bëhet pas auditimit të energjisë	

Masa nr. 4.	
Titulli i masës së ndërmarrë	Renovimi i SHFMU "Sopniqi"-Sapniq
Përgjegjësi për implementim	Drejtoria për Arsim
Periudha e implementimit	Janar 2020 - Dhjetor 2020
Kosto e vlerësuar e implementimit [€]	45,000.00 €
Kursimet e vlerësuara (% or kWh/a)	55,893.52 kWh/v
Reduktimi i vlerësuar i CO2 (tCO ₂ /a)	13.12 t CO ₂ /v
Kosto e reduktimit të CO2 [€/ tCO2]	
Periudha e kthimit	
Burimi i financimit	Qeveria, Buxheti komunal, Fondi për EE, donatorët
Përshkrimi i shkurtër	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Termoizolimi i mureve; ➤ Termoizolimi i pllakës së kulmit; ➤ Ndërrimi i dritareve; ➤ Instalimi i ngrohjes; ➤ Ndërrimi i poçeve me ato LED.
Prioriteti i zbatimit	(ultë, mesëm, lartë)
Përshkrimi detal i masave do të bëhet pas auditimit të energjisë	

Masa nr. 5.	
Titulli i masës së ndërmarrë	Renovimi i SHFMU "Skender Kastrioti" - Gexhe
Përgjegjësi për implementim	Drejtoria për Arsim
Periudha e implementimit	Janar 2020 - Dhjetor 2020
Kosto e vlerësuar e implementimit [€]	50,000.00 €
Kursimet e vlerësuara (% or kWh/a)	2,992.93 kWh/v
Reduktimi i vlerësuar i CO2 (tCO ₂ /a)	0.41 t CO ₂ /v
Kosto e reduktimit të CO2 [€/ tCO2]	
Periudha e kthimit	

Burimi i financimit	Qeveria, Buxheti komunal, Fondi për EE, donatorët
Përshkrimi i shkurtër	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Ndërrimi i dritareve; ➤ Ndërrimi i llanternës (ndriçimi nga kulmi); ➤ Renovimi i kulmit me shtresa; ➤ Ndërrimi i poçeve me ato LED.
Prioriteti i zbatimit	(ultë, mesëm, lartë)
Përshkrimi detal i masave do të bëhet pas auditimit të energjisë	

Masa nr. 6.	
Titulli i masës së ndërmarrë	Renovimi i SHFMU "Faik Konica"- Celine
Përgjegjësi për implementim	Drejtoria për Arsim
Periudha e implementimit	Janar 2020 - Dhjetor 2020
Kosto e vlerësuar e implementimit [€]	40,000.00 €
Kursimet e vlerësuara (% or kWh/a)	77,976.78 kWh/v
Reduktimi i vlerësuar i CO2 (tCO ₂ /a)	13.54 t CO ₂ /v
Kosto e reduktimit të CO2 [€/ tCO ₂]	
Periudha e kthimit	
Burimi i financimit	Qeveria, Buxheti komunal, Fondi për EE, donatorët
Përshkrimi i shkurtër	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Ndërrimi i dritareve; ➤ Mbrojtja e termoizolimit në tavan; ➤ Instalimi i ngrohjes qendrore; ➤ Ndërrimi i poçeve me ato LED.
Prioriteti i zbatimit	(ultë, mesëm, lartë)
Përshkrimi detal i masave do të bëhet pas auditimit të energjisë	

Masa nr. 7.	
Titulli i masës së ndërmarrë	Renovimi i SHFMU "Haki Stermilli" - Zoqishtë
Përgjegjësi për implementim	Drejtoria për Arsim
Periudha e implementimit	Janar 2020 - Dhjetor 2020
Kosto e vlerësuar e implementimit [€]	110,000.00 €
Kursimet e vlerësuara (% or kWh/a)	48,398.19 kWh/v
Reduktimi i vlerësuar i CO2 (tCO ₂ /a)	10.47 t CO ₂ /v
Kosto e reduktimit të CO2 [€/ tCO ₂]	
Periudha e kthimit	
Burimi i financimit	Qeveria, Buxheti komunal, Fondi për EE, donatorët

Përshkrimi i shkurtër	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Ndërtimi i pllakës së kulmit betonarme; ➤ Termoizolimi i mureve; ➤ Ndërtimi i kulmit në shtresa; ➤ Termoizolimi i pllakës së kulmit; ➤ Termoizolimi i dyshemesë; ➤ Instalimi i ngrohjes qendrore; ➤ Ndërrimi i poçeve me ato LED.
Prioriteti i zbatimit	(ultë, mesëm, lartë)
Përshkrimi detal i masave do të bëhet pas auditimit të energjisë	

Masa nr. 8.	
Titulli i masës së ndërmarrë	Renovimi i SHFMU "Hamez Thaqi"- Xerxe
Përgjegjësi për implementim	Drejtoria për Arsim
Periudha e implementimit	Janar 2020 - Dhjetor 2020
Kosto e vlerësuar e implementimit [€]	75,000.00 €
Kursimet e vlerësuara (% or kWh/a)	34,777.68 kWh/v
Reduktimi i vlerësuar i CO2 (tCO ₂ /a)	2.35 t CO ₂ /v
Kosto e reduktimit të CO2 [€/ tCO ₂]	
Periudha e kthimit	
Burimi i financimit	Qeveria, Buxheti komunal, Fondi për EE, donatorët
Përshkrimi i shkurtër	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Termoizolimi i mureve; ➤ Termoizolimi i pllakës së kulmit; ➤ Termoizolimi i dyshemesë; ➤ Ndërrimi i dritareve; ➤ Ndërrimi i poçeve me ato LED.
Prioriteti i zbatimit	(ultë, mesëm, lartë)
Përshkrimi detal i masave do të bëhet pas auditimit të energjisë	

Masa nr. 9.	
Titulli i masës së ndërmarrë	Renovimi i ndërtesës parashkollore "Kinderberg" - Krusha e Madhe
Përgjegjësi për implementim	Drejtoria për Arsim
Periudha e implementimit	Janar 2021 - Dhjetor 2021
Kosto e vlerësuar e implementimit [€]	12,000.00 €
Kursimet e vlerësuara (% or kWh/a)	10,860.00 kWh/v
Reduktimi i vlerësuar i CO2 (tCO ₂ /a)	0.34 t CO ₂ /v
Kosto e reduktimit të CO2 [€/ tCO ₂]	
Periudha e kthimit	
Burimi i financimit	Qeveria, Buxheti komunal, Fondi për EE,

	donatorët
2. Pravo učešća na javnoj raspravi imaju svi građani opštine Orahovac i ostali zainteresovani subjekti.
3. Za datum, mesto i vreme održavanja javne rasprave, građani i ostali zainteresovani subjekti će se obavestiti putem zvanične internet stranice opštine i javne objave na oglasnoj tabli.
4. Pitanja, primedbe, sugestije, komentare, itd (usmene i pismene), mogu se uputiti ekipi koja nadzire proces javne rasprave direktno ili putem skupštinske kancelarije.
5. Za sprovođenje ove odluke stara će se: Odeljenje za Urbanizam, Planiranje i Zaštitu Životne Sredine i Kancelarija Skupštine Opštine Orahovac.
6. Ova odluka stupa na snagu odmah nakon usvajanja od strane Skupštine Opštine Orahovac.

Odluku dostaviti:

- *MALS, i*
- *Arhivi.*

SKUPŠTINA OPŠTINA ORAHOVAC

01 Nr. 33/2019
Me datë: 26.12.2019





REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOMUNES/SKUPSTINA OPSTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY




RAHOVEC /ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)


Nr./Br./No 33 Nr. i faq/Br.str/No.pg 66

Data/Datum/Date 26 /12 / 2019



PLANI LOKAL PER VEPRIM NË MJEDIS RAHOVEC

2019-2024



Plani Lokal per Veprim në Mjedis 2019-2024

Rahovec, 2019

Projekti është financuar nga Komuna e Rahovecit



Ky projekt është zbatuar nga:

Eco Iliria



Dhe përkrahur nga



MAPL - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MMPH - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Përmbajtja	
Profili për Eco Iliria	5
Fjala e Kryetarit të Komunës (foto e kryetarit)	5
Fjalorthi i shkurtesave	7
Akterët dhe përgjegjësit e hartimit të PLVM-së.....	8
Baza ligjore për hartimin e PLVM-së	9
MISIONI DHE VIZIONI	10
I. HYRJE.....	11
1.1. Detyrimet ligjore për hartimin e PLVM-së.....	11
1.2. Qëllimet e Planit Lokal për Veprim në Mjedis	11
1.3. Objektivat specifike të planit	12
1.4. Metodologjia e përgatitjes së PLVM-së.....	12
II. PROFILI I KOMUNËS	13
2.1. Historiku dhe Pozita gjeografike	13
2.2. Popullsia.....	14
2.3 Klima.....	17
2.4 Struktura Demografike.....	17
2.4.1 Popullsia.....	17
2.4.2. Struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë.....	17
2.4.3 Migrimet e popullsisë.....	18
2.4.4 Vendbanimet dhe tipi i vendbanimit	18
2.5. Administrimi territorial dhe çështjet sociale.....	19
2.5.1 Administrimi territorial	19
2.5.2 Çështjet sociale –infrastruktura sociale	19
2.5.3. Arsimiti dhe Institucionet Arsimore	20
2.5.7 Institucionet shëndetësore	21
2.5.8 Institucionet kulturore dhe sportive.....	22
2.5.6 Monumentet natyrore	24
2.5.7 Kushtet ekonomike dhe sociale në komunë.....	27
2.5.8 Bujqësia në komunë	27
III ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE MJEDISORE	31
3.1 Ajri.....	31
3.1.2 Monitorimi i Cilësisë së Ajrit	31
3.1.5 Vlerësimi i shkaqeve dhe kërcënimet në cilësinë e ajrit.....	32
3.1.6 Burimet kryesore të ndotjes	32

3.2 Resurset ujore	32
3.2.1 Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore	33
3.2.2 Cilësia e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore	34
3.2.3 Shfrytëzimi i ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë.....	35
3.3. Menaxhimi i ujërave të ndotur	37
3.3.1. Rrjeti i kanalizimit të ujërave të ndotura - Gjendja ekzistuese	37
3.3.2. Rrjeti ekzistues i kanalizimit të ujërave te ndotura.....	38
3.4 Biodiversiteti dhe Resurset Pyjore në komunën e Rahovecit	41
3.4.1. Ekosistemet pyjore kryesore.....	41
3.5. Menaxhimi dhe degradimi i tokës.....	41
3.5.1. Degradimi dhe ndotja e tokës	42
3.6. Administrimi dhe menaxhimi i mbeturinave në komunë.....	43
3.6.1. Menaxhimi i mbeturinave	43
3.6.2. Shërbimet e ndërmarrjeve për menaxhimin e mbeturinave	45
3.6.5. Prodhimi dhe përbërja e mbeturinave.....	46
3.7. Ndrçimi publik	47
3.8. Ndotja akustike-Zhurma.....	47
3.9. Planifikimi urban dhe gjelbërimi publik.....	48
3.9.1. Vendbanimet jo formale.....	48
4.0. Trafiku dhe infrastruktura rrugore	49
VI. IDENTIFIKIMI I PROBLEMEVE MJEDISORE ME PRIORITET	50
VII. VLERËSIMI I PROBLEMEVE PRIORITARE SIPAS FUSHAVE	50
VIII. P L A N I I V E P R I M I T	58
LISTA E PROJEKTEVE PRIORITARE	65

Profili për Eco Iliria



Eco-Iliria Sh.P.K. është organizatë vendore mjedisore e cila mbështet zgjidhjen e problemeve mjedisore dhe zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë. Kjo organizatë e përmbush misionin e vet duke implementuar projekte nga fusha e mjedisit përmes ofrimit të këshillave profesionale dhe promovuar edhe bashkëpunim ndërmjet Organizatave joqeveritare (OJQ), qeverive, bizneseve si dhe personave tjerë kyç mjedisor si dhe duke përkrahur këmbimin e lirë të informatave dhe pjesëmarrjen publike në vendimmarrjen për mjedis. Eco Iliria si organizatë është themeluar në vitin 2017. Aktualisht, Eco Iliria me qëllim të përmbushjes së misionit të vet angazhon profesionist të fushave të ndryshme si ajrit, ujit, tokës, menaxhimi i mbeturinave, legjislacionin vendor dhe direktivat e BE për fushat përkatëse. Deri më tani Eco Iliria ka implemetuar shumë projekte nga fusha e mjedisit si Vlersimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) Vlersimin Strategjik të Ndikimit në Mjedis (VSM), zhvillimin e Planit Kombëtar për Veprim në Mjedis dhe ka marrë pjesë në hartimin Planeve Lokale për Veprim në Mjedis (PLVM) me ekspertizën e stafit.

Fjala e Kryetarit të Komunës



Të menduarit mbi ruajtjen e vlerave themelore dhe bartjen e tyre në gjeneratat në vijim pa dyshim se sjellë në pah edhe mbrojtjen e mjedisit si një vlerë superiore. Është evidente se problemet mjedisore ekzistojnë në masë të theksuar në gjithë botën dhe si të tilla në masë të madhe janë prezente edhe në Kosovë. Përkundër progresit të konsiderueshëm që është bërë në vitet e fundit si rezultat i shumë iniciativave të shumta në ruajtjen e mjedisit, dëmtimet dhe degradimi i burimeve natyrore (pyjet, bujqësia dhe toka pyjore, burimet ujore, flora dhe fauna) vazhdojnë të jenë prezente. Këtu nuk bënë përjashtim as komuna e Rahovecit e cila ka ndërmarrë shumë veprime dhe ka implementuar projekte të ndryshme në fushën mjedisore por ajo ende përballet me një varg problemesh mjedisore të pa zgjidhura plotësisht siç janë menaxhimi i mbeturinave, menaxhimi i ujërave të ndotura, ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe furnizimi me ujë cilësor të pijshëm. Ruajtja e mjedisit kërkon qasje në nivele të ndryshme organizimi shoqëror, duke filluar nga individi, si elementi bazë i shoqërisë, komuniteti vendor dhe shoqëria si tërësi. Periudha e pas-luftës në Kosovë me listën e gjerë të prioritetëve ekzistenciale ka sfiduar çështjet që kanë të bëjnë me ruajtjen e mjedisit, jo vetëm individin por edhe vet shtetin e ri të

Kosovës, në të gjitha nivelet e sajë organizative. Andaj është koha të ecim përpara duke ndërmarr veprime konkrete për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit. Plani Lokal për Veprim në Mjedis (PLVM) është një dokument strategjik i cili krijon një mundësi të mirë për adresimin dhe zgjidhjen e problemeve mjedisore në nivel lokal dhe gjithashtu është pikë fillestare për një planifikim dhe zhvillim të qëndrueshëm. Vlen të theksohet se komuna e Rahovecit në mungesë të kapaciteteve dhe fondeve ende nuk ka një plan për mbrojtjen e mjedisit.

Hartimi i PLVM për komunën e Rahovecit sikundër edhe për të gjitha komunat është edhe obligim ligjor sipas nenit 24 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025. Gjithashtu PLVM duhet të jetë në harmoni me Planin e ri Zhvillimor të komunes, Planin e Veprimit Kombëtar në Mjedis (PKVM) dhe Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen e Mjedisit (SKMM) dhe dokumentet tjera strategjike në nivel lokal dhe kombëtar që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm.

Qëllimi i PLVM-së është të krijojë politika të përbashkëta të mbrojtjes së mjedisit në kontekst të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm të Komunës.

Dëshiroj të shfrytëzoj rastin që në emër të Komunës së Rahovecit, në veçanti të falënderoj të gjithë donatorët që deri më tani e kanë përkrahur dhe mbështetur financiarisht komunën tonë në fusha të ndryshme me projekte konkrete edhe në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

Duke e vlerësuar lartë rëndësinë e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm, komuna e Rahovecit këtë vit ka vendosur që të financojë hartimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis nga buxheti vetanak. Për këtë qëllim komuna e ka zhvilluar procedurat tenderike sipas ligjeve të Kosovës dhe ka kontraktuar Eco Iliria si organizatë me përvojë të gjatë në këtë fushë në implementimin e projekteve me rëndësi vitale për mbrojtjen e Mjedisit dhe Biodiversitetit.

Fjalorthi i shkurtesave

KK - Kuvendi Komunal

AKMM - Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit

APK - Agjencioni Pyjor i Kosovës

ASK - Agjencioni i Statistikave të Kosovës

BE - Bashkimi Evropian

IHMK - Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës

IKSHPK - Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës

ISHP - Instituti i Shëndetit Publik

MAPL - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

MMPH - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

MBPZHR - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

NQ - Ngrohtorja e Qytetit

OBSH - Organizata Botërore e Shëndetësisë

OJQ - Organizata Joqeveritare

PKVM - Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis

PLVM - Plani Lokal i Veprimit në Mjedis

PM₁₀, PM_{2.5} - Grimcat e suspenduara në ajër

PZHK - Plani Zhvillimor Komunal

PZHU - Plani Zhvillimor Urban

VNM - Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis

VSM - Vlerësimi Strategjik Mjedisor

VLM - Vlera e Lejuar Maksimale

QMF – Qendër e Mjekësisë Familjare

QKMF - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

Akterët dhe përgjegjesit e hartimit të PLVM-së

Ky Projekt është implementuar nga:

Eco Iliria SH.P.K

Leonita Ibrahim- Koordinaore e Eco Iliria për PLVM

Dr. Avdullah Nishori- Projekt menaxher nga Eco Iliria për PLVM

Komuna e Rahovecit

Rumir Zhuniqi – Projekt Menaxher

Bjondinë Rama- Koordinaore e Komunës për PLVM

Grupi Punues:

1. Bjondina Rama - Bashkëpunor Profesional për Mjedis
2. Sylejman Daka - Zyrtar në Drejtorinë për Shërbime Publike
3. Shpejtim Mustafa -Zyrtar i Drejtorisë për Urbanizëm
4. Ilvi Derguti – Zyrtar i Drejtorisë për Bujqësi
5. Metush Isma - Zyrtar i Drejtorisë për Inspektion
6. Nazmi Kabashi - Zyrtar në kompaninë e Ujësjiellës-Kanalizim
7. Qazim Hoti – zyrtar i kompanisë për mbeturina “Eko Drinia”
8. Edon Raba - zyrtar i kompanisë për mbeturina “Eko Regjioni”
9. Vjollca Selimi-Gurgule – përfaqesuese e shoqërisë Civile
10. Ekrem Bytyqi – Zyrtar për Barazi Gjinore
11. Arben Gashi – Zyrtar i zyrës për Integritime Europiane

Baza ligjore për hartimin e PLVM-së

Legjislacioni i Republikës së Kosovës në fushën e mbrojtjes së mjedisit harmonizuar me standardet evropiane që është përdorur si referencë për përgatitjen e PLVM-së.

- ✓ Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit nr. 03/ L-025, 2009
- ✓ Ligji për Mbeturinat nr. 04/L-60, 2012
- ✓ Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja nr. 03/L-160, 2010
- ✓ Ligji për Mbrojtjen e Natyrës nr. 03/L-233, 2010
- ✓ Ligji për Mbrojtjen nga Zhurma nr. 02/L-102, 2007
- ✓ Ligji për Planifikim Hapësinorë nr.04/l-174, 2013
- ✓ Ligji për Ujërat e Kosovës nr. 04/l-147, 2013
- ✓ Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis nr. 03/l-214, 2010
- ✓ Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura nr. 03/l-039, 2008
- ✓ Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor nr. 03/l-230, 2010
- ✓ Udhëzimi Administrativ-nr. 26/2014 për mbeturinat nga bateritë dhe akumulatorët e shpenzuar, me datë: 27.11.2014.
- ✓ Udhëzimi Administrativ-nr.05/2013 për menaxhimin e vajrave të përdorura dhe mbeturinat me vajra, me datë: 21.03.2013.
- ✓ Udhëzimi Administrativ-nr. 19/2012 për menaxhimin e automjeteve mbeturinë dhe komponentet e tyre, me datë: 31.08.2012.
- ✓ Udhëzimi Administrativ-nr. 10/2015 për asgjësimin e mbeturinave të produkteve medicinale, me datë: 10.09.2015.
- ✓ Udhëzimi Administrativ nr. 05/2009 për administrimin e mbeturinave publike
- ✓ Udhëzimi administrativ – nr. 14/2015 për ndëshkimet me gjobat mandatore, me datë: 23.11.2015.
- ✓ Planin Kombëtarë për Veprim në Mjedis i Kosovës, 2006-2010.

MISIONI DHE VIZIONI

Misioni ynë është të krijojmë një mjedis të shëndetshëm aty ku jetojmë duke punuar së bashku me fqinjët tanë për të përmirësuar cilësinë e jetës tonë.

Rahoveci komunë e zhvilluar, me mjedis të pastër dhe popullatë të shëndetshme.

I. HYRJE

Planet Lokale të Veprimit në Mjedis (PLVM) janë dokumente strategjike mjedisore vendore të cilat përcaktojnë prioritetet mjedisore dhe listën e veprimeve për zgjidhjen e tyre. Përgatitja e këtyre planeve zhvillon më tej aftësitë e pushtetit vendor dhe subjekteve të tjera të interesuara për mjedisin dhe komunitetin. Programi Lokal i Veprimit në Mjedis mëton të ndihmoj në zgjidhjen e problemeve mjedisore në nivel lokal, në rastin konkret komunën e Rahovecit.

PLVM është një pikë fillestare për zhvillimin e një komuniteti të qëndrueshëm. Ato ndihmojnë që bashkësia të ketë ekzaminuar dhe adresuar në mënyrë adekuate çështjet kryesore mjedisore që ndikojnë negativisht në shëndetin e njeriut dhe në shëndetin e ekosistemeve.

PLVM përfshin zhvillimin e *vizionit të komunitetit, vlerësimin e çështjeve mjedisore, përcaktimin e prioritetëve, identifikimin e strategjive më të përshatshme për adresimin e problemeve kryesore dhe zbatimin e veprimeve* me qëllim të arritjes së përmirësimeve reale mjedisore dhe shëndetësore.

Gjithashtu, PLVM nxit bashkëpunimin midis shoqërisë civile, publikut, pushtetit vendor dhe atij qendror, biznesit dhe subjekteve të tjera mjedisore, duke përkrahur shkëmbimin e lirë të informacionit dhe pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes.

1.1. Detyrimet ligjore për hartimin e PLVM-së

Përgatitja e PLVM-së është e detyrueshme për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore që kanë filluar procesin e asocim-stabilizimit dhe që synojnë të integrohen në BE. Për vendin tonë, hartimi i këtyre planeve nga qeverisjet vendore është detyrë ligjore, e përcaktuar në Nenin 24 i Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025

1.2. Qëllimet e Planit Lokal për Veprim në Mjedis

- a) **Zgjidhja e problemeve mjedisore** nëpërmjet identifikimit të prioritetëve dhe përcaktimit të veprimeve për zgjidhjen e tyre, duke përfshirë të gjithë akterët e mundshëm për përcaktimin e këtyre veprimeve sipas një Plani Veprimi.
- b) **Zhvillon shoqërinë civile** nëpërmjet forcimit të koordinimit dhe komunikimit ndërmjet sektorëve të ndryshëm në komunitet që përfaqësojnë interesa të ndryshme përfshirë autoritetet vendore, përfaqësues të OJQ-ve, biznesin, komunitetin shkencor.
- c) **Rrit aftësitë e qeverisjes vendore** dhe komunitetit për paraqitjen e elementeve thelbësore të planit të veprimit të komunitetit, duke vlerësuar problemet dhe mundësitë komunitare, duke organizuar komitete qytetare, përfshirë publikun, përcaktimin e prioritetëve, hartimin e strategjive dhe zhvillimin e një Plan - Veprimi.
- d) **Rrit shkëmbimin e informacioneve** në nivel lokal nëpërmjet sjelljes së shembujve dhe modeleve nga plane të mëparshme të komuniteteve nga të cilat pjesëmarrësit mund të nxjerrin ide dhe teknika të zbatueshme në rastet konkrete të tyre, të mbledhin me kujdes informacion mbi gjendjen e tanishme të mjedisit.
- e) **Ofron zgjidhje konkrete për problemet e komunitetit** me anë të shkëmbimit të përvojave lidhur me përdorimin e aftësive në analiza, planifikime, debate dhe vlerësime që janë thelbësore për një veprim të komunitetit efektiv. Duke u dhënë pjesëmarrësve mundësinë për të vënë në praktikë punën në grupe, duke u marrë me zgjidhjen e problemeve praktike nëpërmjet ndërveprimit të grupeve të vogla të punës.

1.3. Objektivat specifike të planit

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për Komunën e Rahovecit ka për synim:

- ❖ Zbutjen e degradimit mjedisor duke lidhur në mënyrë efektive proceset kryesore të planifikimit të zhvillimit në komunë
- ❖ Pozicionimin e komunës si akter kyç për identifikimin dhe bashkëpunimin me burimet e mundshme kombëtare dhe lokale të financimit për projektet prioritare komunale
- ❖ Përmirësimin kushteve të jetesës duke siguruar mbështetje financiare për projektet prioritare komunale
- ❖ Transparencën për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore
- ❖ Integrimin e metodës së qasjes me bazë gjinore për të identifikuar dhe vendosur prioritetet mjedisore në komunitetet lokale, dhe
- ❖ Krijimin e kapaciteteve të forta për të zhvilluar dhe zbatuar PLVM-në dhe për identifikimin dhe shfrytëzimin e opsioneve të financimit.

1.4. Metodologjia e përgatitjes së PLVM-së

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për komunën e Rahovecit u hartua përgjatë një periudhe 6 mujore dhe në hartimin e tij, janë përfshirë akterë të pushtetit vendor, kompanit për menaxhimin e mbeturinave Eko Regjioni dhe Eko Drinia ndërmarrja për ujësjellës dhe kanalizim KRU “Gjakova”, dhe përfaqësues nga shoqëria civile. Me qëllim të realizimit sa më të sukseshshëm por edhe në harmoni me Metodologjinë e hartimit të PLVM-së u ngrit një grup pune më specialistë të fushave të ndryshme (ambient, arkitekturë, turizëm, shëndetësi, bujqësi, arsim, sport, trashëgimi kulturore, etj.), të cilët punuan dhe bashkëpunuan edhe me ekspertë-tjerë vendor të angazhuar nga Eco Iliria për hartimin e PLVM-së.

Në kuadër të projektit për hartimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis (PLVM), janë realizuar një numër i konsiderueshëm i vizitave në organizatat që operojnë në komunën e Rahovecit e të cilat janë edhe ndotës potencial të mjedisit, si dhe organizatat komunale që merren me menaxhimin e mbeturinave, menaxhimin e ujit të pijes dhe ujërave të ndotura me qëllim të grumbullimit të të dhënave lidhur me problemet dhe aktivitetet e tyre për fushat respektive.

Dokumenti i hartuar bazohet në tri shtylla:

1. Analiza e gjendjes mjedisore - Analiza e gjendjes aktuale mjedisore pasqyron në mënyrë të detajuar situatën aktuale për të gjitha çështjet e marra në konsideratë nga plani, duke e paraqitur atë në të gjitha aspektet e tij dhe ndërveprimin ndërmjet tyre. Kjo analizë shërben për të pasur një ide më të qartë për problemet mjedisore, të cilat shqetësojnë komunën.

2. Lista e problemeve mjedisore - Problemet mjedisore paraqiten sipas një matrice të paracaktuar, e cila jep në mënyrë të detajuar të gjithë treguesit për identifikimin e një problemi. Pjesët më të rëndësishme të kësaj matrice janë shkaktarët, shkalla e ndikimit, popullata që preket, përgjegjësit e problemit dhe prioriteti për secilin problem.

3. Plani i veprimeve për zgjidhje - Ky kapitull është pjesa më e rëndësishme e Planit, pasi paraqet të gjitha veprimet dhe projektetet e mundshme për zgjidhjen e problemeve mjedisore të përcaktuara. Kjo matricë u shërben autoriteteve vendore për të hartuar projektetet konkrete dhe për sigurimin e fondeve nga donatorët.

II. PROFILI I KOMUNËS

2.1. Historiku dhe Pozita gjeografike

Rahoveci është ndër vendbanimet më të vjetra të Kosovës. Rahoveci si vendbanim daton qysh nga periudha e hershme Romako-Ilire (I. Cersakov) dhe këtë e dëshmojnë shumë fakte arkeologjike të cilat tregojnë se këto vise janë përplot me relikte të vendbanimeve të dikurshme antike. Me rastin e gërmimit të terrenit më 1953 me rastin e ndërtimit të bodrumit të verës në Rahovec, janë gjetur një numër sendesh arkeologjike (qypa të mëdhenj, monedha metali, maje të shtizave, elefanti i bronzës e tjera për të cilën mendohet se ka prejardhjen nga epoka e hershme romake. Në afërsi të Rahovecit në Bërnjakë supozohet të jetë vendbanimi i pare nga periudha Romake, e më vonë ka qenë i ndarë në dy vendbanime si Bërnjaka e Ulët dhe Bërnjaka e Epërme.

Në pjesën e dytë të shekullit XVIII, Rahoveci përmendet si qytezë, në vitin 1770 si qytezë "Ravac" por ka edhe emra të tjera që gjinden në harta të vjetra si që janë: Rahuaz apo Rahuiz, Rahova, Ravaz, Rahovce etj., ndërsa në vitin 1911 për herë të parë shkruhet në hartë si Orahovac (J. Cvijiqit). Gjatë vitit 1591 të gjitha vendbanimet e Anadrinisë kanë qenë nën sundimin Administrativ të nahisë së Hoçës së Vogël në të cilin kanë ekzistuar 96 fshatra (S. Rizaj).

Në pjesën e dytë të shekullit XIX në këtë territor bëhet themelimi i bajraqeve në kazan e Rahovecit, të Palluzhës dhe Hoçës së Vogël që i takonin regjionit të Prizrenit. Prej asaj kohe Rahoveci bëhet si qendër Administrative e bajrakut të dikurshëm të Hoçës së Vogël dhe Palluzhës.



Foto 1. Foto e qytetit të vjetër të Rahovecit




Foto 2. Rahoveci në vitin 1913

Territori i komunës së Rahovecit të sotëm përfshihet në regjionin e Prizrenit dhe ka një pozitë të mirë gjeografike. Shtrihet në pjesën qendrore të gadishullit Ballkanik dhe i takon Evropës juglindore.

Ky territor përfshin pjesën qendrore dhe jugore të rrafshit të Dukagjinit dhe është i ndarë në tri tërësi ose mikro regjione e këto janë: rrafshirë-luginore, kodrinore dhe malore. Territori i komunës shtrihet në hemisferën veriore të Ekuadorit me shkallë 42° e 30' dhe 42° e 50' të gjërsise veriore gjeografike dhe ndërmjet 20° e 21' dhe 20° e 55' të gjatësisë lindore gjeografike. Vendbanimet në komunën e Rahovecit janë të koncentruara në lartësitë mbidetare prej 310 m. (Krusha e Madhe pjesa e re e vendbanimit pjesa lindore e bregut të

lumit Drini i Bardhë) deri në 920 m. lartësi mbidetare që është i koncentruar vendbanimi i Zatriqit.



Figura 1. Pozita gjeografike e komunës së Rahovecit

2.2. Popullësia

Bazuar në regjistrimin e fundit të vitit 2011, Komuna e Rahovecit ka gjithsej 56.208 banorë prej të cilëve 28,512 janë meshkuj kurse 27,696 janë femra. Rahoveci si komunë ka një popullatë mjaft të re ku rreth 50% e popullatës janë të moshës prej 0-35 vjet.

Që nga viti 1948 kur komuna e Rahovecit kishte 20,287 banorë e deri më sot ka pasur një rritje të vazhdueshme të popullsisë dhe ajo në vitin 2010 kishte 56,208 banorë, që do të thotë se për këtë periudhë kohore (62 vjeçare) numri i popullsisë është rritur për më shumë se tri herë. Përafërsisht ka diku 276 km² dhe është vendbanim i rreth 60,000 banorëve, ndërsa vetëm në qytet jetojnë 29.854 banorë sipas vlerësimeve statistikore të vitit 2017. Bazuar në

vlerësimin e popullsisë, të cilin e bënë Agjencioni i Statistikave të Kosovës (ASK), çdo fundvit, Rahoveci në fund të vitit 2018 vlersohet të kishte 59,734 banor.




Figura 2. Numri i popullsisë sipas regjistrimeve nga viti 1948-2010

Popullsia e komunës së Rahovecit jeton në gjithsej 36 vendbanime, prej tyre 35 janë fshatra dhe vetë qyteti i Rahovecit. Këto vendbanime kanë dallime të theksuara sa i përket numrit të popullsisë. Në qytetin e Rahovecit banorë që do të thotë se rreth 29 % e popullsisë së tërësishme jeton në këtë qytet, ndërsa në të gjitha vendbanimet tjera jetojnë rreth 40316 banor apo rreth 71 %.

Tabela 1. Numri i banorëve sipas vendbanimeve

Nr.	Zona	Nr. Banorëve	Nr.	Zona	Nr. Banorëve
1	Rahovec	15892	19	Nushpal	220
2	Bellacerkë	2270	20	Opterushë	1911
3	Bërnjak	40	21	Pastasellë	1011
4	Bratotin	396	22	Pataqan I Eperm	533
5	Brestovc	1288	23	Pataqan I poshtem	1077
6	Celinë	1903	24	Petkoviq	731
7	Çifllak	1292	25	Polluzhë	808
8	Dobidol	799	26	Radostë	2346
9	Dejnë	1757	27	Ratkoc	3791
10	Drenoc	1587	28	Retijë e Ulet	234
11	Gexhë	660	29	Retijë	771
12	Hoqe e Madhe	124	30	Sapniq	996
13	Hoqe e Vogel	1166	31	Sarosh	6
14	Kaznik	164	32	Senoc	687
15	Kramovik	1125	33	Vrajakë	838
16	Krushe e Madhe	4473	34	Xërxë	3184
17	Mrasor	191	35	Zatniq	535
18	Nagavc	743	36	Zoqishtë	659
		Total		56208	

Burimi: PZHK Rahovec



Figura 3. Harta e zonave kadastrale dhe vendbanimet komunes

2.3 Klima

Në territorin e komunës së Rahovecit mbizotëron klimë kontinentale me ndikim mesdhetar. Reshjet mesatare vjetore në Rahovec arrijnë në 765 mm ndërsa reshjet maksimale arrijnë deri 1,047 mm. Temperatura mesatare e ajrit është 11,8 °C. Muaji më i nxehtë është korriku me një temperature maksimale prej 38,5 °C, ndërsa në dimër muaji më i ftohtë është zakonisht muaji shkurt, me një temperature minimale prej – 14,5 °C. Drejtimi i fryerjes së erërave verilindja (62 %), ndërsa më së paku fryjnë erërat e lindjes (17 %), jugut (14 %) dhe jug-lindja (4 %).

Temperatura mesatare gjatë vegjetacionit është +18,6°C (15 °C PZHK) por sasia e reshjeve gjatë vegjetacionit është vetëm 342,9mm (504 mm).

2.4 Struktura Demografike

2.4.1 Popullsia

Zhvillimi i popullsisë është një fushë mjaft me rëndësi për planifikim dhe zhvillim për të ardhmen. Të gjitha zhvillimet në hapësirë bëhen në interes të vet popullatës. Prandaj, analiza e zhvillimeve demografike është e domosdoshme për planifikim adekuat të zonës me theks të veçantë në kërkesat e popullsisë për resurset natyrore dhe balansim të tyre me qëllim të një zhvillimi të qëndrueshëm i cili nënkupton edhe mjedis të mbrojtur dhe të shëndoshë.

Të dhënat e popullsisë në nivel kombëtar apo lokal i ofrojnë qeverisë apo pushtetit vendor, institucioneve e organizatave, bizneseve e grupeve të interesit, institucioneve hulumtuese e akademike, analistëve, individëve e autoriteteve të tjera një pasqyrë gjithëpërfshirëse që do të ndihmojë në përgatitjen e planeve, strategjive, analizave e hulumtimeve të tyre, siç janë ato për strehim, shkollim, shëndet, shërbime të ndryshme, mjedis, transport, përpilim të projekteve etj.

2.4.2. Struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë

Që nga viti 1981 deri në vitin 2011, në Kosovë nuk kishte regjistrim të popullsisë. Deri në vitin 2011 në mungesë të të dhënave nga regjistrimet, vlerësohej se komuna Rahovecit kishte 59,625 banorë prej të cilëve rreth 29,854 banorë apo 50% e popullates jetonin në qytet dhe 50% në fshatra. Në bazë të rezultateve të regjistrimit të popullsisë në vitin 2011, Komuna e Rahovecit kishte 56,208 banorë prej të cilëve 28,512 meshkuj dhe 27,696 femra.

Vlerësimi i popullsisë së Kosovës është raport i rregullt vjetor njëherit praktikë dhe standard që kërkohet të bëhet çdo vit nga institucionet zyrtare të statistikave të një vendi e që si qëllim ka të sigurojë një vlerësim të saktë statistikor mbi popullsinë, i nevojshëm për institucione, organizata dhe individ. Sipas vlerësimit statistikor të Agjencionit të Statistikave të Kosovës i realizuar me 31 Dhjetor 2017, komuna e Rahoveci kishte 59,734 banorë.

Sa i përket raportit gjinor, ekziston një ndryshim i vogël gjinor në popullsinë e kësaj zone, ku popullsia mashkullore pak dominon me 50.07 %, në krahasim me popullsinë femrore që ka 49.93 % të popullsisë së përgjithshme.

2.4.3 Migrimet e popullsisë

Migrimet e popullsisë sot paraqesin një problem shumë dimensional hapësinor, demografik, ekonomik, social dhe politik, i nxitur nga një varg faktorësh të ndërlikuar dhe shpeshherë reciprocisht të lidhur dhe të kushtëzuar. Mungesa e të dhënave demografike në përgjithësi dhe për migrimet në veçanti, vështirëson punën dhe arritjen deri tek rezultatet e sakta mbi migrimet për këtë zonë. Sipas vlerësimeve të ndryshme, mund të thuhet se ka migrime të theksuara kryesisht nga viset më të thella rurale drejt qendrave urbane. Mirëpo, nuk duhet harruar se kemi të bëjmë edhe me migrime jashtë vendit, të cilët përbëjnë një numër jo të vogël të popullatës. Shkaqet që i kanë kushtëzuar këto migrime janë të natyrave të ndryshme, duke përfshirë ato ekonomike, punësimi, sociale, demografike dhe politike.

Gjatë vitit 2018 popullsia e Kosovës pati një rritje natyrore për 18,562 ose u rrite për 1.02%. Në vitin 2018 është vlerësuar se 8,967 persona ndërruan vendbanimin (komunën) e tyre kurse 6,762 persona imigruan (përfshi të kthyerit) mbrenda Kosovës derisa numri i emigrimit ishte dukshëm më i lartë ku 28,164 persona emigruan nga Kosova. Bilanci i migrimit ndërkombëtar (migrimi neto) në Kosovë për vitin 2018 ishte -21,402, ndërsa popullsia e Kosovës gjatë vitit 2018 është rritur për 18,562 banorë apo rritje vjetore prej 1.02%.

Popullsia rezidente e Kosovës, për periudhën 01 janar–31 dhjetor 2018 u zvogëlua për -2,840 banorë apo me -0.16%. Popullsia në Kosovë për vitin 2018 vlerësohet të jetë 1,795,666 banorë rezident.

Rahoveci si komunë bënë pjesë në pesë komunat e para për nga numri i emigrimit me gjithsej 1,696 banorë të emigruar, ndërsa numri i imigrimeve është mjaft i ulët vetëm 102 banorë. Përkunder shtimit natyror prej 632 banorë, si pasojë e emigrimeve Rahoveci ka një zvogëlim të popullatës prej -1,079 personave në raport me vlerësimin e fundvitit 2017.

Numri i emigrantëve në raport me numrin e popullsisë rezidente në Kosovë, dallon shumë në pjesët e ndryshme brenda vendit. Në komunat me numër të vogël të popullsisë rezidente, emigrimi ishte më i ulët siç janë: Shtërpca, Graçanica, Ranillugu dhe Mamusha nën 10%. Derisa, Rahoveci bën pjesë në 5 komunat me shkallë të emigrimit prej rreth 20-47% në raport me popullsinë rezidente (Gjilani, Suhareka, Malisheva, Rahoveci dhe Prizreni).

2.4.4 Vendbanimet dhe tipi i vendbanimit

Qyteti i Rahovecit ka një rregullim urban në të cilin tani jetojnë 29,854 banorë rezident apo 50%, ndërsa rreth 50% e banorëve jetojnë në zonat rurale në 35 fshatra. Shumica e këtyre vendbanimeve janë të vendosura më larg qendrave urbane dhe janë kryesisht vise rurale, të cilat janë fshatra tipike bujqësore. Karakteristikë e këtyre vendbanimeve është shkalla e lartë e autonomisë. Në shumicën e vendbanimeve kemi banim individual, kurse në Rahovec kemi edhe banim të përzier kolektiv dhe individual. Vendbanimet që ndodhen afër qendrave urbane dhe atyre afër rrugëve vërehen tendencat e zhvillimit linear, duke i përcjellë vijat komunikative, për këtë arsye objektet e banimit, si dhe ato të bizneseve, shtrihen përgjatë rrugëve magjistrale.

Numri më i madh i objekteve të banimit është ndërtuar në hapësirat më të rrafshta urbane, që njëkohësisht është edhe hapësira më e banuar. Për nga cilësia e materialit ndërtimor, sipërfaqes së ndërtuar dhe pajisjeve në hapësirat e banimit, vlerësohet se kjo zonë gjithashtu

disponon me një fond banesor mjaft cilësor. Si në çdo qytet tjetër edhe në Rahovec ka raste të ndërtimeve pa leje të cilat shkaktojnë probleme mjedisore, hapësinore dhe në ofrimin e shërbimeve komunale.

2.5. Administrimi territorial dhe qështjet sociale

2.5.1 Administrimi territorial

Zhvillimi i vendbanimeve dhe diferencimi i tyre hierarkik nuk janë veçori të pandryshueshme por janë procese dinamike që i nënshtrohen ndryshimeve të vazhdueshme si rezultat i zhvillimeve shoqërore, ekonomike, politike, demografike dhe fizike.

Në këtë kontekst ndarja territoriale dhe administrative ka një rëndësi të veçantë duke mundësuar funksionim dhe menaxhim më të mirë të të gjitha tërësive hapësinore të vendbanimit, tërësi këto që janë në ndryshim të vazhdueshëm.

Shtimi natyror në komunën e Rahovecit 623 banorë/vit apo koeficientin e rritjes natyrore prej 1.02% atëherë deri në vitin 2030 Rahoveci do të ketë rreth 6,853.00 banorë më shumë dhe kjo paraqet kërkesë për riorganizim territorial, kërkesë për resurse natyrore dhe shërbime (ujë, hapësirë, energji, kanalizim) gjegjësisht funksionimin e Rahovecit me qendrat urbane me ndarje territoriale dhe decentralizim të përgjegjësive në bashkësi lokale për menaxhimin dhe ofrimin më të mirë të shërbimeve dhe institucioneve sa më afër banorëve.

2.5.2 Çështjet sociale –infrastruktura sociale

Infrastruktura sociale është bazë për zhvillim të qëndrueshëm të një komuniteti, ajo para së gjithash ndihmon në ngritjen shpirtërore dhe intelektuale që në mënyrë të ndërsjelltë pasqyron në ngritjen e cilësisë së jetesës.

Synimet kryesore në aspektin social për një planifikim më të qëndrueshëm janë:

- ✓ Ofrimi i përkujdesjes ndaj fëmijëve për të gjitha familjet, posaqërisht përkujdesjes për fëmijët me nevoja të veçanta;
- ✓ Ndërtimi, përmirësimi dhe përparimi i institucioneve parashkollore, fillore dhe të mesme, ashtu që ato të ofrojnë vend për zhvillim kualitativ të mësimin;
- ✓ Planifikimi i institucioneve dhe përmbajtjeve të përgjithshme shërbyese publike në zona me qasje të lehtë për të gjithë;
- ✓ Ofrimi i shërbimeve për të moshuar, duke siguruar përkujdesje shëndetësore, por edhe siguri të strehimit.

Për zhvillim të shëndosh të komunitetit duhet që secili komunitet apo Bashkësi Lokale (lagje) të ketë qasje në përmbajtjet e saj lokale të domosdoshme si: çerdhe, shkolla, qendra shëndetësore, shitore, objekte hoteliere, postë dhe qendra të komunitetit. Të gjitha këto përmbajtje duhet të përfshihen mbrenda një radiusi (shtëpi—përmbajtje lokale) sa ma të përshtatshëm për banorët.

Në komunën e Rahovecit funksionon Qendra për punë sociale e cila merret me çështje të rëndësishme sociale siq janë: banimi social, shëndeti mendor, shtresat e shoqërisë si ata të moshuarit, integrimin e personave me çrregullime etj.

2.5.3. Arsimimi dhe Institucionet Arsimore

Struktura organizative e sistemit arsimor në komunën e Rahovecit është e organizuar në katër nivele: arsimin parashkollor (fëmijët e moshës 5 - 6 vjeçar), arsimin fillor (klasët I – V), arsimin e mesëm të ulët (klasët VI – IX) dhe arsimin e mesëm të lartë (klasët X – XII/XIII). Numri i objekteve shkollore gjithsej është 42, duke përfshirë edhe çerdhet dhe shkollat e mesme. Në procesin edukativo-arsimor në të gjitha nivelet e shkollimit janë të angazhuar rreth 846 punëtorë, prej të cilëve janë 710 mësues/mësueses. Numri i nxënësve është gjithsej 14,526, që do të thotë se kemi një raport prej 20.4 nxënës /mësues/mësueses.

Numri i nxënësve në të gjitha nivelet e arsimimit në komunën e Rahovecit sipas Statistikave të Arsimit 2015/16 është 11,568 nxënës apo student. Struktura gjinore e tyre është 6,163 meshkuj dhe 5,405 femra.

a) Institucionet parashkollore

Ashtu si toka që edhe nëse është pjellore, nuk mund të prodhojë asgjë pa kultivim, kështu as mendja e njeriut pa arsim nuk mund të prodhojë rezultate të pritura.

Rrjeti i institucioneve parashkollore është para së gjithash nevojë sociale me qëllim të përgatitjes së fëmijëve për shkollim të rregullt dhe për kujdes të fëmijëve deri sa prindërit janë në punë. Në suaza të planifikimit urban do duhej të parashihen lokacionet e përshtatshme për institucione parashkollore.

Sipas Statistikave të Arsimit 2015/2016 të prodhuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) numri i fëmijëve në arsimim parashkollor në komunën e Rahovecit nga 0-5 vjeçar ishte vetëm 44 fëmijë ndërsa në arsimim parashkollor prej moshës 5-6 vjet në qytetin e Rahovecit përshihen 793 fëmijë por sipas këtyre statistikave nuk ka asnjë institucion parashkollor në komunë. Ndërsa sipas të dhënave nga PZHK në qytet ka vetëm 1 çerdhe – shqipe dhe 6 (gjashtë) institucione parashkollore private me gjithsej 837 fëmijë. Numri i kopshteve është i vogël dhe shumica e tyre janë përqendruar në qytetin e Rahovecit.

Sipas standardeve, normat për planifikimin e institucioneve parashkollore duhet të jenë:

- ✓ 2000-2500 banorë një çerdhe/kopsht
- ✓ Qasshmëria me distancë prej 400 m me dendësi 80—100 ban/ha dhe distancë 600 m me dendësi 40—60 ban/ha
- ✓ Sipërfaqja e lokacionit 25 m² / fëmijë (0.25—0.3 ha)
- ✓ Sipërfaqja e ndërtesës bruto 4.5-6.5 m² / fëmijë
- ✓ Ndërtesa duhet të ketë maximum 120 fëmijë.

b) Institucionet e edukimit fillor dhe të mesëm të ulët

Arsimi dhe edukimi fillor në komunën e Rahovecit zhvillohet në 27 shkolla fillore shqipe, 2 shkolla fillore serbe, 5 shkolla të mesme prej të cilave 4 shkolla të mesme shqipe, 1-shkollë e mesme serbe. Struktura gjinore e nxënësve është 4,373 meshkuj dhe 3,902 femra. Nisur nga numri i përgjithshëm i banorëve të komunës mesatarisht kemi nga 2,306 nxënës/shkollë por duhet theksuar se në qytet ky numër është shumë më i madh se në fshatra si pasojë e

migrimeve fshat-qytet. Sigurimi i shkollave lokale lehtë të arritshme është thelbësore për shërbimin dhe rigjallërimin e komunitetit lokal.

Kriteret / normat për planifikimin e institucioneve të edukimit fillor duhet të jenë:

- ✓ Institucionet e edukimit fillor duhet të mbulojnë një numër prej 4000 banorësh;
- ✓ Secila Bashkësi Lokale duhet të përmbajë një shkollë fillore;
- ✓ Qasshmëria shtëpi—shkollë fillore duhet të arrijë distancë të lëvizjes (ecje / biçikletë) prej 500 m deri në 800 m, varësisht prej dendësisë së banimit të qytetit;
- ✓ Sipërfaqja e nevojshme e lokacionit duhet të jetë prej 1-2 ha
- ✓ Hapësira e nevojshme shkollore 3—5 m² / nxënës (hapësirat e mësimit 60 m²);
- ✓ Raporti nxënës –mësimdhënës duhet të jetë nga 22 deri në 42 nxënës
- ✓ Numri i nxënësve duhet të jetë prej 200 deri 500, (një klasë 27 deri 37 nxënës);
- ✓ Mësimi shkollor duhet të mbahet në një ndërrim.

c) Institucionet e edukimit të mesëm të lartë

Niveli i arsimit të mesëm i lartë përfshin nivelin tre (3) sipas SNKA-së (Klasifikimi standard ndërkombëtar i arsimit) në Kosovë dhe organizohet në gjimnaze dhe shkolla profesionale. Arsimi i mesëm në Rahovec zhvillohet në 4 shkolla të mesme të larta me gjithsej 2,456 prej të cilëve 1,371 nxënës janë meshkuj ndërsa 1,085 femra.

Kriteret / normat për planifikimin e institucioneve të edukimit të mesëm duhet të jenë:

- ✓ Institucionet e edukimit të mesëm duhet të mbulojnë një numër prej 8000 deri 16000 banorë (për shkolla të mëdha);
- ✓ Qasshmëria shtëpi-shkollë e mesme preferohet të arrijë distancë të lëvizjes (ecje/biçikletë) prej 1000 m deri në 1500 m, varësisht prej dendësisë banimore të qytetit;
- ✓ Sipërfaqja e nevojshme e lokacionit duhet të jetë prej 4 - 6 ha;
- ✓ Numri i nxënësve duhet të jetë prej 500 deri 750;
- ✓ Raporti nxënës/mësimdhënës duhet të jetë nga 22 deri në 42
- ✓ Hapësira e nevojshme shkollore 3-5 m² / nxënës (dhomat e mësimit/klasat 60 m²);

Përveç këtyre normave themelore për planifikim të lokacionit duhet të merren parasysh kushtet e përshtatshme klimatike, pa pluhur, larg transportit rrugor të dendur dhe lidhje të mirë me sipërfaqet e gjelbëruara.

2.5.7 Institucionet shëndetësore

Në komunën e Rahovecit, mjekësia familjare është shtylla kryesore e shëndetësisë e cila udhëhiqet nga Drejtoria e Shëndetësisë. DSH organizon punën në shërbimet primare shëndetësore, shërbimet sociale dhe shërbimet të inspektimit sanitar.

Në komunën e Rahovecit shëndetësia është e organizuar në sektorin publik, ku ofrohen shërbime të nivelit parësor, dhe në sektorin privat i cili ofron shërbime parësore të lemive të specializuara mjekësore. Në sektorin publik, kujdesi primar shëndetësor është i organizuar në 10 objekte shëndetësore:

- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në qytetin e Rahovecit
- 6 QMF në vendbanimet: Ratkoc, Bellacerkë, Qifllak, Drenovc, Krushë e Madhe dhe Opterush, 3 ambullanta në: Hoqë të Madhe, Lagjen për minoritete dhe Zoqisht.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Rahovec, si bartëse e kujdesit primarë, është e vendosur në qytetin e Rahovecit dhe ka gjendje fizike të kënaqshme.

Kjo qendër mbulon me shërbime territorin e Rahovecit dhe fshatrat përreth. Në këto institucione janë të punësuar gjithsej 87 punonjës, 28 mjek dhe 59 infermier - teknik.

Spektori privat shëndetësor kryesisht është i organizuar në ambulanca të vogla të specializuara me nga 1 apo 2 specialistë dhe të pajisura më mjetet më të domosdoshme për punë. Më të shumta janë ambulancat private stomatologjike, që punësojnë me shumë se një stomatolog.

Në sektorin farmaceutik ekzistojnë x barnatore private dhe x barnatore publike. Furnizimi me barna kryesisht është i kënaqshëm, sidomos në barnatoret private, ku llojshmëria dhe cilësia e medikamenteve është më e mirë.

Institucionet shëndetësore në aspektin hapësinor dhe të funksionimit duhet të jenë të pajisur në atë mënyrë që të mund t'iu mundësojnë secilit individ të gjitha shërbimet jashtë nivelit të spitalit duke u bazuar në metodat bashkëkohore të punës.

Standartet për institucione shëndetësore janë:

- Ambulanca / 6,000 banorë.
- Qendra e Mjekësisë Familjare / 10,000 banorë.
- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare / 100,000 banorë.
- Raporti mjek, motër / numri i banorëve duhet të jetë një mjek + dy motra / 2000 banorë.
- Afërsia e ndërtesave shëndetësore duhet të jetë prej 500 m deri 2500 m.

Sipas kriterëve evropiane sipërfaqja e nevojshme e lokacionit duhet të arrijë 4 deri 8 ha ndërsa sipërfaqja e ndërtesës 1.2 m² / banorë.

2.5.8 Institucionet kulturore dhe sportive

a) Institucionet dhe objektet e kultures

Në Komunën e Rahovecit zhvillohen aktivitete të ndryshme kulturore : Muzikore, Teatrale, Bibliotekare, Ekspozitat e ndryshme, etj. Këto aktivitete zhvillohen në Qendrën Kulturore në Rahovec, Shtëpinë e Kulturës në Krushë të Madhe, Shtëpinë e Kulturës në Hoçë të Madhe si dhe në Qendrën Rinore në Rahovec. Aktivitetet kulturore organizohen kryesisht nga drejtoria komunale në bashkëpunim me shoqatat dhe klubet kulturore si “Art-Studio”, “Nirvana-Club”, Shoqatën e Artistëve të Komunës së Rahovecit, Shoqatën e Enigmatëve Labirinti, Shoqëritë Kulturo Artistike: “Rahoveci”, “Bajram Curri”, “Heronjë e Kosovës”, “Anadrinia”, “Vëllezërit Frashëri”, dhe grupet muzikore “Boemat”, “Sokolat” etj.

Shtëpinë e Kulturës në Krushë të Madhe e renovuar tërësisht, me ndihmën e CDF-it dhe K.K. Shtëpinë e Kulturës në Hoçë të Madhe, që duhet të renovohej.

Bibliotekën në Rahovec, me rreth 5000 libra ekzemplarë. Bibliotekën në Krushë të Madhe, me rreth 4000 ekzemplarë. Bibliotekën në Hoçë të Madhe posedon rreth 2000 ekzemplarë. Galerinë e arteve që i ka kushtet shumë të mira për ekspozim. Gjatë një viti në të ekspozohen minimumi 12 ekspozita. Teatrin, që funksionon në baza amatore dhe vullnetare.

Sallën e kinemasë në shtëpinë e Kulturës me 430 ulëse. Kjo sallë nuk funksionon në mungesë të kino-projektorëve

Trashëgimia kulturore në komunën e Rahovecit nga koha Ilire e deri tani është e larmishme po fatkeqësisht pa mbrojtje të duhur institucionale nga se shumë vlera të tilla janë shkatërruar dhe ju kanë ekspozuar kohës dhe faktorit njeri. Ky thesar i çmuar i kulturës duhet vënë nën

mbrojtje si: Sahat Kulla në Rahovec, që daton nga viti 1206, që dikurë ishte kështjellë e vogël Ilire, kullat e Anadrinit, Kalaja e Durmanit shek. III dhe IV, Kalaja e Kështjelles (Zatriq, Gexhë, Gurkuq, etj

Shoqëritë kulturo-artistike, grupet muzikore e artistike, dhe shoqatat e ndryshme, zhvillojnë aktivitete në këto objekte kulturore. Ato financohen kryesisht vetë. Gjithashtu, në pjesën veriore të Rahovecit është ndërtuar qendra kulturore për minoritetet, e cila udhëhiqet nga shoqata Gjermane Shuler Helpe Leben. Kjo qendër është rehabilituar pas luftës nga organizatat gjermane “Shuler Helfen Leben” dhe “AMICA”. Para masave të dhunshme serbe të viteve 1990-1999, komuna e Rahovecit ka pasur 4 biblioteka publike me një numër prej gjithsej 49.106 librash. Biblioteka kryesore ka pasur 15.320 libra, ndërsa degët në Drinas, Krushë të Madhe, Xërxë, Hoçë të Madhe kanë pasur 33.786 libra, por lufta dhe masat e dhunshme serbe të viteve 1990-1999, kanë zhdukur rrjetën librare dhe stoqet e librave të kësaj komune. Nxënësit ndjekin mësimet në 19 shkolla fillore dhe në një shkollë të mesme, të ndara me paralelet në Krushë të Madhe dhe Drinas.

Sa i përket zonave të veçanta të mbrojtura për komunën e Rahovecit duhet respektuar dhe zbatuar: Ligji Nr. 03/L-039 PËR ZONAT E VEÇANTA TË MBROJTURA. Në këtë komunë janë dy zona që kanë karakter të veçantë të mbrojtjes :

1. Manastiri i Zoqishtës, Zoqishtë, dhe
2. Fshati Hoqë e Madhe, Hoqë e Madhe.

Objektet e mbrojtura të propozuara nga Drejtoria për kulturë ,sport dhe rini

- Sahat Kulla, Rahovec
- Vendi i rënies së dëshmorëve Toni e Mici në Opterushë
- Varrezat e Dëshmorëve në Rahovec
- Përmendorja e Tonit e Micit në Rahovec
- Shtabi i UÇK-së në Drenoc
- Shtabi i UÇK-së njësia “Arti” në Rahovec
- Maja e Shkodranit në Rahovec
- Xhamia e Qarshisë në Rahovec
- Kulla e Meriqëve në Rahovec
- Kroi i Haxhinjve në Rahovec
- Kroi në Sheshin e Republikës
- Kështjella (kalaja e Durmanit) në Rahovec
- Arti në gur në Zatriq
- Kisha Ortodokse në Rahovec
- Varrezat Bizantine në Reti
- Kulla e Mahmut Pashës dhe varrezat Bizantine në Opterushë
- Ura e Shenjtë në Drini i Bardhë
- Shtëpia muze e Ukshin Hotit në Krushë të Madhe
- Varrezat e Shtavicës
- Bodrumi i Vjetër në Rahovec
- Vendi ku u zhvillua beteja e Gradishit (Gegjë)

- Pika e vrojtimit të UÇK-së “Vlora” në Drenoc
- Vendi i fushëbetejës së UÇK-së në Guri të Kuq
- Fushëbeteja në Bratotin-Ratkoc (12 maj 1998)
- Beteja e Fortesës (18 korrik 1998) në Fortesë
- Shtabi i UÇK në Reti
- Beteja e Kramovikut (1998) në Kramovik


2.5.6 Monumentet natyrore

Llojllojshmëria e monumenteve natyrore të karakterit botanik, hidrologjik, gjeomorfologjik të komunës së Rahovecit, si dhe peizazheve të ndryshme natyrore, që kanë përhapje në territorin e komunës konsiderohen vlera të trashëgimisë natyrore.

Në territorin e komunës së Rahovecit shtrihet një pjesë e sipërfaqes së zonës së mbrojtur të Kanionit të Drinit të Bardhë te Ura e Fshejt, Monument natyror me karakter hidro-gjeomorfologjik që është shpallur në vitin 1986, me sipërfaqe 126.5 ha dhe Parku regjional i Mirushes 198.77 ha 1983 monument natyre me ujëvara të njëpasnjëshme



Për shkak të vlerave natyrore janë propozuar për mbrojtje edhe këto monumente të natyrës:

1. Nagavc- Trungu i Bungu
2. Dabidol- Trungjet e dushkut
3. Bratotin- Trungu i Shpardhit
4. Bratotin- Trungu i Qarrit
5. Drenovc-Trungjet e Shpardhit
6. Kaznik- Trungjet e Shpardhit
7. Vëranjakë- Trungjet e vidhit
8. Pataçan i Ulët-Trungjet e dushkut
9. Brestovc – trungjet e dushkut (lisi i Bajraktarit)



Trungu i Bungut (*Quercus petraea*) – gjendet ne fshatin Nagavc të Rahovecit përkatësisht gjendet në varreza të fshatit. Karakteristikat kryesore të këtij monumentit të natyrës janë këto: Sipërfaqe prej **5 ari**. Vjetërsia mbi **500 vite**. Lartësia e kërcellit është rreth **35 m**, perimetri i kërcellit është rreth **6 m** diametri i kurorës është rreth **24 m**.


Trungjet e Dushkut (*Quercus sp.*) – gjendet në fshatin Dabidol të Rahovecit. Karakteristikat kryesore të këtij monumentit të natyrës janë këto: Sipërfaqe prej **13 ari**. Vjetërsia është mbi **250 vite**. Lartësia e kërcellit është rreth **20-30 m**, perimetri i kërcellit është rreth **2.70 – 3.70 m**, diamteri i kurorës është rreth **20-25 m**.



Trungu i Shpardhit (*Quercus frainetto*) – gjendet në fshatin Bratotin të Rahovecit, përkatësisht në zonën kadastrale Bratotin. Karakteristikat kryesore të këtij monumentit të natyrës janë këto: Sipërfaqe prej **5 ari**. Vjetërsia është mbi **500 vite**. Lartësia e kërcellit është rreth **24 m**, perimetri i kërcellit është rreth **4.40 m** diametri i kurorës është rreth **24 m**.


Trungjet i Qarrit (*Quercus cerris*) - gjendet në fshatin Bratotin të Rahovecit. Karakteristikat kryesore të këtij monumentit të natyrës janë këto: Sipërfaqe prej **7 ari**. Vjetërsia rreth **350 vite**. Lartësia e kërcellit është rreth **30 m**, perimetri i kërcellit është rreth **3.60 – 4.10 m**, diametri i kurorës është rreth **24 m**.






Trungu i shpardhit (*Quercus frainetto*) – gjendet në fshatin Drenoc të Rahovecit. Karakteristikat kryesore të këtij monumentit të natyrës janë këto: Sipërfaqe prej **4 ari**. Vjetërsia është rreth **450 vite**. Lartësia e kërcellit është rreth **22 m**, perimetri i kërcellit është rreth **3.50 m**, diamteri i kurorës është rreth **1.70m**.

Trungu i shpardhit (*Quercus frainetto*) – gjendet në fshatin Drenoc të Rahovecit, Karakteristikat kryesore të këtij monumentit të natyrës janë këto: Sipërfaqe prej 4 ari. Vjetërsia mbi **350 vite**. Lartësia e kërcellit është rreth **37 m**, perimetri i kërcellit është rreth **3.80 m**, diamteri i kurorës është rreth **1.40 m**.



Trungu i Shpardhit (*Quercus frainetto*) – gjendet në fshatit Kaznik të Rahovecit, Karakteristikat kryesore të këtij monumentit të natyrës janë këto: Sipërfaqe prej **3.5 ari**. Vjetërsia rreth **300 vite**. Lartësia e kërcellit është rreth **15 m**, perimetri I kërcellit është rreth **4.20 m**, diamteri i kurorës është rreth **18 m**.

Trungu i Shpardhit (*Quercus frainetto*) – gjendet në fshatit Kaznik të Rahovecit. Karakteristikat kryesore të këtij monumentit të natyrës janë këto: Sipërfaqe prej **7.69 ari**. Vjetërsia është rreth **400 vite**. Lartësia e kërcellit është rreth **13 m**, perimetri i kërcellit është rreth **4 m**, diamteri i kurorës është rreth **13 m**.



Në këto monumente rekomandohet të vendoset nga një pllakë identifikuese me të gjitha karakteristikat për secilin monumente natyror edhe të rrethohen sepse i përmbushin të gjitha kriteret në bazë të ligjit që janë shpallur si Monumente Mbrojtëse të Natyrës përkatësisht sipas Nenit 3 këto monumente kategorizohen si vlerë e Natyrës e kategorisë III –të, sipas IUCN – Monument Natyror.

2.5.7 Kushtet ekonomike dhe sociale ne Komune

Duke marrë parasysh kushtet e favorshme topografike, pedo-klimatike dhe agro-ekologjike puna në bujqësi, vreshtari dhe verari përbënë aktivitetin themelor ekonomik në Rahovec në të gjitha aspektet duke përfshirë prodhimin, burimin e të ardhurave dhe punësimin e qytetareve të komunës.

2.5.8 Bujqësia në komunë

Bujqësia si degë e ekonomisë, është bartëse e zhvillimit ekonomik në komunën e Rahovecit dhe si e tillë duhet ti kushtohet vëmendje e posaçme si nga udhëheqësia komunale ashtu edhe ato shtetërore.

Kushtet pedo-klimatike janë të përshtatshme dhe mundësitë e mëdha të ujitjes, bëjnë të mundur që në Rahovec të kultivohen me sukses të gjitha kulturat bujqësore si: drithërat, pemët, vreshtat, perimet e poashtu ka kushte edhe për zhvillimin e blegtorisë dhe shpeztarisë. Përderisa edhe industria ushqimore përpunuese është duke u zhvilluar në aspektin e modernizimit dhe ngritjes së kapacitetve, por Rahoveci si komunë njihet kryesisht si prodhuese e madhe e rrushit dhe perimeve.

Pjesa më e madhe e banorëve në komunën tonë merren me kultivimin, grumbullimin dhe përpunimin e perimeve si dhe kultivimin e kulturave lavërtarë dhe vreshtarisë.

Prioritetet që duhet ti jepen bujqësisë janë:

- ❖ Transformimi i fermave të vogla familiare në ato të mëdha komerciale,

- ❖ Shfrytëzimi i praktikave më të mira bujqësore dhe aplikimi i tyre, (mbrojtje e integruar e bimeve, farëra cilësore me potencial të lartë prodhues etj.).
- ❖ Ofrimi i mbështetjes institucionale,
- ❖ Ofrimi i shërbimeve këshillimore dhe përkrahjes teknike

Sipas shënimeve të Agjencisë së Statistikave të Kosovës komuna e Rahovecit ka 13.600 hektar tokë bujqësore. Sipërfaqet e tokës bujqësore të cilat shtrihen përgjatë shtratit të lumit Drini i Bardhë në lartësi mbidetare prej 310 – 350 m, janë toka aluviale me pjellori të lartë në të cilat kultivohen kulturat bujqësore intenzive si që janë kulturat perimore (speci, domatja, patatja, trangulli, shalqini, karrota e tjera) por edhe kulturat lavërtare ku dominojnë gruri dhe misri. Në zonat kodrinore në lartësi mbidetare prej 350 – 600 m dominon toka e tipit Smonice ku kryesisht kultivohen kulturat lavërtare pranverore dhe vjeshtore, kulturat shumëvjeqare (vreshtat dhe pemishtet), ku bëjnë pjesë edhe kullosat.

Ndërtimi e objekteve të banimit, atyre hoteliere, pompat e benzinës si dhe objektet tjera industriale kanë ndikuar shumë në zvogëlimin e sipërfaqeve të tokave bujqësore. Një dukuri tjetër që ndikon në degradimin e tokave bujqësore është edhe eksploatimi i zhavorrit në tokat bujqësore kryesisht përgjatë lumit Drini i Bardhë. Nëse ky trend i ndërrimit të destinimit të përdorimit të tokave do të shkaktoj edhe zvogëlimin e prodhimit bujqësor.

Struktura e të mbjellurave kryesore në Rahovec:

- ❖ Grur - 2,400 ha
- ❖ Misër – 2,100 ha
- ❖ Perime - 3,000 ha
- ❖ Vreshta – 2,168 ha

Në 11 zona kadastrale të komunës shtrihet edhe sistemi i ujitjes me të cilin menaxhon Kompania Regjionale e Ujitjes KRU „Radoniqi-Dukagjini, me seli në Gjakovë nga i cili sistem në Rahovec ujiten 2.658,63 ha tokë të punueshme bujqësore, ku kryesisht ujiten perimet (speci, domatja, lakra, shalqini, pjepri, qepa etj.) misri dhe kulturat furaxhere (jonxha, misri për sillaxh apo livadhet).




Figura 4. Harta e zonave kadastrale ku shtrihet sistemi I ujitjes KRU Radoniqi

Disa nga problemet madhore prezente në lëmin e bujqësisë krahas shndërrimit të tokave bujqësore në toka jo bujqësore, mos shfrytëzimi i tokave bujqësore publike/ të sektorit shoqëror janë edhe politikat e pafavorshme fiskale për prodhuesit bujqësor, kredi me kamata të larta dhe pasiguria e tregut për plasmanin e prodhimeve bujqësore e sidomos të prodhimet e perimkultuës.

2.5.9. Blegtoria dhe shpeztaria

Krahas prodhimtarisë primare bimore blegtoria është një aktivitetet tjetër ekonomik si degë tjetër kyçe e bujqësisë në Rahovec. Ka karakter ekstensiv pasi që një numër i kufizuar i fermerëve merret me këtë veprimtari dhe kryesisht prodhohet për përmbushjen e nevojave familjare e pak për treg. Prej blegtorisë kultivohen: gjedhet, delet, dhitë, kuajt, buallicat, etj. Kohëve të fundit ka tendencë të kalimit të kësaj dege të bujqësisë në blegtori intensive, me përmirësimin e racës së gjedhit vendor busha në racë simentale, montafone etj. Për mbarshtrimin e blegtorisë në komunën e Rahovecit kujdeset stacioni i veterinarisë në Rahovec që nga viti 1960.

Nga të dhënat më të reja nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural të komunës së Rahoveci, kemi: Gjedhe të imta 7,084 krerë; Gjedhe të trasha 8,892 krerë dhe shpezë 38,700 sosh.

Viteve të fundit ka filluar kultivimi intensiv i shpezëve ku janë ndërtuar disa mini-ferma të pulave, si në fshatrat Celinë, Krushë të madhe, Opterushë, Qifllak etj.

2.6.0. Veprimtari tjera ekonomike

Sektori i industrisë në Komunën e Rahovecit, bazohet kryesisht në industrinë agro-industriale, përpunimin e rrushit dhe të gurit, industrinë e plastikës, ndërtimtari, teknologji përpunuese të metaleve, teknologjive për ngrohje dhe ftohje, artizanate, objekte tregtie, shërbime etj. Pas luftës, ndërmarrjet e vogla kanë shfaqur tendencën për shfrytëzimin dhe përpunimin e gurit, rërës, zhavorit dhe argjilës, evidente me një shkatërim joselektiv të resurseve natyrore.

2.6.1. Turizmi dhe hoteleria

Turizmi është më pak i zhvilluar, edhe pse Rahoveci është njëri ndër qytetet më të vjetra të Kosovës, me relikte të vendbanimeve të dikurshme antike, të cilat rrjedhin nga epoka e hershme romako-ilire

Në përgjithësi zona e Dukagjinit është përplot me trashëgimi arkitekturore, shpirtërore, fetar, etnologjike etj. Poashtu resurse për një turizëm rekreativ ekzistojnë në kanionin e Drinit të Bardhë. Turizmi kulturor kryesisht mund të jetë i bazuar në trashëgimi kulturore/arkitekturore: shtëpitë tradicionale, turizëm kulturor arkeologjik, 17 shpella, hamame, trashëgimi arkitekturore dhe fetare në Hoçën e Madhe 18 , e cila tashmë është edhe e mbrojtur me pakon e Ahtisarit 19 nga e cila derivon dhe Ligji për Mbrojtjen e Zonave të Veçanta të Mbrojtura 20 dhe në hartim e sipër përderisa flasim është Ligji për Hoçën e Madhe.




Foto 7. Kanioni i lumit Drini i Bardhe



Foto 8. Ura e Fshajt




Foto 9. Kisha e Shën Nikollës shek. 14



Foto 10. Kisha e Shën Llukës shek. 16-të

III ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE MJEDISORE

Gjendja e përgjithshme mjedisore në Kosovë është jo e mirë si pasojë e aktiviteteve të pa menaxhuar mirë si ndërtimet pa plan, ndotja nga trafiku, menaxhimi jo përkatës i mbeturinave dhe ujërave të zeza dhe aktivitetet ekonomike dhe industriale. Problemet serioze mjedisore lidhen me shfrytëzimin jo racional të burimeve natyrore të cilat pastaj shkaktojnë ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës, prishin pejsazhin, kërcënojnë biodiversitetin dhe burimet natyrore. Përkundër progresit të konsiderueshëm që është bërë në vitet e fundit si rezultat i shumë iniciativave dhe përmirësimeve, dëmtimet dhe degradimi i burimeve natyrore (pyjet, tokat bujqësore dhe ato pyjore, burimet ujore, flora dhe fauna) vazhdon.

3.1 Ajri

Ajri i pastër është me rëndësi vitale për shëndetin e njeriut dhe të mjedisit. Mirëpo zhvillimi i hovshëm dhe i pakontrolluar ekonomik, sidomos zhvillimi industrial dhe trafiku ndikojnë në përkeqësimin e cilësisë së ajrit dhe mjedisit si rezultat i shkarkimeve të ndryshme në ajër, ujë dhe tokë.

Sipas një studimi të Ministrisë së Mjedisit në Zelandën e Re, njeriu thith rreth 14,000 litra ajër në ditë duke u ekspozuar kështu para shumë rreziqeve potenciale. Ajri i ndotur ka efekt negativ posaçërisht tek fëmijët, të moshuarit si dhe ata që kanë probleme me frymëmarrje dhe me zemër.

Efekti i sëmundjeve, vdekjeve të parakohshme dhe uljes së nivelit të produktivitetit në punë ndikon drejtpërdrejtë në ekonominë e një vendi duke rritur kështu rëndësinë e trajtimit të kësaj çështjeje.

Qytetin e Rahovecit e karakterizon një trafik mjaft i dendur, me numër të madh makinash, që brenda ditës qarkullojnë nëpër qytet. Mungesa e vendeve të mjaftueshme për parkim, makina të vjetra dhe dendësia e qarkullimit drejtpërdrejtë ndikojnë në ndotjen e madhe të ajrit dhe kanë ndikim në shëndetin e popullatës.

Ndotja e ajrit nga shfrytëzimi i mineraleve/gurthyesve në zonat periferike të qytetit dhe vendet rurale janë një burim tjetër i madh i ndotjes së ajrit në zonat përreth tyre por edhe më gjerë.

Një burim tjetër i ndotjes së ajrit është edhe ngrohja e shtëpive apo banesave kolektive gjatë sezonit të dimrit e sidomos përdorimi i thëngjillit apo lëndëve tjera djegëse, cilësia e të cilave nuk është e kontrolluar. Përdorimi i gazit natyral në amvisëri është ende i kufizuar. Trendi i ndërhyrjeve për përmirësimin e izolimeve të objekteve ekzistuese apo objekteve të reja të banimit pritet të japin efektet pozitive në zvoglimin e përdorimit të energjisë për ngrohje.

Aplikimi i burimeve alternative të energjisë, si panelet diellore, apo përdorimi i burimeve tjera energjetike ka një ndikim mjaft të mirë në përmirësimin e cilësisë së ajrit por ky trend po shënon rritje shumë të ngadaltë.

3.1.2 Monitorimi i Cilësisë së Ajrit

Institucioni i mandatuar për monitorimin e cilësisë së ajrit në Kosovë është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor përmes Institutit Hidro-Meteorologjik të Kosovës (IHMK).

Në bazë të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit, Nr.03/L-025, Ligjit i mbrojtjes së ajrit nga ndotja, Nr.03/L-160 dhe Ligjit për veprimtarinë hidrometeorologjike, Nr.02/L-79, IHMK është i obliguar që të bëjë monitorimin e cilësisë së ajrit në tërë territorin e Kosovës.

Por në territorin e komunës së Rahovecit nuk ka pika monitoruese të cilësisë së ajrit, andaj në një të ardhme të afërt do duhej të vendosen instrumente monitoruese në disa pika. Mungesa e të dhënave nga monitorimi i cilësisë së ajrit si pasqyrim i plotë i nivelit të vërtetë të ndotjes së ajrit pamundëson edhe marrjen e veprimeve për zvogëlimin apo parandalimin e ndotjes.

3.1.5 Vlerësimi i shkaqeve dhe kërcënimet në cilësinë e ajrit

Ka pak informata në dispozicion për numrin e automjeteve motorike për km rrjet rrugor, llojin e veturave dhe formën kryesore të sistemeve ngrohëse, duke e vështirësuar kështu parashikimin e ndikimit real të këtij lloji të emetimit në cilësinë e ajrit në komunë.

Veturat në Kosovë janë përgjithësisht të vjetra, në klasën e emetimeve Euro-1 deri në Euro-3, (derisa në Europë po kalohet nga Euro-4 në Euro-5) dhe për pasojë shkalla emetuese specifike për veturë është mjaft e lartë. Cilësia e lëndëve djegëse që importohen siç janë peleti, nafta dhe gazi natyror gjithashtu janë një burim tjetër që ndikon në ndotjen e ajrit.

Cilësia e rrugëve dhe problemet që lidhen me shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe pamjaftueshmërinë e tyre si dhe mungesa e vend-parkimeve kontribuojnë gjithashtu në rritjen e sasisë së pluhurit dhe të ndotësve tjerë në ajër nga automjetet. Në zonat rurale ndikim negativ në cilësinë e ajrit krahas rrugëve të paasfaltuara kanë edhe guroret dhe minierat të cilat në territorin e Rahovecit janë në numër. Një burim specifik i ndotjes së ajrit në përgjithësi në Kosovë por edhe në Rahovec është djegia e mbeturinave, gomave dhe hamulloreve në ara të korrura.

3.1.6 Burimet kryesore të ndotjes

- Niveli i lartë i përqendrimit të emetimeve të pluhurit, pluhurit fluturues, thërmija të pluhurit, bloza, SO₂ dhe Nox, si rezultat i trafikut të dendur, cilësia jo e mirë e karburateve dhe ngrohjes sezonale ndikojnë drejtpërsëdrejti në ndotjen e ajrit në qytet por edhe në gjithë hapsirën e komunës së Rahovecit ;
- Lirimi i gazrave serë (CO₂, SO₂, Nox) nga djegjia e mbeturinave nëpër kontinier apo jashtë tyre, djegjia e gomave dhe hamulloreve pas korrjeve, dhe aktivitete të operatorve ekonomik brenda dhe jasht qytetit,
- Cilësia e rrugëve dhe problemet që lidhen me shfrytëzimin, mirëmbajtjen e pamjaftueshme të tyre dhe të parkingjeve që kontribuojnë në rritjen e sasisë së pluhurit, dhe të shkarkimeve në ajër nga automjetet nga djegjia e karburanteve.

3.2 Resurset ujore

Resurset ujore janë faktor i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të një vendi. Vlerësohet se territori i komunës së Rahovecit ka rezerva të kufizuara të burimeve ujore dhe të njëjtat janë mjaft të ndotura. Ndotja e ujërave në territorin e komunës reflektohet kryesisht nga ndotja prej shkarkimeve të ujërave të zeza sanitare dhe ujërave industriale të cilat shkarkohen drejtpërdrejtë në lumenjtë e lartëpërmendur apo trupa tjerë ujorë pa ndonjë trajtim paraprak. Mungesa e infrastrukturës për trajtimin ujërave sanitare apo industriale të shkarkuara në trupa ujorë edhe në të ardhmen do të jetë burim i ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntoksore si burime të përdorura për nevoja të qytetarëve.

3.2.2 Cilësia e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore

Ujërrjedhat më të ndotura që përshkojnë territorin e qytetit të Rahovecit dhe vendbanimeve përreth janë Rimmiku, Duhllo, Sapniq, Bellaja si rrjedhojë e hedhjes së mbeturinave dhe shkarkimit të ujërave të zeza. Shfrytëzimi i zhavorit kryesisht nga shtrati i lumit Drini i Bardhë është veprim shumë negativ i cili krahas dëmtimit të pejsazhit dëmton edhe biodiversitetin e lumit dhe përreth tij. Shfrytëzimi i zhavorit nga shtretit e lumenjëve apo ngushtimit të shtratit të tyre me ndërtime buzë bregut apo hudhjes së mbetjeve ndërtimore çrregullon rrjedhën e tyre dhe për pasojë kemi edhe vërshimet të vendbanimeve dhe tokave bujqësore përgjatë këtyre rrjedhave pothuaj çdo vit në pranverë apo vjeshtë kur rritet intenziteti i reshjeve të shiut apo shkrija e hovshme e borës.

Ndotjet industriale nga operator si Venaria apo Termoventi si dhe operator tjerë më të vegjël gjithashtu kontribuojnë në ndotjen e burimeve ujore.

Mungesa e infrastrukturës për trajtimin ujërave sanitare apo industriale të shkarkuara në trupa ujorë edhe në të ardhmen do të jetë burim i ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntoksore si burime që përdoren për nevoja të qytetarëve. Një burim tjetër i ndotjes është edhe hedhja e mbeturinave urbane apo atyre ndërtimore në shtretër të ujërrjedhave apo afër tyre.




Foto 11. Ngushtimi i shtratit në Fortesë Foto 12. Shkarkimi i ujërave të zeza dhe mbeturinave



Foto 13 dhe 14. Vërshimet në Fortesë

3.2.3 Shfrytëzimi i ujerave sipërfaqësore dhe nëntokësore

a) Uji i pijes

Furnizimi me ujë cilësorë të pijes është nevojë elementare e cilësisë jetësore të njeriut dhe sipas konventave ndërkombetare është e drejtë univerzale njerzore. Sigurimi i ujit të pijshëm cilësor është parakusht themelor për shëndetin e një komuniteti andaj edhe detyrë e çdo shoqërie të ofroj këtë shërbim në kohë dhe sasi të mjaftueshme.

Furnizimi me ujë për qytetarët e komunës së Rahovecit bëhet nga Liqeni i Radoniqit, i cili ka kapacitet prej 113 milion m³, dhe përmes kompanisë rajonale “Gjakova” dhe nga pusët në zonat më të thella rurale. Aktualisht KRU, „Gjakova” sh.a, është ofruesi i vetëm publik me ujë të pijshëm në komunën e Rahovecit.

Sipas të dhënave nga raportet e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik (IKSHP) dhe KRU, „Gjakova” sh.a pjesa më e rrezikuar e popullsisë është ajo në zonat rurale të cilët furnizohen me ujë nga pusët individuale dhe nga ujësjellësit vetanak burimor, të cilët nuk menaxhohen nga ndërmarrje. Ato paraqesin rrezik për qytetarët, të cilët përdorin ujin e pakontrolluar, por që kohë pas kohe ka pasur dëshmi se shumë prej tyre kanë shfrytëzuar ujë të kontaminuar.

Uji i ofruar për zonën e shërbimit të cilën e mbulon KRU “Gjakova” i plotëson standardet e ujit të pijshëm sipas rregullores, respektivisht standardeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OSH) dhe rregulloreve dhe normave të IKSHP. Metoda e pastrimit, trajtimit – përpunimit të ujit është me sistemin e para klorinimit e deri te filtrimi në SF.

a) Rrjeti i ujësjellësit

Komuna e Rahovecit nuk ka rrjet shumë të zhvilluar të furnizimit me ujë të pijes, i cili ka shtrirje në 26 vendbanime, kanë ujësjellës kolektiv.

Nga tabela vijuese mund të shihet se 87 % e popullatës së Rahovecit kanë qasje në ujë cilësor të pijshëm përmes sistemit të ujësjellësit kolektiv, derisa vetëm 13% e popullatës nuk kanë qasje në këto sisteme dhe kryesisht furnizohen nga burime natyrore sipërfaqësore apo puse.

Tabela 3. Vendbanimet e Rahovecit të cilat janë të lidhura në sistemin e ujit të pijes

	Vendbanimet	K.R.U Gjakova	Operatori	Konsumatorët			Nr. i banoreve
				Amvis	Ente	Indus	
1	Rahoveci	K.R.U Gjakova	Nj. O. Rahovec	4541	67	4608	15892
2	Brestovci	K.R.U Gjakova	1/2Nj. O. Rahovec	293	1	294	1288
3	Bernjak	K.R.U Gjakova	Nj. O. Rahovec	21	6	27	40
4	Hoqa e Madhe	Ujera burimor	Nj. O. Rahovec	229	8	237	124
5	Zoqishti	Ujera burimor	Vetëm menaxhim			0	659
6	Opterusha	Ujera burimor	Nj. O. Rahovec	430	4	434	1911
7	Retia	K.R.U Gjakova	Nj. O. Prizren	104	1	105	771
8	Retia e Ulët	K.R.U Gjakova	Nj. O. Prizren	100	2	102	234
9	Krusha e Madhe	K.R.U Gjakova	Nj. O. Prizren	895	6	901	4473

10	Nagavci	K.R.U Gjakova	Nj. O. Prizren	173	3	176	743
11	Hoqa e Vogel	K.R.U Gjakova	Nj. O. Prizren	306	2	308	1166
12	Celina	K.R.U Gjakova	Nj. O. Prizren	418	2	420	1903
13	Xerxe	K.R.U Gjakova	Nj. O. Gjakova	778	7	785	3184
14	Fortesa	K.R.U Gjakova	Nj. O. Rahovec (50%)	520	4	524	2270
15	Sopniqi	K.R.U Gjakova	Nj. O. Rahovec	229	1	230	996
16	Potoqan i Ulet	K.R.U Gjakova	Nj. O. Rahovec	194	1	195	1077
17	Potoqan i Eperm	K.R.U Gjakova	Nj. O. Rahovec	108	1	109	533
18	Nushpala	K.R.U Gjakova	Nj. O. Rahovec	54		54	220
19	Drenoci	Ujëra burimor	Nj. O. Rahovec	275	4	279	1587
20	Senoci	Ujëra burimor	Nj. O. Rahovec	101	1	102	687
21	Postoseli	Nuk është i lidhur				0	1011
22	Zatririqi	Nuk është i lidhur				0	535
23	Polluzha	K.R.U Gjakova	Nj. O. Rahovec	162	2	164	808
24	Guri I Kuq	K.R.U Gjakova	Nj. O. Gjakova	109		109	731
25	Bratotini	K.R.U Gjakova	Nj. O. Gjakova	54		54	396
26	Kramoviku	K.R.U Gjakova	Nj. O. Gjakova	128	1	129	1125
27	Mrasor	Nuk është i lidhur				0	191
28	Kazniku	Nuk është i lidhur				0	164
29	Qifllaku	K.R.U Gjakova	Nj. O. Gjakova	220	2	222	1292
30	Saroshi	Nuk është i lidhur				0	6
31	Dobidoli	K.R.U Gjakova	Nj. O. Gjakova	80	1	81	799
32	Dejni	K.R.U Gjakova	Nj. O. Gjakova	306	1	307	1757
33	Ratkoci	K.R.U Gjakova	Nj. O. Gjakova	774	6	780	3791
34	Malesi e Vogel	K.R.U Gjakova	Nj. O. Gjakova	457	3	460	2346
35	Gexhe	K.R.U Gjakova	Nj. O. Gjakova	145	1	146	660
36	Vranjak	K.R.U Gjakova	Nj. O. Gjakova	140	1	141	838
				12344	139	12483	56208

Burimi: KRU Gjakova

Nga gjithsej 12,483 konsumatorë, 1,052 përdorin ujin e burimeve vetanake ndërsa 11,431 furnizohen nga rrjeti i K.R.U. Gjakova

Ndërsa sipas të dhënave nga Komuna nga 36 vendbanime me 56,208 banor, vetëm 7 prej tyre nuk kanë shërbime nga ujësjellësi ndërsa sipas KRU Gjakova nga 36 vendbanime me 56,208 banor 11,431 konsumatorë mbulohehen me shërbime dhe vetëm 5 vendbanime nuk mbulohehen dhe atë Saroshi, Mrasori, Kazniku, Pastoseli dhe Zatriqi ndërsa Hoqa e madhe dhe Zoqishti furnizohen nga burimet natyrore por operohen nga KRU Gjakova.

Nga ky sistem, në bazë të sasive të ujit, që momentalisht janë në dispozicion, konsumimi mesatar ditor për banorë vlerësohet të jetë përafërsisht 200-250 litra në ditë. Krahasuar me nivelet e BE-së, ku konsumimi i ujit për kokë banori është prej 100-150 l/kokë banori, del se këtu është dukshëm më i madh. Përkundër këtij kapaciteti të madh të ujit nga Hidrosistemi i Radoniqit, gjatë muajve të verës shfaqen probleme në furnizim me ujë sidomos në pikat

kritike të sistemit (zonat e larta dhe pikat e largëta). Duhet theksuar se humbjet e ujit qoftë ato teknike apo ato komerciale janë mjaft të larta rreth 43-57%. Humbjet e ujit në sistemin shpërndarës/rrjet janë humbjet teknike si rrjedhojë e dëmtimit të rrjetit apo prishjeve që ndodhin gjatë operimit të sistemit, ndërsa humbjet e ujit si pasojë e kyqjeve ilegale dhe keqpërdorimeve të ujit të pa faturuar për nevoja tjera si ujitje apo pastrimin e rrugëve apo makinave. Këto humbje paraqesin ndryshimin ndërmjet sasisë së prodhuar dhe sasisë së faturuar të ujit. Inkasimi për vitin 2010 vlerësohet të jetë 65-70%.

Rrjeti i ujësjellësit në komunën e Rahovecit, është mjaftë i vjetër, prej 5-25 vite. Edhe përkundër vjetërsisë, rrjeti mirëmbahet relativisht mirë nga ekipet e mirëmbajtjes së NJ.O Rahovec në kuadër të KRU Gjakova.

Me qëllim të reduktimit të humbjeve dhe ofrimit ma cilësor të shërbimeve kompanitë rajonale të ujësjellësve në Kosovë kanë hartuar dhe finalizuar strategjinë për reduktimin e humbjeve të ujit i cili është problemi kryesor. Këtu bënë pjesë edhe KRU "Gjakova" dhe në kuadër të strategjisë është parapare edhe ndërimi i ujëmatësve të cilët nuk funksionojnë dhe kalimi i tyre në sistemin SMART apo ujëmatës të mençur me anë të të cilëve do të shmangeshin shumë probleme në ofrimin e shërbimeve cilësore të furnizimit me ujë të pijshëm. Problem tjetër është identifikimi i lidhjeve ilegale dhe ndërimi i gypave të azbest çimentos në tërë zonën e shërbimit. KRU Gjakova, synon që deri në vitin 2020, të bëjë furnizimin e me ujë të fshatrave Pastasel, Babovc, Mrasor, Zatriq dhe Kaznik, me çka do të mbulohet furnizimi 100% me ujë të pijes në komunën e Rahovecit.

KRU Gjakova në koordinim edhe me Drejtorinë e Shërbimeve Publike në Rahovec, ka planifikuar investime në zonën e shërbimit për tri vitet e ardhshme në vlerë prej afro 2,000,000.00 EUR.

3.3. Menaxhimi i ujërave të ndotur

3.3.1. Rrjeti i kanalizimit të ujërave të ndotura - Gjendja ekzistuese

Ndotja e ujërave sipërfaqësore në lumenjtë e Kosovës, sikurse edhe në komunën e Rahovecit, është si pasojë e shkarkimit të ujërave të zeza dhe atyre industriale të pa trajtuara paraprakisht si dhe hedhja e mbeturinave të amvisërisë në trupa ujore. Këto dukuri negative janë të shprehura sidomos në viset e ulëta fushore aty edhe ku ka shtrirje aktiviteti njerëzor.




Foto 15 & 16 Shkarkimi i ujërave të zeza të fshatit Nushpall në përrrenjë

Shkarkimi i ujërave të zeza në rrjedhjet lumore pa trajtim paraprak rrit shkallën e ndotjes së lumit. Mesatarisht çdo banor shkarkon 16.46 m³/vit ujëra të zeza.

3.3.2. Rrjeti ekzistues i kanalizimit të ujërave të ndotura

Në komunën e Rahovecit, rrjeti i kanalizimit të ujërave të ndotura është shumë mirë i zhvilluar ku mbi 93% e popullatës dhe vendbanimeve është i mbuluar me këtë shërbim dhe vetëm 7% pjesërisht apo fare nuk janë mbuluar me këtë shërbim. Por ajo që vlen të theksohet është se nuk kemi asnjë impiant për trajtim qoftë primar apo sekondar të ujërave të zeza andaj ato si të tilla shkarkohen në trupa ujqor dhe mjedis duke shkaktuar ndotje të madhe.

Në tabelën vijuese janë paraqitur të dhënat e mbulueshmërisë me shërbimin e kanalizimit të ujërave fekal sipas vendbanimeve.

Tabela 4. Vendbanimet e mbuluar me shërbimet e kanalizimit

Nr	Vendbanimi	Nr. i banoreve	Kanalizim
1	Rahovec	15892	PO
2	Bellacerkë/Fortesë	2270	PO-pjesrisht
3	Bërnjak	40	po
4	Bratotin	396	PO
5	Brestovc	1288	PO
6	Celinë	1903	PO
7	Çifllak	1292	PO
8	Dobidol	799	PO
9	Dejnë	1757	Po
10	Drenoc	1587	PO
11	Gexhë	660	PO
12	Hoqë e Madhe	124	PO
13	Hoqë e Vogël	1166	PO
14	Kaznik	164	JO
15	Kramovik	1125	PO-pjesrisht
16	Krushë e Madhe	4473	PO
17	Mrasor	191	PO-pjesrisht
18	Nagavc	743	PO
19	Nushpal	220	PO
20	Opterushë	1911	PO
21	Pastasellë	1011	PO
22	Pataqan i Epërm	533	PO
23	Pataqan i poshtëm	1077	PO
24	Gur i Kuq	731	PO
25	Pölluzhë	808	PO
26	Radostë/Malësi e vogël	2346	PO

27	Ratkoc	3791	PO
28	Retijë e Ulët	234	PO
29	Retijë	771	PO
30	Sapniq	996	PO
31	Sarosh	6	PO
32	Senoc	687	PO
33	Vrajakë	838	PO
34	Xërxë	3184	PO
35	Zatriq	535	PO
36	Zoqishtë	659	PO
Totali		56208	
1	Me Kanalizim	52458	93.3
2	Pjesërisht	3586	6.4
2	Pa Kanalizim	164	0.3

Burimi PZHK

3.3.3. Trajtimi i ujërave të ndotur

Në komunën e Rahovecit të gjitha ujërat e ndotura qoftë ato urbane apo nga objektet industriale shkarkohen si të pa trajtura në trupa ujqorë apo mjedis. Këtu përjashtim bënë fshati Kramovik ku UNDP, Komuna e Rahovecit dhe projekti Drin Corda e mbështetur nga Global Environmental Facility (GEF) kanë nënshkruar një marrëveshje për ndërtimin e një impianti ARB (Reaktor Anareobik) -Moqalishte Horizontale për trajtimin e ujërave të zeza në fshatin Karmovik. Ky impiant do të shërbej 480 banorë me një rrjedhje ditore të ujërave të zeza prej 88 l/banorë/ditë i cili ka për qëllim zvogëlimin e shkallës së ndotjes së trupave ujqorë në pikat shkarkuese. Një projekt i tillë duhet shqyrtuar nëse mund të replikohet edhe në ndonjë vendbaim tjetër. Ndërtimi i gropave septike gjithashtu është një zgjidhje tjetër mjaft efikase e trajtimit biologjik të ujërave të zeza.




Foto 17, 18 dhe 19 -Moqalishtja Horizontale në Kramovik

3.4 Biodiversiteti dhe Resurset Pyjore në komunën e Rahovecit

3.4.1. Ekosistemet pyjore kryesore

Llojllojshmëria apo biodiversiteti i monumenteve natyrale të karakterit botanik në komunën e Rahovecit dhe peizazhet janë mjaft të pasura si rrjedhojë e klimës mesdhetare nëpërmjet luginës së Drinit të Bardhë që janë të shpërndara gjithandej në teritorin e komunës dhe si të tilla konsiderohen si vlera natyrore të trashëgimisë.

Pyjet dhe tokat pyjore si habitatet më të pasura shtrihen në veri-perëndim të komunës një sipërfaqe të përgjithshme prej rreth 10,800 ha, nga e cila 6,065 ha janë të mbuluara nga pyjet, ndërsa pjesa tjetër e zonës malore është e zhveshur. Degradimi i pyllit është një fenomen si në shumë pjesë të Kosovës, veçanërisht prerjet ilegale, ku rreth 2,200 hektarë të pyllit në regjistrin e komunës rezultojnë si të dëmtuar. Pyjet janë një habitat i mirë për rritjen dhe zhvillimin e llojeve të ndryshme të drujve dhe shkurreve si dhe kafshëve të egra andaj dëmtimi dhe degradimi i tyre ndikon drejtpërdrejt në dëmtimin e biodiversitetit.

Në pyjet kodrinore dominojnë shumë specie të përziera. Dallohen nga drurët gjetherënës si lisi i Turqisë, dhe me rreth 80% bung, ah dhe shkozë. Përhapje më të kufizuar kanë lloje të tjera si limoni (Tili kordata) dëllinja, hiri i zi etj. Lloje të tjera të ulëta janë gjithashtu të pranishme, lloje të shkurreve, si : thana, murrizi, si dhe Corylus-it në zonat e fierit të lartë.

Rreth 15% e territorit total të komunës përbëjnë livadhet dhe kullotat apo përafërsisht 4,208 ha që gjithashtu janë një habitat i mirë i shumë specieve bimore dhe organizmave shtatzor. Është një bazë e mirë për zhvillimin e aktiviteteve bujqësore, veçanërisht në zonat malore si kullota. Këtu rriten bimët e njohura si çaji i malit, kantariumi, kamomili, luleshtrydhet etj. Fauna është shumë e pasur me specie që nuk janë vetëm karakteristikë e kësaj hapësire. Në pyje jetojnë ujçit, dhelprat, lepuri, iriqi, gjarpri i ujtit etj. Llojet e peshqve janë të shumta, në Drinin e Bardhë jetojnë 18 lloje, ndërsa më të zakonshmet janë: mustaku, ngjala, krapa, trofta ylber, etj.

3.5. Menaxhimi dhe degradimi i tokës

Si çdo resurs tjetër natyror edhe toka duhet trajtuar seriozisht dhe në mënyrë të integruar për një zhvillim të qëndrueshëm. Trajtimi i integruar, kërkon zbatimin e politikave ekonomike, sociale dhe mjedisore në një mënyrë të përforcuar reciprokisht. Administrimi efikas i tokës, rritja e madhësisë së fermës përmes rregullimit të tokës, mbrojtja e tokës bujqësore nga degradimi i mëtejshëm, mbrojtja e mjedisit dhe arritja e zhvillimit të qëndrueshëm është një sfidë e madhe jo vetëm për Rahovecin. Tokat sikur në shumicën e komunave të Kosovës kryesisht në pjesët urbane dhe zonave përreth shfrytëzohen kryesisht për aktivitete jo bujqësore siç janë ndërtimet për qëllime banimi apo objekte afariste dhe industri, ndërsa në zonat rurale toka kryesisht shfrytëzohen për aktivitete bujqësore.

Gjatë viteve të fundit, është arritur një përparim i madh, megjithatë degradimi i tokës në zonat rurale dhe përreth zonave urbane si rredhojë e zgjerimit të pa kontrolluar urban, ndotja

mjedisore dhe dëmtimet në burimet natyrore janë vetëm disa nga problemet që duhet trajtuar për një menaxhim të mirë të këtij resursi jetik në të ardhmen.

Megjithatë, duhet gjetur një ekuilibër midis nivelit të shfrytëzimit të tokës dhe mbrojtjes së mjedisit. Vonesat në përshtatjen e këtij trajtimi të integruar dhe vazhdimësia me veprimtari, të cilat e dëmtojnë së tepërmi mjedisin, rrezikojnë shëndetin publik dhe pakësojnë cilësinë e jetës, dhe dërgojnë në një rritje të madhe të kostos së përgjithshme të zhvillimit ekonomik.

3.5.1. Degradimi dhe ndotja e tokës

Degradimi i tokës është një nocion kompleks i cili ngërthen në vete edhe shumë përbërës të tokës (toka, uji, bimësia, shkëmbinjë, ajër, klimë, relief), të cilët ndryshojnë në aspektin negativ. Nga aspekti bujqësor degradimi i tokës në përgjithësi nënkupton rënien e përkohshme ose të përhershme të kapacitetit prodhues të tokës dhe rënies së vlerës ekonomike si resurs. Nga aspekti i ndotjes degradimi nënkupton futjen e përbërësve negativ kimik të cilët shkatërojnë jo vetëm uljen e kapacitetit prodhues por edhe efektet negative në shëndetin e njeriut ndërsa nga aspekti i pejsazhit degradimi i tokës nënkupton edhe pamjen e keqe të sipërfaqes së tokës dhe erozionin.

Llojet e degradimit të tokave janë:

- **Erozioni** i shkaktuar nga uji apo era;
- **Ulja e pjellorisë** si pasojë e zvogëlimit të materies organike, degradimit të vetive fizike, zvogëlimit të materieve ushqyese, ndotjeve (plehëra, pesticide, me ujë të ndotur);
- **Moqalizimi** si pasojë e ngritjes së nivelit të ujërave nëntokësore, kullimit jo të mirë apo ujitjes jo përkatëse;
- **Kripëzimi** me rritjen e koncentrimin të kripave në tretjen tokësore si pasojë ujërave të ndotura apo të kripëzuara;
- **Sedimentimi** i shkaktuar nga vërshimet përmes bartjes së materieve të ndryshme nga uji;
- **Ulja e nivelit të ujit nëntokësorë** si pasojë e shfrytëzimit të madh të ujërave nëntokësore;
- **Zhveshja nga vegjetacioni** i tokave si pasojë e prejeve të pyjeve, ndërrimit të destinimit të tokës me çka shkaktohet erozioni;

Ndërsa, shkaktarët kryesor në degradimin e tokave janë: shfrytëzimi jo adekuat i tyre; ndërrimi i destinimit të përdorimit; përdorimi i pa kontrolluar i pesticideve dhe plehërave artificiale; ndotja e ujërave sipërfaqësore; hudhja e mbeturinave jashtë deponive sanitare; shfrytëzimi i pa kontrolluar i resurseve natyrore (pyjet, ujërat, gurëve dhe zhavorit, mineraleve etj.).

Në rastin konkret në komunën e Rahovecit ndotja dhe degradimi i tokave është pasojë e ndotjes së lumenjve nga shkarkimet e ujërave të ndotura dhe të pa trajtuara që për pasojë ka ndotjen e ujërave nëntokësore e me këtë edhe ndotjen e tokave përreth.

Gjithashtu deponitë ilegale janë një tjetër burim i ndotjes dhe degradimit të tokave në komunën e Rahovecit.

Një formë tjetër mjaft prezente e degradimit të tokave është edhe urbanizimi i pa kontrolluar i cili ka qenë i shprehur sidomos në periudhen e pas luftës në zonat përreth qytetit por edhe në disa lagje në mbrendi të qytetit. Për të ilustruar këtë dukuri mjafton të nënvizohet fakti se në komunën e Rahovecit por edhe në shumicën e qyteteve të Kosovë sot kemi ndërtime pa leje duke shkaktuar një kaos urbanistik dhe probleme në furnizim me ujë të pijshëm, shërbime të kanalizimit, menaxhim të mbeturinave dhe zhdukjen e hapësirave të gjelbëruara dhe atyre publike.

3.6. Administrimi dhe menaxhimi i mbeturinave në komunë

Një ndër sfidat kryesore të çdo komuniteti në përmirësimin e gjendjes së mjedisit dhe shëndetit publik mbetet menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave. Kjo vlen edhe për Kosovën si shtet por edhe për komunën e Rahovecit. Me gjithë arritjet dhe progresin në forcimin e bazës ligjore dhe programore për sektorin e mbeturinave, me gjithë përmirësimin e infrastrukturës për menaxhimin e tyre, mbetet ende hapsirë për angazhim dhe punë për përmirësimin e gjendjes në sektorin e menaxhimit të mbeturinave.

Mbeturinat e ngurta urbane janë temë e vazhdueshme e ankesave nga qytetarët dhe mbesin ende prioritet për të gjitha komunat në Republikën e Kosovës. Një pjesë e madhe e mbeturinave vazhdon të hedhet në mënyrë të pakontrolluar duke krijuar kështu deponi ilegale dhe burim infeksioni për banorët. Për më tepër, sasia e mbeturinave është në rritje dhe komunat janë nën presion të madh që të ofrojnë shërbime më të mira për qytetarët në këtë fushë. Sfidë jashtëzakonisht e madhe është krijimi i sistemit për menaxhimin e mbeturinave në nivelin lokal, duke filluar nga grumbullimi, ndarja, riciklimi, trajtimi dhe deponimi i tyre. Njëri nga problemet deri më tani ishte edhe legjislacioni dhe ndarja e kompetencave për menaxhimin e mbeturinave.

3.6.1. Menaxhimi i Mbeturinave

Për menaxhimin e mbeturinave në teritorin e komunes së Rahovecit, komuna respektivisht Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka licencuar dy kompani:

- NDËRRMARRJA PUBLIKE "EKOREGJIONI"- e cila mbulon pjesën më të madhe të teritorit të Rahovecit, dhe
- EKODRINIA operator privat.

Kompanitë të cilat janë e licencuar për administrimin e mbeturinave punojnë në bazë të rregullores për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Rahovecit, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina e miratuar nga Kuvendi i Kosoves në vitin 2014.

Për menaxhim dhe rregullim sa ma të mirë të sektorit të mbeturinave komuna e Rahoveci krahas zbatimit të ligjit për mbeturina ka miratuar edhe kornizën rregullative dhe dokumente strategjike si vijon:

- Rregulloren për plotësimin e rregullorës për menaxhimin e mbeturinave 01. Nr 4103 të datës 09.12.2015.
- Rregullore për menaxhimin e mbeturinave 01.Nr.239.të dates 30..01.2015 dhe
- Planin Lokal për menaxhimin e mbeturinave të vitit 2016-2021.

Komuna ka përzgjedhur deponinë ku do të hudhen mbeturinat nga konstruktimi dhe demolimi i objekteve të ndryshme ndërtimore.

Mbulimi i shërbimeve në territorin e komunës është i përfshirë në të gjithë territorin apo në 36 vendbanimet. Aktualisht operatori më i madh është Ekoregjioni-NJP "Ambienti" i cila sipas shënimeve të komunës ofron shërbim primar të grumbullimit të mbeturinave për 66% të popullatës së përgjithshme, dhe atë 100% të zonën urbane dhe rreth 27% në zonat rurale apo 36,439 banor. Kurse operatori tjetër "Ekodrinia", shërben kryesisht në pjesën rurale dhe rurale të thellë me përqindje të përgjithshme prej 34%.

Tabela 5. Shërbimet e operatorëve sipas zonave të MM

Operatori	Zona 1	Zona 2	Total	Në %
Ekodrinia	540	1,861	2,401	29.5%
NJP "Ambienti"	5,742	-	5,742	70.5%
Total	6,282	1,861	8,143	100.0%

Sasia e mbeturinave e cila grumbullohet brenda një dite sillet 20-30 ton, kurse sipas raporteve të dy kompanive që operojnë në komunën e Rahovecit, shërbimi i grumbullimit të mbeturinave zhvillohet në të gjitha vendbanimet e komunës, megjithatë një pjesë e amvisërive nuk pranon të bëjë marrëveshje me operatorët.

Tabela 6. Lokalitetet të cilat nuk marrin shërbim të plotë të MM

Lokaliteti	Zona	Distanca KM	Rangu Km	Ekonomi Famil.	Ekonomi Familjare/Te Mbulura	Ekonomi Familjare/Pa Mbulura	Gjen Mbeturine Vit-Ton	Mbet. Jo-te Menaxh.
Nushpal	Zona 2	7	6-9	32	22	10	40	13
Senoc	Zona 2	7	6-9	101	69	32	125	39
Polluzhë	Zona 2	11	9-12	162	60	102	147	93
Gexhë	Zona 2	12	9-12	165	68	97	120	71
Kazmik	Zona 2	13	12-40	24	8	16	24	16
Bratotin	Zona 2	21	12-40	58	24	34	58	34
Dabidol	Zona 2	21	12-40	138	36	102	117	86
Sarosh	Zona 2	23	12-40	2	1	1	1	0
Guri i kuq	Zona 2	28	12-40	183	56	127	107	74
Mrasor	Zona 2	32	12-40	28	15	13	28	13
Total				892	359	533		439

Burimi PZHK

Edhe përkundër mbulueshmërisë totale me shërbime prap kemi banorë/familje që nuk marrin këto shërbime.

Arsyet kryesore për grumbullimin jo të plotë të mbeturinave janë të ndryshme, si:

- Niveli i ulët i vetëdijes në mesin e banorëve;
- Kapacitetet e kufizuara të Ndërmarrjes Publike për menaxhimin e mbeturinave;
- Mospagesa e një pjesë të përfituesve të shërbimit;

- Mos zgjidhja e çështjes së mbeturinave ndërtimore (demolimeve);
- Problemi i pazgjidhur i menaxhimit të mbeturinave nga mbetjet shtazore;
- Shkalla e ulët dhe informale e ndarjes dhe riciklimit.

3.6.2. Shërbimet e ndërmarrjeve për menaxhimin e mbeturinave

Veprimtaria primare e kompanive të licencuara për menaxhimin e mbeturinave në komunë është:

- ✓ grumbullimi i mbeturinave, dhe
- ✓ transporti i mbeturinave komunale,

Ndërsa shërbim dytësor kanë:

- ✓ Menaxhimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike.
- ✓ Pastrimin e rrugëve dhe pastrimin e borës gjatë sezonës dimërore
- ✓ Mirëmbajtjen hapësirave të gjelbërta publike .

Kompanitë ofrojnë shërbimet e tyre për tri kategori të konsumatorëve: ekonomitë familjare, biznese dhe institucionet.

Format e shërbimit janë: shërbimi derë më derë dhe konsumatorët të pajisur me kontejnerë, kurse bizneset me kontrata janë të pajisura me kontejnerë të veçantë.

Mekanizmi i inkasimit bëhet përmes inksantëve, arkës ndihmëse dhe llogarive rrjedhëse. Shkalla e arkëtimit për shërbimet e ofruara tek NjP Ambienti është 80-82% që vlerësohet si arkëtim mjaft i mirë. Kjo kompani grumbullon dhe transporton deri në deponinë në Landovicë rreth 8,500 t/vit.

Mbeturinat e mbledhura nga konsumatorët dërgohen në deponinë finale në Landovicë ku edhe bëhet matja përkatëse.

a) Vështirësitë e Kompanive

Objektivat kryesore janë rritja e cilësisë së shërbimeve, rritja e inkasimit dhe e zgjerimit të rrejtës shërbyes në tërë komunën. Por që këto kompani të ofrojnë shërbime cilësore dhe me kohë nevojitet që të bashkëpunohet ngusht me komunitetin që nga burimi i krijimit të mbeturinave e deri tek deponimi i tyre. Ekoregjioni NjP “Ambienti” shërbimet e veta i ofron 1 herë në javë në zonat jasht qytetit, 2 herë në javë në lagjet periferike dhe çdo ditë në rruget kryesore të qytetit.

NjP “Ambienti” posedon 5 kamion kompaktorë, 1 kamion me cisternë, 1 kamion me rimorkio, 3 traktorë. “Ekodrinia” posedon 3 kamiona 12, 11 dhe 6 tonesh, një kamionetë dhe një cisternë 15000 L.

Kontejneret publik janë mjaft të vjetruar dhe vështirë manipulohen dhe mungesa e kontejnerëve të vegjël familjarë shkakton vështirësi në procesin e grumbullimit të mbetjeve. Gjatë sezonit veror ka prodhim ma të madh të mbetjeve dhe mekanizmi ekzistues shpesh nuk mbërrinë të bëjë transportimin 2 herë në ditë deri në deponinë regjionale në Landovicë, kështu që ndërtimi i një transfer deponie do të lehtësonte shumë grumbullimin me kohë dhe cilësor. Gjithashtu mungesa e ndriçimit publik pamundëson operimin e kompanisë edhe në ndërrimin e natës.

Kompania posedon vetëm një kamion cistern për pastrimin e rrugëve dhe kjo nuk mjafton për ofrimin e këtij shërbimi sekondar sidomos në sezonin e vjeljes së rrushit kur ka rrjedhje të lëngut të rrushit gjatë transportit.

Arkëtimi i taksës për shërbimet e ofruara në shkallë sa më të lartë ju mundëson atyre që të ofrojnë shërbime cilësore por gjithashtu kompanitë duhet të jenë të kujdesshme për shërbim sa më cilësor dhe me kohë. Arkëtimi mbi 80% të shërbimeve në rastin e kompanisë Ambienti krijon një situatë të qëndrueshme financiare por kjo kompani ka telashe me borxhe të vjetra.

3.6.5. Prodhimi dhe përbërja e mbeturinave

Struktura e mbeturinave sipas llojeve të tyre në nivel të Kosovës është kalkuluar duke u bazuar në hulumtimet që janë bërë në 4 qytete të Kosovës: Prishtinë, Prizren, Viti dhe Hani i Elezit në vitin 2012. Hulumtimet janë pjesë e planeve komunale për menaxhimin e mbeturinave të përkrahura nga GIZ, JICA dhe LOGOS.

Përbërja e mbeturinave dëshmon se 75% e mbeturinave janë të riciklueshme; 42% janë mbeturina organike, ndërsa 33% janë lëndë të tjera të riciklueshme.




Figura 6. Struktura e mbeturinave

Edhe pse nuk kemi informata për strukturën e mbeturinave për komunën e Rahovecit ajo pak a shumë duhet të jetë e ngjashme me atë në nivel vendi ku dominojnë mbetjet e amvisërisë apo mbetjet biodegraduese.

3.6.6. Reciklimi i mbeturinave

Në komunën e Rahovecit si edhe në shumicën e komunave të Republikës së Kosovës përqindja ma e madhe e mbetjeve janë ato biodegraduese apo mbetjet organike të amvisërisë. Karakteristikë e mbetjeve biodegraduese në Rahovec janë mbetjet nga krasitja e hardhisë dhe mbetjet nga përpunimi i rrushit të cilat mund të riciklohen dhe nga to të prodhohen plehëra organik shumë të nevojshëm për bujqësi. Gjithashtu mbetjet nga plastika janë një mundësi tjetër e reciklimit të tyre nëse organizohet ndarja në burim e mbeturinave dhe për këtë qëllim duhet furnizuar me kontejner për ndarjen e tyre dhe duhet organizuar grumbullimi dhe transporti i tyre i veçantë nga ndonjë operator privat. Në Rahovec ekzistojnë tri kompani private Toni, Korenica dhe Pista Ecoplast të cilat bëjnë grumbullimin dhe përpunimin e mbetjeve të plastikës për prodhimin e arkave të plastikës për perime, ulëse për palestra dhe gypa. Lënda e parë për prodhim në këto kompani kryesisht sigurohet nga importi. Është mirë

që komuna në partneritet publiko privat të shqyrtoj mundësinë e reciklimit të mbetjeve të plastikës duke organizuar ndarjen e plastikës në burim të cilën kompanitë e lartpërmendura do ta përdorin si lëndë të parë me plotësime teknologjike që do ta mundësonin këtë.




Foto 20 & 21. Grumbullimi dhe përpunimi i plastikës Toni & Pista

Një prej sfidave në sektorin e menaxhimit të mbeturinave është menaxhimi i mbetjeve kimike industriale, medicinale, shtazore dhe elektrike apo elektronike të cilat nuk janë në kompetencë të drejtpërdrejtë të komunës. Menaxhimi i këtyre llojeve të mbetjeve kërkon urgjentisht të adresohet si në nivel vendi apo edhe në nivel komunal. Reciklimi i këtyre mbetjeve është prej mundësive përmes bashkpunimit publiko privat gjithashtu.

3.7. Ndrëçimi publik

Ndrëçimi publik në komunën e Rahovecit është bërë vetëm në zonën urbane si dhe në vendbanimet Krushë e Madhe dhe Dejnë me një gjatësi të gjithmbarëshme prej 16.59 km prej të cilave 12.89 km në Rahovec, 1.2 km në Krushë e Madhe dhe 2.5 km në Dejnë. Rrjeti i sistemit të ndrëçimit është i përbërë prej shtyllave të drurit dhe disa prej tyre janë shtylla të betonit me lartësi deri në 8.5 m, Distanca në mes të shtyllave është 35 metra.

Është e nevojshme që rrjeti i ndrëçimit publik të bëhet në vendbanimet e mëdha dhe të dendura me numër më të madh të popullsisë si dhe në qendrat Sekondare (Ratkoc, Xërxë, Fortesë/Bellacërke, Radoste, Celinë, Drenoc dhe në Krushë të Madhe) në pjesët tjera të pa mbuluara.

3.8. Ndotja akustike-Zhurma

Ndotja akustike është zhurma shqetësuese me ndikim të dëmshëm në veprimtarinë e jetës njerëzore por edhe të kafshëve. Zhurmat, me dhe pa dëshirën tonë, janë bërë pjesë e përditshmërisë sonë.

Burimi i zhurmës në natyrë në mbarë botën është shkaktuar kryesisht nga makinat dhe sistemet e transportit, motorët e automjeteve motorike dhe trenat. Planifikimi i dobët urbanistik mund të shkaktojë ndotje nga zhurma, ndërtime industriale dhe banimi mund të

rezultojnë me ndotje të zhurmës në zonat e banuara. Pra zhurma është ndotje mjedisore karakteristike për zonat urbane andaj kjo vlenë edhe për Rahovecin si qendër urbane por jo vetëm nga se edhe jasht qytetit ka kapacitete industriale si mulliri M&sillosi apo ndonjë kapacitet tjetër. Zhurmë shkatojnë edhe makinerit ndërtimore dhe ato transportuese, gjeneratorët elektrik apo makinat në trafik. Në qytet burim i ndotjes akustike kryesisht janë muzika e lartë, trafiku i rënduar, ndërtimet pa orar edhe gjatë natës, puna në mobileri, servise apo kafiteri.

Ekspozimi i gjatë ndaj zhurmës mund të shkaktojë shqetësime apo stres, shpërqendrim deri në humbjen e dëgjimit. Nivelet e larta të zhurmës mund të rezultojë në efekte kardiovaskulare dhe ekspozimi ndaj niveleve të larta gjatë një periudhe tetë-orëshe në punë shkakton një rritje statistikore të presionit të gjakut prej pesë deri në dhjetë pikë dhe një rritje në stres duke çuar në rritjen e presionit të gjakut dhe rritjen e incidencës së sëmundjes së arteries koronare.

3.9. Planifikimi urban dhe gjelbërimi publik

Pothuajse të gjitha vendbanimet e komunës së Rahovecit janë formuar në mënyrë spontane. Ndërsa forma e tyre e parregullt është si pasojë e kushteve natyrore të terrenit, por edhe faktorëve shoqëror-ekonomik dhe historik.

Rahoveci si qendër komunale dhe i vetmi vendbanim i karakterit urban vetëm me një pjesë të vogël mund të konsiderohet me plan. Shikuar në aspektin e strukturës morfologjike-urbanistike, dallohen këta tipa të vendbanimeve: Tip i grumbulluar i vendbanimeve dhe i shpërdarë rural.

Vendbanimet e grumbullura strukturën e tyre e karakterizon koncentrimi i madh i objekteve ndërtimore, oborreve ekonomike. Ky tip i vendbanimeve kryesisht është prezent në zonën e ulët të fushës. Oborret ekonomike janë të madhësive të ndryshme, por zakonisht me sipërfaqe të vogla. Ndërsa ato janë të shfrytëzuara në mënyrë maksimale, qoftë në pjesën e përparme, kah rruga, apo në pjesën e mesme të tyre me shumë pak apo fare hapësira të gjelbruara. Si në shumicën e vendbanimeve urbane por edhe rurale të Kosovës edhe në komunën e Rahovecit kemi shumë ndërtime pa leje dhe një zhvillim urban kaotik i cili pamundëson ofrim cilësor të shërbimeve komunale (ujësjellës, kanalizim, rrugë, vendparkim, menaxhim mbeturinash) dhe mungesë të hapsirave të gjelbëruara apo parqe.

3.9.1. Vendbanimet jo formale

Në komunën e Rahovecit janë identifikuar 9 vendbanime jo formale, një nga të cilat ndodhet në zonën urbane dhe 8 në zonat rurale. Në këto vendbanime jetojnë kryesisht banorë të komunitetit rom, ashkali, egjiptian por edhe shqiptar. Këto vendbanime karakterizohen me mungesë të infrastrukturës fizike dhe infrastrukturë sociale si dhe kanë ndikim negativ në mjedis.

Sipërfaqja e përgjithshme e vendbanimeve jo formale në Komunën e Rahovecit është 12.2 ha. Në të gjitha këto vendbanime jetojnë gjithsej 1556, me 293 ekonomi familjare.

Vendbanimet jo formale gjenden në këto vendbanime: Një pjesë e qytetit të Rahovecit, dhe pjesë apo lagje të fshatrave Fortesë/Bellacërk, Xërxë, Gexhë, Radost, Ratkoc, Çifllak, Dabidol dhe dy pjesë të fshatit Drenoc.

4.0. Trafiku dhe infrastruktura rrugore

